



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Skrapar**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë**

**të ushtruar në**

## **BASHKINË SKRAPAR**

**Tiranë, 2024**

# PËRMBAJTJA

SHKURTIME..... Error! Bookmark not defined.

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 3

1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit ..... 12

## II. HYRJE..... 13

1. Objekti i Auditimit..... **Error! Bookmark not defined.**

2. Qëllimi i auditimit..... **Error! Bookmark not defined.**

3. Identifikimi i çështjes..... 14

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..... 14

5. Përgjegjësitë e audituesve ..... 14

6. Kriteret e vlerësimit ..... 15

7. Standardet e auditimit ..... 17

8. Metodot e auditimit ..... **Error! Bookmark not defined.**

9. Dokumentimi i auditimit..... **Error! Bookmark not defined.**

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT ..... 19

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Skrapar ..... 19

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit. .... **Error! Bookmark not defined.**

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. .... 20

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit ..... 27

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar..... 38

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik ..... 42

2.5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit..... 91

2.6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV) ..... 97

2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ..... 98

2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit ..... 107

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET ..... 108

A. MASA ORGANIZATIVE ..... 108

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI ..... **Error! Bookmark not defined.**

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR (TË ARDHURA TË MUNGUARA)..... **Error! Bookmark not defined.**

E. MASA DISIPLINORE ..... **Error! Bookmark not defined.**

## V. ANEKSET ..... 123

Anekset mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin..... 123

Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit ..... 123

Anekset mbi të ardhurat ..... 127

Anekset mbi prokurimet publike..... 131

Anekset mbi Lejet e Ndërtimit ..... 134

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Skrapar:

Bashkia Skrapar është një nga 61 bashkitë në Shqipëri. Ajo ka një sipërfaqe prej 774 kilometër katror, dhe përfaqëson një tërësi prej 103 fshatrash.

Këto fshatra, lidhur nga afërsia gjeografike, traditat dhe ritalet historikë janë të grupuar në 8 Njësi Administrative, pas ndarjes administrativo-territoriale të vitit 2015.

Çorovoda, është qendra kryesore e Skraparit. Aty ndodhen të lokalizuara institucionet kryesore të Skraparit. Sipas të dhënave të INSTAT në 01.01.2019, numri i popullsisë së Skraparit është 17,343 banorë. Bashkia Skrapar bën pjesë në Qarkun e Beratit dhe është 1 nga 5 Bashkitë e këtij Qarku. Bashkia Skrapar në gjithë qarkun zë 43% të sipërfaqes së gjithë qarkut.

Për vitin 2022, buxheti bazë fillestar vjetor është miratuar me VKB nr. 65 datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 908/2, datë 10.01.2022. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton neni 41 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë VKB, në total të ardhurat sipas buxhetit të vitit 2022 janë 688,952 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 104,182 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 127,428 mijë lekë, transfertat specifikë ka vlerën 134,477 mijë lekë. Shpenzimet në total për vitin 2022 janë parashikuar në shumën 688,952 mijë lekë.

Për vitin 2023, buxheti bazë fillestar vjetor është miratuar me VKB nr. 86, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 951/1, datë 09.01.2023. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton neni 41 i Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë VKB në total të ardhurat sipas buxhetit të vitit 2023 janë 661,904 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 73.800 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 181.263 mijë lekë, transfertat specifikë ka vlerën 134.821 mijë lekë. Shpenzimet në total për vitin 2023 janë parashikuar në shumën 661,904 mijë lekë.

### b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Bashkia e Skraparit është njësi vendore e pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish bashkia Çorovodë dhe tetë ish komunat në afërsitë të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe janë: NjA Çodovodë (qyteti), NjA Qëndër Skrapar, NjA Bogovë, NjA Vëndreshë, NjA Çepan, NjA Potom, NjA Leshnjë, NjA Gjerbës dhe NjA Zhepë.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të auditimeve për muajin janar 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87 prot., datë 16.01.2024.

### c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2023.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Referuar nivelit të materialitetit, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 14 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Skrapar dhe njësinë e saj shpenzuese, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, me fond limit 163,431,389 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 113,444,166 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 23 gjetje dhe ka dhënë 31 rekomandime, nga ku masa organizative 17 gjetje me 27 rekomandime, masa për shpërbllim dëmi 2 gjetje me 2 rekomandime dhe masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) 2 gjetje me 2 rekomandime.

Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve u konstatua dëm ekonomik në vlerën 688,600 lekë me TVSh dhe në fushën e të ardhurave të munguara, u konstatua si vijon:

- Detyrime nga abonentët familjarë në vlerën 95,805,410 lekë
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 7,985,028 lekë;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 561,579 lekë;
- Qira trualli në vlerën 480,000 lekë;

Në fushën e prokurimeve, u konstatua si vijon:

- Në 7 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 41,313,973 lekë pa TVSh

dhe vlerë totale të kontratave 40,322,656 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

- Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 97,422,625 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në 8 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 40,039,475 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 35,263,160 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar dhe Ndërmarja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Në fushën e lejeve të ndërtimit, u konstatua si vijon:

- Nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës, parcela minimale e lejuar për zhvillim, lartësia maksimale e lejuar e objektit, si dhe ajo e katit përdhe, në 2 raste;

- Projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, në 3 raste;

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Skrapar nuk ka kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 2 raste;

- Zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “*Njoftimit të fillimit të punimeve*”, në 2 raste.

## **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

### ***1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik***

Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik rezultoi se:

- Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se: Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve në Bashkinë Skrapar nuk ka hartuar një program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike, si dhe mungon një program strategjik dhe vjetor për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Nuk ka koordinator për MFK-në dhe koordinator risku. Për vitin 2022 dhe vitin 2023 nuk janë dokumentuar takimet vjetore të GMS. Nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet IT. Në Bashkinë Skrapar nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk është miratuar gjurma e auditimit. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nga auditimi i veprimtarisë dhe përbërjes së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, u konstatua se NJAB e Bashkisë Skrapar përmban vetëm një punonjës nga tre që parashikon pika 3 e VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisive të auditimit të*

*brendshëm në sektorin publik*". NJAB Skrapar nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit të njërive të menaxhimit të Bashkisë Skrapar.

## **2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Skrapar, u konstatua se: Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është **662,726 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer **579,917 mijë lekë** me një diferencë prej **82,088 mijë lekë** ose në masën **88%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar 13,803 mijë lekë dhe është realizuar 5,158 mijë lekë ose në masën 37%. Gjithashtu, zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 38% pasi, janë planifikuar investime 154,708 mijë lekë dhe janë realizuar 117,212 mijë lekë ose 68%. Zëri shpenzime operative është planifikuar 104,841 mijë lekë dhe është realizuar 75,119 lekë ose në masën 72%.

Për vitin 2022, planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është **689,416 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzimet janë **640,379 mijë lekë**, me një diferencë **49,036 mijë lekë** ose në masën **93%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar 16,921 mijë lekë dhe është realizuar 10,987 mijë lekë ose në masën 65%. Gjithashtu, zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 11%, pasi janë planifikuar investime 225,727 mijë lekë dhe janë realizuar 200,779 mijë lekë ose në masën 89%. Zëri shpenzime operative është planifikuar 79,327 mijë lekë dhe është realizuar 71,920 mijë lekë ose në masën 91%.

- Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, si një nga zërat kryesorë të shpenzimeve për secilin vit buxhetor, në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e buxhetit. Mosarritja e pritshmërive vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Skrapar në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

- Bashkia Skrapar në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta 18,533 mijë lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar 76,398,342 lekë detyrime të prapambetura dhe janë likuiduar 77,827,037 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 36,981,155 lekë për faturat e pranuar gjatë periudhës 01.01.2023-31.10.2023 dhe në total, në fund vitit 2023 vlera e detyrimeve të prapambetura është 14,055,953 lekë.

- Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për disa zëra, realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real.

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Skrapar, u konstatua se deri më datën 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën 85,872 mijë lekë. Përgjatë vitit 2022 vlera debitore e krijuar është 9,324,913 lekë, si dhe vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2023 është 10,634,682 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive deri më datën 31.12.2023, janë në vlerën **105,832 mijë lekë**, e përbërë nga:

*Detyrime nga abonentët familjarë në vlerën 95,805,410 lekë*

*Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 7,985,028 lekë;*

*Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 561,579 lekë;*

*Qira trualli në vlerën 480,000 lekë;*

- Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2023, u konstatua se:

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga

auditimi i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH, në periudhën e audituar më parë, madje edhe nga vlera e maturuar gjatë periudhës objekt auditimi. Vlera debitore në fillim të vitit 2022 rezulton në shumën 60,510 mijë lekë nga ku gjetë vitit 2022 shuma e maturuar është në vlerën 8,120 mijë lekë dhe e arkëtuar në vlerën 3,636 mijë lekë. Vlera debitore në fillim të vitit 2023 rezulton në shumën 64,997 mijë lekë nga ku gjatë vitit 2023 shuma e maturuar është në vlerën 8,034 mijë lekë dhe e arkëtuar në vlerën 3,322 mijë lekë. Pra rezulton një vlerë më pak se 40% e vlerës së arkëtuar duke rritur akoma më shumë totalin e debisë progresive në fund të vitit 2023 e cila paraqitet në vlerën **69,276,330 lekë. Kjo shumë konsiderohet e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Skrapar.**

### **3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar**

- Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentave financiare dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në njësitë e varësisë, rezultoi se nga Drejtoria Ekonomike dhe sektorët e financës në njësitë e varësisë të Bashkisë Skrapar, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me programin Excel dhe jo me “*Bartës Informatik*”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023, rezultoi se në Bashkinë Skrapar, Nëpunësi Zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia dhe njësitë në varësi. Për vitin 2023 në lidhje me zërat: tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj., të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Skrapar, rezultoi se nga Nëpunësi Autorizues në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e tyre.

- Nga auditimi mbi dokumentacionin e procesit të inventarizimit, u konstatua se në disa raste, fletëinventarët fizikë nuk janë nënshkruar nga punonjësi me përgjegjësi materiale si dhe nga anëtarët e komisionit. Në urdhërin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitit 2023, si dhe në fletët e inventarit, rezulton se, në komision janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit. Nga komisioni i inventarizimit rezulton se nuk është hartuar një raport lidhur me procesin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, vërejtjet për diferencat e konstatuara, shkaqet në raste të dëmtimeve, etj.

### **4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik**

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje.

- Në 7 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 41,313,973 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 40,322,656 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

- Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 97,422,625 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e

kontratës.

- Në 8 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 40,039,475 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 35,263,160 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë*”, me vlerë të kontratës 50,628,700 lekë me TVSh, fituar nga OE “D” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 405,000 lekë (me TVSh).

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë*”, me vlerë të kontratës 12,746,600 lekë me TVSh, fituar nga OE “F” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në vlerën 216,600 lekë (me TVSh).

#### ***5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit***

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës, parcela minimale e lejuar për zhvillim, lartësia maksimale e lejuar e objektit, si dhe ajo e katit përdhe, në **2 raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B , për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, në **tre raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B , për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

- Çertifikatë përdorimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 09, datë 29.09.2023.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Skrapar nuk ka kërkuar dhe respektuar në asnjë rast mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në **dy raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B , për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, Nj. Adm. Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se zhvilluesi dhe



aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “Njoftimit të fillimit të punimeve”, në dy raste për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstrukcion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B , për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022;
- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

#### **6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi përbërjen dhe veprimtarinë e IMTV në Bashkinë Skrapar, u konstatua se për vitet 2022 dhe 2023, Bashkia Skrapar nuk ka ngritur strukturën e IMTV. Inspektori që mbulon mbrojtjen e territorit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka arsimimin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

#### **7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

- Nga 10 Masa organizative, janë pranuar plotësisht 10 masa organizative, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, dhe nuk janë zbatuar 6 masa.
- Nga 13 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të tyre, janë pranuar 13 masa, 1 masë është pjesërisht e zbatuar, janë zbatuar dy masa dhe nuk janë zbatuar 10 masa.
- Nga 13 Masa disiplinore, janë pranuar të 13-ta masat, janë zbatuar 8, nuk janë zbatuar 5 prej tyre.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

##### **1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

Kryetari i Bashkisë Skrapar, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar duhet të marrë masa që në vijimësi, Njësia e Auditimit të Brendshëm:

Të funksionojë gjithmonë sipas strukturës së përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi, me jo më pak se tre punonjës, përfshirë edhe përgjegjësën e kësaj njësie.

Të krijojë një dosje të përshërshme të auditimit, sipas përcaktimeve të Manualit të AB.

##### **2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

- Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Skrapar, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

- Bashkia Skrapar, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin, në fund të çdo viti buxhetor të përgatitë dhe të paraqesë për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor dhe në vijim Këshilli Bashkiak Skrapar të marrë vendimet brenda afateve.

- Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me

miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mosshlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e njësisë vendore gjatë vitit në vazhdim, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të gjendjes së të ardhurave vjetore të bashkisë.

- Bashkia Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 105,832 mijë lekë**, e cila përbëhet nga:

- **95,805,410 lekë** detyrime nga **abonentët familjarë**;

- **7,985,028 lekë** detyrime nga **biznesi i madh**;

- **561,579 lekë** detyrime nga **biznesi i vogël**;

- **480,000 lekë** detyrime nga qiratë e truallit;

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pallogaritur dhe papaguar në shumë **69,276,330 lekë**.

### ***3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar***

- Bashkia Skrapar, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, të ngrejë strukturat e nevojshme me specialistë të fushës dhe të kryejë analizën e situatës së aktiveve të njësisë, duke vlerësuar asetet që ka në administrim, plotësimin me dokumentacion pronësor, si dhe kryerjen e regjistrimeve përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim identifikimin e pronës dhe vlerësimin e saj. Drejtoria e Menaxhimit Financiar të marrë masat e duhura për përditësimin e regjistrit të aktiveve, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të miratuar për të ulur riskun e shpërdorimeve të pasurive publike dhe mirëmenaxhimin e tyre.

- Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, të kryhet analiza e situatës për mospërbushjen e procesit të inventarizimit të aktiveve me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive, marrjen e masave përkatëse për punonjësit të cilët nuk kanë zbatuar urdhërin e titullarit të Njësisë si dhe të kryhet procesi i inventarizimit sipas udhëzimit përkatës.

### ***4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik***

Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese (sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

- Bashkia Skrapar të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **405,000 lekë me TVSh** nga OE "D" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2764 prot, datë 30.09.2022, me objekt "Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë", vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë

vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

- Bashkia Skrapar të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **216,600 lekë me TVSh** nga OE "F" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3594 prot, datë 27.12.2022, me objekt "*Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë*", vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Gjithashtu, në përfundim të periudhës së garancisë së punimeve, të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, për të gjithë elementet e projektit, përfshirë puseta elektike, puseta shiu, pemë/fidanë, kuadër komandimi komplet, etj. dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre nga kontraktori.

### **5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Skrapar të marrë të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, në çdo rast të respektohet distancat nga kufiri i pronës, lartësia maksimale e lejuar, ajo e katit përdhe dhe e çatisë, intensiteti maksimal dhe parcela minimale e lejuar.

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar, të marrë masa:

- Për çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkojë të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.

- Përpara miratimit lejeve të sigurohet mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve si: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efencës së energjisë, etj.

- Të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar para miratimit të lejeve të ndërtimit të kërkojë mendimin e autoriteteve përkatëse mbi konformitetin e objektit në zhvillim në raport me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Gjithashtu të kërkojë dhe marrë mendim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi statusin juridik të pronave në zhvillim.

- Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Struktura e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të merren të gjitha masat për të mos lejuar zhvillimin e objekteve në mungesë të dokumentit të fillimit të punimeve, sipas parashikimeve ligjore, si dhe të ushtrojë masat parandaluese dhe administrative të parashikuara, për të gjitha rastet kur konstatohet kjo kundërvajtje.

### **6. Auditim mbi Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

- Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara. Gjithashtu, të marrë masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i punonjësve të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi i përshtatshëm i inspektorit/kryeinspektorit, për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

### **7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë**

marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

- Nga 10 Masa organizative, janë pranuar plotësisht 10 masa organizative, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, dhe **nuk janë zbatuar 6 masa**.

- Nga 13 Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të tyre, janë pranuar 13 masa, 1 masë është pjesërisht e zbatuar, janë zbatuar dy masa dhe nuk janë **zbatuar 10 masa**.

- Nga 13 Masa disiplinore, janë pranuar të 13-ta masat, janë zbatuar 8, **nuk janë zbatuar 5 prej tyre**.

## 1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

### **I. Opinion i Modifikuar për përputhshmërinë:**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

### **Opinion:**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Skrapar janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion:

**1.** Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi si:

- Në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit.

- Në 7 procedura me fondit limit 41,313,973 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj.

- Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet.

- Në 8 procedura me vlerë totale të fondit limit 40,039,475 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimin të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme.

**2.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë”, me vlerë të kontratës 50,628,700 lekë me

TVSh, fituar nga OE “D” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 337,500 lekë (pa TVSh).

3. Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”, me vlerë të kontratës 12,746,600 lekë me TVSh, fituar nga OE “F” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në vlerën 283,600 lekë (pa TVSh).

4. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit, u konstatuan shkelje dhe mangësi të ndryshme, si më poshtë:

- Nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës, parcela minimale e lejuar për zhvillim, lartësia maksimale e lejuar e objektit, si dhe ajo e katit përdhe, në 2 raste;

- Projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, në 3 raste;

- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Skrapar nuk ka kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 2 raste;

- Zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “Njoftimit të fillimit të punimeve”, në 2 raste.

## II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 36/1, datë 10.01.2024 “Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Skrapar”, i ndryshuar me shkresën nr. 36/2, datë 12.02.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Skrapar”, nga data 15.01.2024 deri në datën 23.02.2024, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2023 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P, Përgjegjës Grupi;
2. E.M;
3. M.M;
4. L.K dhe
5. P.XH, anëtarë.

**Objekti dhe qëllimi i auditimit:** Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet

materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Skrapar.

**Identifikimi i çështjes.** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 *“Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”*, duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Skrapar, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Skrapar.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Kryetari i Bashkisë, z. A.M , në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. N.G , Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, etj.

**Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të

vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Skrapar, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e

*detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të



shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

**Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

---

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
  - *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
  - *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
  - *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
  - *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
  - *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
  - *Raportet dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Dokumentimi i auditimit.** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr., datë. Nga ana e Bashkisë Skrapar me shkresën nr., datë është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Skrapar

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Skrapari kufizohet në veri me Bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km<sup>2</sup>. Sipas Censurit, dendësia e popullsisë është 15 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas Regjistrimit Civil dendësia është 22.93 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re e Skraparit ka një reliev të thyer malor, i cili ka një territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha të Shqipërisë apo në emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre. Problematika kryesore e banorëve të Çorovodës ka qenë gjendja e vështirë e rrugës kombëtare Skrapar-Berat.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoaria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.<sup>2</sup>



##### **Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:**

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Çorovodë	Qyteti: Çorovodë
Qëndër Skrapar	Fshatrat: Zogas, Kalanjas, Dhores, Vesesh të, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzhezhë, Slatinjë, Strorë
Bogovë	Fshatrat: Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan
Vëndreshë	Fshatrat: Lavdar, Spatharë, Therepel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro
Çepan	Fshatrat: Çepan, Muzhakë, Rog, Zabërzan i Ri, Zabërzan, Blezënckë, Malind, Muzhënckë, Sevran i madh, Sevran i Vogël, Qeshibes, Strënc, Kakos, Prishtë
Potom	Fshatrat: Potom, Gjergjovë, Koprënckë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrkish, Staraveckë
Leshnjë	Fshatrat: Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Faqekuq, Gostënckë, Leshnjë, Vlushë, Bërsakë
Gjerbës	Fshatrat: Mëlovë, Zaloshnjë, Gjerbës, Ujanik, Gradec, Strafickë, Vishanj, Barçi 1, Barçi 2, Kuç, Rehovë, Grëmsh, Gjogovicë, Floq

2 Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-skrapar/pasaporta-e-bashkise-skrapar/>

<b>Zhepë</b>	<b>Fshatrat:</b> Grevë, Posten, Kovaçanj, Gurazez, Çorrotat, Cericë, Zhepë, Leskovë, Trebël, Dunckë, Rromas, Tërrovë, Dobrenj, Buranj, Luadh, Shpatanj
--------------	--

**Forma dhe mënyra e organizimit:**

Struktura organizative aktuale është miratuar me me VKB nr. 20, datë 29.08.2019, me VKB nr. 65, datë 24.12.2021 dhe ka funksionuar me të njëjtën strukturë për vitin 2022 dhe vitin 2023.

Bashkia Skrapar ka gjithsej 370 punonjës, ndër të cilët: 235 punonjës të Bashkisë Skrapar, 105 punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe 22 punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor. Numri i punonjësve me kontratë sezonale është 8, ndër të cilët 4 punonjës në Bashkinë Skrapar dhe 4 punonjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

**Kuadri ligjor:**

Bashkia Skrapar e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Skrapar është z. A. M. dhe Këshilli Bashkiak i Skraparit përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë mandatar zgjedhjet e datës 28 qershor 2023.

**2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

*2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.*

➤ **Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së.**  
Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Skrapar, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Drejtorja Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve në Bashkinë Skrapar nuk ka hartuar një program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike, si dhe mungon një program strategjik dhe vjetor për trajnimin zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Në Bashkinë Skrapar nuk ka koordinator për MFK dhe koordinator risku. Për vitet 2022 dhe 2023 nuk janë dokumentuar takimet vjetore të GMS. Në Bashkinë Skrapar nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Skrapar nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në Bashkinë Skrapar nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Në Bashkinë Skrapar nuk është miratuar gjurma e auditimit. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit dhe nuk është përfshirë në

rregulloren e brendshme. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

#### Në lidhje me parimin nr. 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”:

- Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Bashkia Skrapar për gjatë periudhës nën auditim 2022-2023, ka ushtruar funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës dhe njësitë vartëse të Bashkisë Skrapar”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9. Për sa i përket hartimit dhe funksionimit të Kodit të Etikës, Bashkia Skrapar për periudhën nën auditim ka funksionuar me “Kodin e Etikës në Bashkinë Skrapar”, të miratuar me Urdhërin e Kryetarit nr. 89 datë 19.05.2020 dhe regjistruar me nr. 1419 prot., datë 19.05.2020, në zbatim të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1, germa b dhe neni 46.

- Nga institucioni nuk ka program trajnim të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat e kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj.

#### Në lidhje me parimin nr. 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”:

- Për vitet 2022 dhe 2023, Bashkia Skrapar ka hartuar dhe miratuar plan-veprimin për kontrollin e brendshëm, i cili përfshin aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

#### Në lidhje me parimin nr. 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”:

- Nga auditimi rezultoi se lidhur me strukturën organizative, Bashkia Skrapar ka ndryshuar strukturën organizative të miratuar me VKB nr. 20, datë 29.08.2019, me VKB nr. 65, datë 24.12.2021 dhe ka funksionuar me të njëjtën strukturë për vitet 2022 dhe 2023.

- Bashkia Skrapar ka gjithsej 370 punonjës, ndër të cilët: 235 punonjës të Aparatit të Bashkisë, 105 punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe 22 punonjës të Ndërmarrjes së Shërbimit Pyjor. Numri i punonjësve me kontratë sezonale është 8, ndër të cilët 4 punonjës në Bashkinë Skrapar dhe 4 punonjës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

- Për vitet 2022 dhe 2023, janë rekrutuar 8 punonjës dhe janë larguar 31 punonjës. Të dhënat tabelore janë paraqitur në anekset bashkëlidhur projekt raportit të auditimit si Aneksi MFK1 dhe MFK2.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

- Për çdo drejtori është përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”:

- Stafit administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA, pjesë e procedurës për përfundimin e statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Skrapar, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore nuk janë hartuar Plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Trajnimet realizohen nga ASPA dhe punonjësit i përzgjedhin vetë temat për të cilat kanë interes. Mos hartimi i planeve vjetore të trajnimeve nuk mundëson një trajnim efektiv të personelit në përputhje me pozicionin në strukturë. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Për sa më sipër, përgjegjësia i takon znj. R.LL me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të bëra në Manualin për MFK, paragrafi 3.1.

- Për Bashkinë Skrapar Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.

- Në Bashkinë Skrapar nuk është caktuar Koordinatori MFK dhe i Riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8/b, neni 27, pika 1, 2. Për sa më sipër mban përgjegjësi z. A.M me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar.

### **Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).**

Bashkia Skrapar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 49 datë 12.03.2021 dhe me nr. 764 prot., datë 12.03.2021, ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik. Referuar Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II, neni 8. Nga ana tjetër, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë procesverbal ku të jenë dokumentuar takimet e GMS realizuar gjatë viteve 2022 e 2023, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nenet 8, 12 dhe 27; si dhe “Manualin për MFK”, Kreu II, kapitulli 2.2.6.

### **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”:**

Në lidhje me parimin nr. 6: “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre”:

- Nga Bashkia Skrapar përcaktohen objektiva sasiore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se është hartuar plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit.

Në lidhje me parimin nr. 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”:

- Nuk janë krijuar në mënyrë të plotë mekanizmat për vlerësimin e riskut.

- Nga Bashkia Skrapar nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, si dhe Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016. Për shkak se Bashkia Skrapar nuk ka Koordinator Risku, përgjegjësia për sa më lart i kalon titullarit të Bashkisë Skrapar, z. A.M , sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8, pika 4.

- Për vitet 2022 dhe 2023, është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut.

- Në Bashkinë Skrapar Drejtoria e Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nga auditimi rezultoi se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Skrapar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2 dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, neni 121 e 122. Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i Bashkisë Skrapar, z. A.M.

Në lidhje me parimin nr. 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”:

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Në lidhje me parimin nr. 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”:

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Në Bashkinë Skrapar për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Spektori i Financës: 1) Manuali i Klasifikimit të llogarive dhe 2) Manuali i pasqyrave financiare.

Spektori i Zhvillimit Urban dhe Kadastrës: Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.20155 “Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre”.

Njësia e Prokurimit: 1) Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël, 2) Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE).

- Institucioni përgjithësisht zbaton rregullat e përcaktuara në “Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të shërbimit arkivor” për ruajtjen e dokumenteve, për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës.

- Bashkia Skrapar ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit, ka miratuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit”, Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit”, shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, me nr. 4469/1 prot., datë 26.12.2019, në zbatim këto të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhërat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, në bazë të së cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet, si dhe në bazë të Urdhërit nr. 189, datë 17.08.2020 me nr. prot. 2557 “Për miratimin

*e Rregullores për administrimin e aktiveve në Bashkinë Skrapar dhe në Njësitë e Varësisë*". Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Skrapar.

- Bashkia Skrapar në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Në lidhje me parimin nr. 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivite të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”:

- Bashkia Skrapar nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Në Bashkinë Skrapar nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Në lidhje me parimin nr. 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”:

- Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedurë janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (UMFE nr. 8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”:**

Në lidhje me parimin nr. 13: “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”:

Bashkia Skrapar ka faqen e saj zyrtare në web me adresë <https://bashkiaskrapar.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me Adresë <https://portavendore.al/bashkia-Skrapar/pasaporta-e-bashkise-Skrapar/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connection security) HTTPS (Hyper Text Transfer Protocol Secure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm.

Në lidhje me parimin nr. 14: “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor”:

- Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

- Në Bashkinë Skrapar është emëruar Koordinatori për Informim dhe Koordinatori i Transparencës konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16.



Çdo informacion dhe njoftim publikohen në web-in e Bashkisë. Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

a. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë);

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Skrapar;

c. Drejtoria Ligjore, e Prokurimeve dhe e Burimeve Njerëzore/Sektori i Burimeve Njerëzore, është përgjegjës për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal.

d. Çdo muaj bëhet akt rakordimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

Në lidhje me parimin nr. 15: “Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm”

- Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.

**V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”:**

Në lidhje me parimin nr. 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”:

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomicitetit, të efikasitetit e të efektivitetit.

- Bashkia Skrapar lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2022 me shkresën me nr. 542 prot., datë 28.02.2023. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet problematikat në 5 komponentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.

Në lidhje me parimin nr. 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”, “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”:

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve, nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1, germa b, neni 46, neni 15, neni 16; Manuali për MFK, Kreu, 3, paragrafi 3.1., Kreu II, kap. 2.2.6, kapitulli V; Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8/b, neni 12, neni 27,

pika 1.2., neni 21, pika 2, neni 8, pika 4, neni 16 pika 2 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, nenet 121 e 122, **duke ngarkuar me përgjegjësi:**

**Z. A.M, kryetar i Bashkisë Skrapar.**

**Znj. R.LL, drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve.**

**2.1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm.**

**2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i veprimtarisë dhe përbërjes së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, u konstatua se: NJAB e Bashkisë Skrapar përmban vetëm një punonjës nga tre që parashikon pika 3 e VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Dosjet e auditimit të brendshëm të realizuar nga NJAB nuk arkivohen në Arkivin e Njësisë Vendore. NJAB Skrapar nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit të njësive të menaxhimit të Bashkisë Skrapar. Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr. 1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Për ngritjen e strukturës së Auditimit të Brendshëm, NJAB Skrapar është miratuar me VKB nr. 7, datë 27.8.2019 “Për rishikimin e buxhetit dhe të numrit të punonjësve të B. Skrapar” dhe me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 29.08.2020 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave Bashkine Skrapar dhe njësive në varësi të saj”, i ndryshuar me Vendimin nr. 20/1, datë 18.02.2020. Për vitet 2022 dhe 2023, struktura e NJAB pranë Bashkisë Skrapar ka funksionuar me vetëm një auditues, znj. D.S , me detyrë Përgjegjës i NJAB, në kundërshtim me VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Miratimi i Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 3, pika 3. Për vitin 2022 dhe 2023 nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Skrapar, janë kryer auditimet si më poshtë:

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performace	Tjetër
2	Viti 2022	5	5	5	-	-	-	-
3	Viti 2023	5	5	4	-	1		

- Plani strategjik 2023-2025 është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën me nr. 2925 prot., datë 18.10.2022. Plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 344/1 prot., datë 09.02.2022.

- Plani vjetor i auditimeve për vitin 2023 është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 43 prot., datë 09.01.2023.

- Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 373 prot., datë 13.02.2023.

- Për aktivitetin e NJAB për vitin 2023, është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 468 prot., datë 13.02.2024.

- Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Skrapar me shkresën nr. 329 prot., datë 08.02.2017 dhe përditësuar me shkresën nr. 2680 prot., datë 22.9.2022.

- Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë 23 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Dy rekomandime janë zbatuar, ndërsa 21 rekomandime janë në proces zbatimi.

- Nga auditimi i raportimit për vitet 2022 dhe 2023, rezulton se janë dhënë 22 rekomandime, ndër të cilat 3 janë zbatuar, 13 rekomandime janë në proces dhe 6 nuk janë zbatuar.

Në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Periudha	Të dhëna sipas raportimit							
	Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
	Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	Gjithsej	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
Viti 2022	23	2	21	-	-	-	-	-
Viti 2023	22	3	13	6	-	-	-	-
TOTALI	45	5	34	6	-	-	-	-

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 12, pika b dhe neni 13.
- Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Skrapar me urdhërin nr. 5720 prot., datë 20.11.2018.
- Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022-2024 dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuara në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.
- Plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 dhe vitin 2023 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2. të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.
- Struktura e Raportit mbi Veprimtarinë Vjetore të NJAB për vitin 2022, dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, është përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me modelin e parashikuar në aneksin e kapitullit IV të MAB.
- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, në kundërshtim me paragrafin 6.3., Kreu 6, të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
- Në 10 dosjet e auditimit të realizuara në vitet 2022 dhe 2023, u konstatua se struktura e dojesve dhe dokumentat e procesit të auditimit janë hartuar përgjithësisht në përputhje me anekset e kapitullit IV të MAB.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Miratimi i Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 3, pika 3, **duke ngarkuar me përgjegjësi:**

**Z. A.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar.**

**Znj. D.S, me detyrë përgjegjës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, Bashkia Skrapar.**

## **2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

### **2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore, janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Për vitin 2022 buxheti bazë fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 65 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 908/2, datë 10.01.2022. Buxheti vjetor është miratuar brenda

afateve që përcakton pika e nenit 41 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë VKB në total të ardhurat sipas buxhetit të vitit 2022 janë 688,952 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 104,182 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 127,428 mijë lekë, transfertat specifike ka vlerën 134,477 mijë lekë.

Për vitin 2023 buxheti bazë fillestar vjetor është miratuar me VKB nr. 86, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 951/1, datë 09.01.2023. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton pika e nenit 41 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë VKB në total të ardhurat sipas buxhetit të vitit 2023 janë 661,904 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 73.800 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 181.263 mijë lekë, transfertat specifike ka vlerën 134.821 mijë lekë. Ndërsa shpenzimet në total për vitin 2022 janë parashikuar në shumën 688,952 mijë lekë dhe për vitin 2023 niveli i shpenzimeve është parashikuar në shumën 661,904 mijë lekë.

Të dhënat e planifikimit për vitet 2022-2023 janë paraqitur në Aneksin B1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

### 2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

#### Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e taveve të shpenzimeve sipas programeve.

Bazuar në dokumentet e paraqitura (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat administrohen nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, programet buxhetore afatmesme dhe projekt buxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Për hartimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor nga njësitë vartëse që financohen nga buxheti i Bashkisë dhe nga Drejtoritë e Bashkisë janë përgatitur kërkesat buxhetore lidhur me nevojat dhe objektivat.

Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Skrapar, për periudhën 2022-2024 janë miratuar me VKB-të si më poshtë:

Për vitin 2022, buxheti është miratuar me VKB nr. 65 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 908/2, datë 10.01.2022, për vlerën **323,886,100 lekë**. Miratimi i buxhetit vjetor për vitin 2023 është realizuar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Krahasimi i planit përfundimtar buxhetor për vitin 2022 me PBA 2022-2024 është paraqitur Aneksin B2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej **55,149 mijë lekë** nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar është pasqyruar rritja fondit të pagave në shumën 5,888 mijë lekë e cila ka ardhur si rezultat i VKM nr. 158, datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, nga shtesat për shpenzime buxhetore nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar për llogarittë 602, 604, 606 dhe 609 në shumën 23,838 mijë lekë, si dhe investimet nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar në shumën 25,423 mijë lekë, të miratuar me VKB përkatëse dhe alokuar pas miratimit të buxhetit fillestar.

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me VKB nr. 86, datë 21.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 951/1, datë 09.01.2023, për vlerën **347,358,978 lekë**.

Miratimi i buxhetit vjetor për vitin 2023 është realizuar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Krahasimi i planit përfundimtar buxhetor për vitin 2023 me PBA 2023-2025 është paraqitur Aneksin B3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej **80,251 mijë** lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja fondit të pagave në shumën 12,473 mijë lekë e cila ka ardhur si rezultat i shkresës nr. 8321, datë 08.05.2023 e Ministrisë së Financave, “Akordim fonde për rritjen e pagave për funksionet Sektoriale” në Zbatim të VKM nr. 241 datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 175, datë 08.03.2027”, nga shtesat për shpenzime buxhetore nga të ardhurat e grant të pakushtëzuar për llog. 602, 604, 606 dhe 609 në shumën 24,546 mijë lekë, si dhe investimet nga të ardhurat e grant të pakushtëzuar në shumën 42,230 mijë lekë, të miratuar me VKB përkatëse dhe alokuar pas miratimit të buxhetit fillestar.

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime janë paraqitur në Aneksin B4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime janë paraqitur në Aneksin B5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Referuar të dhënave mbi ndryshimet buxhetore për secilin vit 2022 dhe 2023, rezulton se në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan-buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

### 2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për vitin **2022** planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **689,416 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **640,379 mijë lekë** me një diferencë në vlerën **49,036 mijë lekë**, ose në masën **93%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar në vlerën 16,921 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 10,987 mijë lekë ose në masën 65%. Gjithashtu zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 11%, pasi janë planifikuar investime në shumën 225,727 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 200,779 mijë lekë ose në masën 89%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 79,327 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 71,920 lekë, ose në masën 91%.

Në mënyrë të detajuar planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime për vitin 2022 është paraqitur në Aneksin B6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për vitin **2023** planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **662,726 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **579,917 mijë lekë** me një diferencë në vlerën **82,088 mijë lekë**, ose në masën **88%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar në vlerën 13,803 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 5,158 mijë lekë ose në masën 37%. Gjithashtu zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 38% pasi janë planifikuar investime në shumën 154,708 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 117,212 mijë lekë ose në masën 68%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 104,841 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 75,119 lekë, ose në masën 72%.

Në mënyrë të detajuar planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime për vitin 2023 është paraqitur në Aneksin B7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për vitin 2022, duke marrë në konsideratë edhe buxhetin shtesë, shpenzimet në total janë planifikuar në vlerën **689,416 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **640,379 mijë lekë** me një diferencë në vlerën **49,036 mijë lekë**, ose në masën 93%.

Për vitin 2023, duke marrë në konsideratë edhe buxhetin shtesë, shpenzime në total janë planifikuar në vlerën **662,726 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **579,917 mijë lekë** me një diferencë në vlerën **82,808 mijë lekë** ose në masën 88%.

#### Përdorimi i të ardhurave, viti 2022.

Në totalin e shpenzimeve të kryera në fakt për vitin 2022 (në vlerën 671,871 mijë lekë. Shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 77,111 mijë lekë ose në masën 11.5% ( $671,871/77,111 * 100$ ). Duke analizuar vetëm vlerën e të ardhurave të përdorura, pra drejtimi se ku janë shpenzuar të ardhurat e veta për vitin 2022 (të cilat kanë vlerën 77,111 mijë lekë), konstatohet se 67% e tyre është përdorur për zërin investime ( $175437 / 261471 * 100$ ), 32.6% janë shpenzuar në zërin i shpenzime operative dhe 0.4% në zërin paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Pra vihet re se përqindjen më të lartë të shpenzimeve, nga të ardhurat e veta, e zënë shpenzimet për fondin e pagave në shumën 44,806 mijë lekë ose në masën 58.1%, e ndarë për paga në shumën 38,386 mijë lekë ose në masën rreth 50%, sigurime shoqërore në shumën 6,419 mijë lekë ose 8.1% dhe investimet në shumën 15,233 mijë lekë ose rreth 20%.

Zërin më të lartë të shpenzimeve e zënë grantet specifike në shumën 319,907 mijë lekë, nga të cilat shuma prej 175,612 mijë lekë është nga të ardhurat e Ministrisë së Linjës dhe shuma prej 134,304 mijë lekë nga transfertat buxhetore për invalidë dhe ndihma ekonomike. Një peshë

specifike të konsiderueshme zënë edhe grantet e pakushtëzuara të cilat paraqiten në shumën 261,905 mijë lekë.

Të ardhurat për vitin 2022, plan fakt, janë paraqitur në Aneksin B8, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Përdorimi i të ardhurave, viti 2023.

Në totalin e shpenzimeve të kryera në fakt për vitin 2023 (në vlerën 652,589 mijë lekë. Shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 64,484 mijë lekë ose në masën 10% ( $652,589/64,484 * 100$ ). Duke analizuar vetëm vlerën e të ardhurave të përdorura, pra drejtimi se ku janë shpenzuar të ardhurat e veta për vitin 2023 (të cilat kanë vlerën 64,484 mijë lekë), konstatohet se 22.6% e tyre është përdorur për zërin investime ( $14,602/64,484 * 100$ ). Pra vihet re se përqindjen më të lartë të shpenzimeve, nga të ardhurat e veta, e zënë shpenzimet për fondin e pagave në shumën 44,634 mijë lekë ose në masën 69.2%, e ndarë për paga në shumën 38,596 mijë lekë ose në masën rreth 59.9%, sigurime shoqërore në shumën 6,038 mijë lekë ose 9.4% dhe investimet në shumën 13,696 mijë lekë ose rreth 5%.

Një peshë specifike të konsiderueshme zënë grantet specifike në shumën 234,294 mijë lekë, nga të cilat shuma prej 108,041 mijë lekë është nga të ardhurat e Ministrisë së Linjës dhe shuma prej 126,253 mijë lekë është nga transfertat buxhetore për invalidë dhe ndihma ekonomike. Zërin më të lartë të shpenzimeve e zënë grantet e pakushtëzuara të cilat paraqiten në shumën 316,085 mijë lekë.

Të ardhurat për vitin 2023, plan fakt, janë paraqitur në Aneksin B9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga sa më sipër konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore të Bashkisë Skrapar për vitet 2022 dhe 2023 nga të ardhurat e veta ka diferenca të dukshme. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, si një nga zërat kryesorë të shpenzimeve për secilin vit respektiv buxhetor, në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e buxhetit. Mosarritja e pritshmërive vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Skrapar në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Këto veprime nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika a) e nenit 5, neni 37 dhe neni 46; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 15, 27 dhe 32, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3., gërma “c”.

Nga auditimi në lidhje me monitorimin, mbikëqyrjen dhe dërgimin e raporteve periodike në Ministrinë e Linjës dhe paraqitjen e këtyre raporteve në Këshillin Bashkiak, rezulton se, nuk janë hartuar e dërguar raportet periodikë 4-mujorë të monitorimit për zbatimin e buxhetit për asnjë nga vitet 2022 dhe 2023. Pra Bashkia Skrapar nuk ka informuar Këshillin Bashkiak dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, UMFE nr. 9, datë 20.03.2023 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 133, pika 270, UMFE nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 116.

#### **2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

Raportimi i detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Skrapar nuk ka shlyer në kohë detyrimet ndaj të tretëve si rezultat i kontratave. Për vitin 2022 vlera e këtyre detyrimeve është llogaritur nga vetë njësia vendore. Bazuar në shkresën nr. 921 prot., datë 23.02.2022, Bashkia Skrapar ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura në vlerën **19,432 mijë lekë** për vitin 2021 dhe për vitin 2022 ka raportuar në MFE detyrime të prapambetura në vlerën **18,533 mijë lekë**.

Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Skrapar në datën 31.12.2022, sipas raportimit në MFE, janë paraqitur në Aneksin B10, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për vitin 2022 vlera e këtyre detyrimeve është llogaritur nga vetë njësia vendore. Bazuar në shkresën nr. 921 prot, datë 23.02.2022, Bashkia Skrapar ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën **18,533 mijë lekë** për vitin 2022 dhe për vitin 2023 ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën **14,055 mijë lekë**.

Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Skrapar në datën 31.12.2023, sipas raportimit në MFE, janë paraqitur në Aneksin B11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Vendimet gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 3,926 mijë lekë ose rreth 21.2% mbi totalin e detyrimeve të raportuara në shumën 18,533 mijë lekë, si dhe nuk ka patur asnjë likuidim gjatë vitit.

Gjatë periudhës ushtrimore 2023, ka patur shtesa detyrimesh nga vendimet gjyqësore në vlerën 2,150 mijë lekë. Gjatë kësaj periudhe është likuiduar vlera 1,059 mijë lekë. Mbetet pa likuiduar në fund të vitit vlera prej 5,018 mijë lekë ose rreth 35,7% mbi totalin e detyrimeve të raportuara në shumën 14,055 mijë lekë. Kjo situatë tregon një rritje të nivelit shpenzues të detyrimeve si rezultat i vendimeve gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës dhe 1A met e punonjësve nga puna, si të padrejta, të cilat çenojnë fondet e buxhetit të Bashkisë Skrapar dhe buxhetit të shtetit.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 55 “Problemet financiare”, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, UMF nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 29, 59, 60, 61.

Faturat e palikuiduara për vitet 2022 dhe 2023, të cilave u ka kaluar afati i likuidimit prej 60 ditësh:

Nga dokumentet e analizuara, të paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Skrapar, për vitin 2022, deri në datën 31.12.2022, rezultojnë pa u likuiduar 38 fatura për shërbime dhe investime, në **vlerën 69,200,275 lekë**, ndërsa për vitin 2023, deri në datën 31.12.2023, rezultojnë pa u likuiduar gjithsej 9 fatura për shërbime dhe investime në **vlerën 32,099,056 lekë**, sipas tabelës më poshtë:

Periudha	Llog. 602		Llog. 230+231		Shuma	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Viti 2022	22	2,739,705	16	66,460,570	38	69,200,275
Viti 2023	4	1,222,904	5	30,876,152	9	32,099,056

#### 2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për financimet nga Ministrinë e Linjës, FZHR dhe donatorë të tjerë, për periudhën objekt auditimi janë lidhur gjithsej 3 kontrata në vlerën 113,912 mijë lekë, nga të cilat:



Për kontratat e vitit 2022 në vlerën 70,745 mijë lekë. Financuar në vitin 2022 vlera prej 70,745 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2023 e në vijim vlera prej 0 mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 0 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2023 në vlerën 43,167 mijë lekë. Financuar në vitin 2023 vlera prej 21,026 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2023 vlera prej 0 mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 0 mijë lekë (*është kontratë dy vjeçare 2023-2024*).

Për financimet nga buxheti Bashkisë Skrapar dhe Grantet, janë lidhur për periudhën objekt auditimi gjithsej 14 kontrata në vlerën 35,552 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2022 në vlerën 9,684 mijë lekë është financuar në vitin 2022 vlera prej 9,684 mijë lekë, pra janë likuiduar në kohë.

Për kontratat e vitit 2023 në vlerën 25,868 mijë lekë, janë financuar në vitin 2023 vlera prej 16,551 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2023 vlera prej 0 mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 9,316 mijë lekë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave në Bashkinë Skrapar, z. N.G.

Fondi rezervë dhe i kontigjencës:

Me miratimin e buxhetit është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, të cilat si për vitin 2022, ashtu edhe për vitin 2023 janë miratuar në vlerën 1,200 mijë lekë, të cilat nuk janë përdorur për fatkeqësi natyrore dhe ushqime për familjet e dëmtuara nga tërmeti, në zbatim të VKM-së nr. 329 datë 16.05.2020 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare*".

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Skrapar:

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Skrapar nuk marrë subvencion për periudhën objekt-auditimi.

***2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.***

Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tariva Vendore, Bashkia Skrapar.

Për periudhën 2022-2023, struktura është miratuar me VKB nr. 20, datë 29.08.2019, e ndryshuar me VKB nr. 20/1, datë 18.02.2020, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Berat me shkresën nr. 1129/1 prot., datë 06.01.2021. Me vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 01, datë 05.01.2021 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i taksave dhe tarifave vendore (në vijim STTV) dhe me vendimet e Kryetarit të Bashkisë janë bërë ndryshimet si rezultat i ndryshimeve të përcaktimeve të pagave referuar VKM-ve përkatëse.

STTV është në varësi të Drejtorisë së Ekonomisë, Financës, Tatim-Taksave dhe Shërbimeve. Ky sektor ka në përbërjen e tij, 1 përgjegjës sektori, 1 specialist i të ardhurave, 1 inspektor i taksave dhe 1 inspektor i kontrollit dhe administrimit të tregut. Gjithashtu në çdo njësi administrative është i punësuar 1 inspektor i taksave, por që nuk kanë varësi organizative nga STTV.

Struktura e STTV Bashkia Skrapar dhe inspektorët e taksave pranë NJA-ve, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë periudhës 2022-2023 janë paraqitur në Aneksin A1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

STTV Bashkia Skrapar, për periudhën 2022-2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Skrapar nga taksat dhe tarifat (me përjashtim të të ardhurave nga disa taksa dhe tarifa, si: taksa e ndikimit në infrastrukturë, tarifa e parkimit, tarifa

për shërbime administrative të urbanistikës, shërbime nga institucione të kulturës, tarifa e konviktit, çerdheve, kopshteve, qiratë për fondin pyjor/kullosor, etj). Ky sektor në aktivitetin e tij për planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave duhet të bashkëpunojë edhe me drejtori/sectorë të tjerë pranë bashkisë, si ai i kadastrës, urbanistikës, veterinarisë, ndërmarrjen e shërbimit pyjor, etj. Për sa më sipër sugjerojmë që të shikohet mundësia në parashikimin e buxhetit në vijim, që struktura për Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit dhe përgjegjësisë së saj, të krijohet dhe administrohet në nivel Drejtorie.

Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Skrapar:

Gjatë periudhës 2022-2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, me VKB nr. 64, datë 24.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale”, e cila nuk ka pësuar ndryshime derit në fund të vitit 2023. Paketa fiskale është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 908/2 prot., datë 10.01.2022.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2022 dhe 2023, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përlllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar qartë sektori që do të bëjë përlllogaritjen dhe sektori që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në disa raste për vjeljen e taksave dhe tarifave të ndryshme ngarkohen njëkohësisht më shumë se dy struktura. Situata e mësipërme ndikon negativisht në aktivitetin e bashkisë në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, pasi krijohet mundësia për mbivendosje të funksioneve, mosidentifikim të saktë të përgjegjësisë në lidhje me veprimet/mosveprimet, paqartësi dhe vonesë në zbatimin e paketës fiskale etj. Mangësitë e mësipërme janë konstatuar në taksën e tokës bujqësore, truallit, ndikimit në infrastrukturë (nuk përcaktohet se cili sektor përlllogarit taksën), pronën pyll dhe kullotë, tarifa e lejeve për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme, licencimi i veprimtarive të transportit, tregtimin e karburantit etj. Në përcaktimin e paketës fiskale rezulton se në pikën 1.7., Taksa e përkohshme për pronën pyll e kullotë, nuk është përcaktuar në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 13, pika 2, gërma b, duke mos ndryshuar taksat e përkohshme, e cila është me afat dhe duhej ndryshuar. Ky ndryshim nuk është bërë për vitin 2022 por është ndryshuar për aplikimin e tarifave për vitin 2024, i cili nuk është objekt auditimi si periudhë. Gjithashtu rezulton se në pikën 2.18., tarifa për dhënie leje zhvillim aktiviteti pas orës 23, nuk është përcaktuar në përputhje me urdhërin nr. 99, datë 10.02.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, refuzuar edhe nga Prefekti i Qarkut Berat. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, shkronja “f” dhe neni 20.

Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Skrapar, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur 39 lloje taksash dhe tarifash.

Për periudhën 2022-2023 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Skrapar dhe NJA, ndahen në 3 kategori: 1. Biznes; 2. Familjar dhe 3. Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

- Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël;
- Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionistë, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalidët, etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2022	2023
1	Biznesi i Madh	92	98

2	Biznesi i Vogël	163	150
3	Ambulant	0	0
4	Institucione	16	16
6	Familje	7,864	7,889

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Të gjitha të ardhurat, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në mijë lekë, për periudhën 2022-2023, mbi parashikimin dhe realizimin e tyre janë paraqitur në Aneksin A2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Tabela përmbledhëse për njësinë qëndër dhe njësitë e varësisë planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për vitin 2022-2023, është paraqitur në Aneksin A3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **60,916,653** lekë dhe janë realizuar në vlerën **87,103,820** lekë ose 143%, pra një nivel i realizimit, me 26,187,167 lekë më shumë nga plani. Ky tejkalim i realizimit të të ardhurave ka ardhur si rezultat i blerjes së një autoboti në shumën 9,990,750 lekë si grant i Qeverisë Japoneze, shuma prej 1,147,236 lekë e cila ka ardhur si rimbursim shpenzimesh nga projekti “Lessvaste”, në shumën 17,231,118 lekë të ardhura nga ndërmarjet dhe pronësia, për kontratat e qirave pyll e kullota të cilat nuk ishin parashikuar si të ardhura për vitin 2022 dhe nuk u vendos dokumentacion se nga cilat parcela apo prona është kjo e ardhur. Gjithashtu në shumën 10,785,150 lekë nga të cilat shuma prej 387,200 lekë janë sponsorizime ndërsa diferenca prej 10,397,950 lekë janë të ardhura të tjera të cilat nuk kanë të përcaktuar destinacionin se nga vijnë këto të ardhura.

Për vitin 2023 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **66,984,764** lekë dhe janë realizuar në vlerën **64,484,901** lekë ose 96%, me një nivel të ulët të realizimit, me 2,499,863 lekë më pak nga plani. Në tabelën e të dhënave të vëna në dispozicion vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash nuk planifikohet arkëtim, pavarësisht se në vitin e kaluar janë realizuar të ardhura, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga qiratë, taksë tabele nga subjektet fizike, taksa për zënien e hapësirë publike, taksë transporti, tatim nga të ardhurat personale etj., për të cilat administrohen kontrata të lidhura ndërmjet palëve dhe në këto kushte planifikimi i vlerës që do të arkëtohet është i mundshëm. Nga tarifa e licencimit për ushtrimin e veprimtarisë në tregtimin e karburanteve, në vitin 2023 nuk janë planifikuar fonde për t’u arkëtuar, gjithashtu tarifa për rafting nuk aplikohet edhe pse është mëse e ditur që për shkak të ofrimit të këtij sporti atraktiv të njohur në këtë zonë, dihet që çdo vit sjell një numër të konsiderueshëm të përvojës në këtë lloj sporti për vetë zonën që ofrojnë kanionet e lumit Osum.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave”, Kreu IV, pika 200, dhe UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

**Për sa më sipër mbanë përgjegjësi:**

**Znj. H.B , ish Përgjegjës i STTV, konceptuese e paketës fiskale dhe grupi i krijuar për hartimin e paketës fiskale.**

- Debitorët sipas kategorive:

Të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për abonentët

familjarë dhe abonentët privatë, janë paraqitur në Aneksin A4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, ku jepet ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, si dhe të trashëguar nga vitet e mëparshme.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultoi se: Në fillim të vitit 2022 shuma debitorë progresive e trashëguar paraqitet në vlerën 85,872 mijë lekë. Zërin kryesor të debitorëve e zë kategoria familjare, e cila paraqitet në shumën e mbartur progresive prej 82,834 mijë lekë, e cila vetëm për vitin 2022 është shtuar në shumën 7,026 mijë lekë. Në krahasim me fundin e vitit 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitorë me 10,634,682 lekë dhe shuma në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 95,197 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022 vlera debitorë e krijuar është 9,324,913 lekë dhe vlera debitorë e krijuar gjatë vitit 2023 është 10,634,682 lekë. Zërin kryesor të debitorëve e zë kategoria familjare, e cila paraqitet në shumën e mbartur progresive prej 96,805 mijë lekë, e cila vetëm për vitin 2023 është shtuar në shumën 6,934 mijë lekë.

Në raport me vitin 2022 vlera debitorë e krijuar brenda vitit 2023 është 1,309,769 lekë më shumë nga vlera e krijuar gjatë vitit 2022. Shuma totale progresive e debitorëve në fund të vitit 2013 paraqitet në vlerën 105,832 mijë lekë.

Situata e mësipërme tregon për një shtim të treguesit nga viti 2022 në vitin 2023, por nëse i referohemi të dhënave në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023, rezultojnë një punë jo efektive në kohë e Bashkisë Skrapar ku pjesa më e madhe vjen si rezultat i IA mit të IA mit të disa familjeve tatim paguese nga territori i Bashkisë Skrapar, në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

- Kategoria “Biznes”:

Për periudhën 2022-2023, grupi i auditimit vlerësoi veprimtarinë e STTV Bashkia Skrapar në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtje infrastrukture. Nga auditimi u konstatua se në 43 raste subjekte të kategorisë “biznes i madh” dhe “biznes i vogël” në NJA Çorovodë Qendër, Bogovë dhe Gjerbës, janë taksuar saktë/aspak, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet për tarifën dhe taskat vjetore, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar në vlerën 3,263,037 lekë, deri në 31.12.2023.

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi**, Zj.H.B përgjegjëse e STTV, z. G.H Inspektor i taksave në NJA Qendër; z. N.K, Inspektor i taksave në NJA Bogovë; z. N.D, Inspektor i taksave në NJA Vëndreshë; z. S.B, ish-Inspektor i taksave në NJA Çepan deri me datë 31.08.2022, zj. F.B, Inspektor i taksave në NJA Çepan për periudhën 01.09.2022-31.12.2023, znj. E.O, Inspektore e taksave në NJA Potom; z. L.B, Inspektor i Taksave në NJA Leshnjë; z. F.L, Inspektor i taksave në NJA Gjerbës dhe z. TH.SH, Inspektor i taksave në NJA Zhepë.

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale (banim ose e kombinuar), objekt legalizimit:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Skrapar në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa

leje, nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Skrapar, nuk ka detyrime të paarkëtuara të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Të dhënat për Taksën e ndërtimit në Infrastrukturë për vitin 2022 janë paraqitur në Aneksin A5 dhe të dhënat për Taksën e ndërtimit në Infrastrukturë për vitin 2023 janë paraqitur në Aneksin A6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Skrapar për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitore, si dhe nuk ka evidentuar raste që Bashkia Skrapar t'i jetë drejtuar ASHK Dega Skrapar, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për abonentët familjarë dhe abonentët privatë paraqitet si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion për administrimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, për debitorët familjarë të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat në Bashkinë Skrapar rezulton një shumë e konsiderueshme e gjeneruar nga vitet e mëparëshme por edhe detyrime të cilat janë gjeneruar gjatë viteve objekt auditimi, pra vitit 2022 dhe vitit 2023, në vlerën progresive totale 64,997,116 lekë, e cila është paraqitur e detajuar në Aneksin A7 dhe A8, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 6,111 familje debitore për vlerën 64,708,144 lekë. Nga këto në fillim të vitit 2022 debia ka qënë në shumën 60,510,522 lekë, janë maturuar gjatë vitit 2022, në shumën 8,123,288 lekë nga të cilat janë likuiduar shuma prej 3,636,694 lekë dhe kanë mbatur pa u arkëtuar për vitin 2022 në shumën 4,486,594 lekë, ndërkohë që shuma totale debitore progresive paraqitet në vlerën 64,997,116 lekë.

Në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 6,111 familje debitorë për vlerën 69,276,330 lekë. Nga këto në fillim të vitit 2023 debia ka qënë në shumën 60,510,522 lekë, janë maturuar gjatë vitit 2022, në shumën 8,123,288 lekë nga të cilat janë likuiduar shuma prej 3,636,694 lekë dhe kanë mbetur pa u arkëtuar për vitin 2022 në shumën 4,486,594 lekë, ndërkohë që shuma totale debitore progresive paraqitet në vlerën 64,997,116 lekë. Kjo rritje nga viti i mëparshëm deri në 31.12.2023, vjen si rezultat i mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e të ardhurave nga debitorët e cila gjatë vitit 2023 është rritur në shumën 4,711,412 lekë. Si përfundim në fund të vitit 2023 shuma progresive prej 69,276,330 lekë përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Skrapar, nga të cilat për shuma prej 4,711,412 i përket vitit 2023. Peshën më të madhe të familjeve debitore e ka NJA Qendër, Çepan, Bogovë dhe Zhepë, duke vijuar me NJA Potom, Vëndreshë, Gjerbës, Leshnje dhe Çorovodë. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me probleme, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre, me qëllim arkëtimin e kësaj takse.

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:** zj.H.B përgjegjëse e STTV, Z. G.H, Inspektor i taksave në NJA Qendër; z. N.K, Inspektor i taksave në NJA Bogovë; z. N.D, Inspektor i taksave në NJA Vëndreshë; z. S.B, ish-Inspektor i taksave në NJA Çepan deri me datë 31.08.2022; zj. F.B, Inspektor i taksave në NJA Çepan për periudhën 01.09.2022-31.12.2023, znj. E.O, Inspektore e taksave në NJA Potom; z. L.B, Inspektor i Taksave në NJA Leshnjë; z. F.L, Inspektor i taksave në NJA Gjerbës dhe z. TH.SH, Inspektor i taksave në NJA Zhepë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 3, neni 3, pikat 1 dhe 2; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 42, pika 2; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6, pika 3, neni 76, pika 2, neni 89, neni 117, Paketa Fiskale e Bashkisë Skrapar, kreu I dhe kreu II dhe neni 67 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Skrapar.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4, datë 19.04.2024, nga z. A.M, Kryetar i Bashkisë, dhe znj. H.B , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me Projektraportin e Auditimit mbi drejtimin nr. 2.2.6, janë paraqitur pretendimet se niveli i ulët i realizimit të investimeve nuk ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve poër për shkak të vonesave lidhur me procedurat e tjera deri në momentin e lidhjes së kontratës. Diferenca e planifikimit dhe realizimit të të adhurave vjen si rezultat i LA mit të familjeve tatim paguese nga territori i Bashkisë Skrapar. Problematikat e moslikuidimit të faturave vjen si rezultat i akordimit me vonesë të fondeve buxhetore. Paraqiten objeksione në lidhje me strukturën e STTV, për përgjegjësinë e kësaj strukture, gabime të të dhënave të paraqitura gjatë auditimit në terren, për të ardhurat personale të planifikuara dhe të realizuara, LA min e familjeve nga territori i Bashkisë Skrapar e cila sjell pamundësi të vjeljes së të ardhurave, etj, pretendime të cilat janë paraqitur edhe për aktkonstatimin e mbajtur për këtë pikë.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se, nga pretenduesit janë paraqitur thujtse të njëjtat pretendime të cilat janë paraqitur edhe për aktkonstatimet e mbajtura, për të cilat grupi i auditimit i ka sqaruar në Projektraportin e Auditimit. Nga sa më sipër pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

**2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

**2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

**2.3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Nga Bashkia Skrapar, u vendos në dispozicion të grupit të auditimit urdhëri i procesit të inventarizimit me nr. 478 prot., datë 13.11.2023, me komisionin e përbërë nga znj. I.O, kryetare e komisioni me detyrë inspektore e menaxhimit të asetëve, dhe anëtarët znj. A.K, me detyrë Përgjegjës i sektorit të Arsimit, Sportit dhe Kulturës dhe znj. A.G, me detyrë Specialiste e Financës, në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave. Në këtë urdhër citohet se ky komision do të kryejë procesin “Për inventarizimin e aktiveve qarkulluese në institucionin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet vartëse të saj, të qytetit Çorovodë”.

Fletët e inventarit të:

- |                                     |  |
|-------------------------------------|--|
| 1. Administratës së Bashkisë        | 12. Kopështit “2-Dhjetori”                                     |
| 2. Sektorët ndihmës                 | 13. Gjimnazi “Ramiz Aranitasi”                                 |
| 3. Njësisë Administrative Potom     | 14. Kopështi “5 Shtatori”                                      |
| 4. Njësisë Administrative Bogovë    | 15. Muzeut   |
| 5. Njësisë Administrative Zhepë     | 16. Qendrës Alternative  |
| 6. Njësisë Administrative Leshnjë   | 17. Konviktit  |
| 7. Njësisë Administrative Çepan     | 18. Qendrës Kulturore të Fëmijëve                              |
| 8. Njësisë Administrative Vëndreshë | 19. Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi,<br>(PMNZSH) |
| 9. Njësisë Administrative Gjerbës   | 20. Shkollës “Karaman Ylli”                                    |
| 10. Njësisë Administrative Qëndër   | 21. Shkollës “Zylyftar Veleshja”                               |
| 11. Çerdheve                        | 22. Qendrës Kulturore  |

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua se:

1. Në fletet e inventarit të Adminstratës së Bashkisë, rezultoi se për zyrën “Me një ndalesë”, persona përgjegjës për materialet janë znj. A.K , z. I.D dhe z. E.SH. Pra rezultoi se znj. A.K ka nënshkruar edhe në cilësinë komisionit të inventarizimit edhe në cilësinë e punonjësit me përgjegjësi materiale. Gjithashtu rezultoi se nuk rakordon shuma totale e të dhënave kontabël e cila është në vlerën 1,064,627 lekë, me shumën totale me të dhënat sipas fletës së inventarit në vlerën 1,170,983 lekë me një tepricë në vlerën 106,356 lekë. Gjithashtu në fletën me përgjegjës material zj. A.K është nënshkruar edhe nga komisioni i inventarizimit edhe nga vetë personi me përgjegjësi materiale. Rezultoi se nuk rakordon shuma totale e të dhënave kontabël e cila është në vlerën 1,117,561 lekë me shumën totale me të dhënat sipas fletës së inventarit në vlerën 1,223,917 lekë me një tepricë në vlerën 106,356 lekë. Në fletën e inventarit për Serverin, rezultoi se kjo fletë është nënshkruar vetëm nga komisioni i inventarizimit dhe nuk ka të përcaktuar person me përgjegjësi materiale (pa emër). Në fletën e inventarit të sekretares znj. XH.Ç, rezultoi se nuk rakordon shuma totale e të dhënave kontabël e cila është në vlerën 714,173 lekë me shumën totale me të dhënat sipas fletës së inventarit në vlerën 739,048 lekë me një tepricë në vlerën 24,875 lekë.
2. Njesisë Administrative Potom, ku rezultoi se Fleta e inventarit të shkollës “Qafë”, në vlerën 87,316 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës “Staraveckë”, në vlerën 24,700 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër).
3. Në fletet e inventarit të Njesisë Administrative Leshnjë, rezultoi se fleta e inventarit të bibliotekës së shkollës “Leshnjë”, në vlerën 11,556 lekë nuk është e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës fillore “Gostenckë”, në vlerën 12,604 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër).
4. Në fletet e inventarit të Njesisë Administrative Çepan, rezultoi se fleta e inventarit të bibliotekës së shkollës “Çepan”, në vlerën 5,490 lekë nuk është e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të cilkit të ulët në vlerën 87,728 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës fillore “Blezencke”, në vlerën 15,540 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës fillore “Lulart Dingo”, në vlerën 89,307 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër).
5. Në fletet e inventarit të Njesisë Administrative Qëndër, rezultoi se në një nga fletët e inventarit nuk është nënshkruar nga dy prej anëtarëve të komisionit konkretisht nga zj. A.K dhe nga zj A.G si dhe nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës “Veleshnjë”, në vlerën 10,680 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës “Sharovë”, në vlerën 32,850 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës “Dhores”, në vlerën 32,500 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të kopështit “Radësh”, në vlerën 88,100 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të shkollës “Gradec”, në vlerën 50,376 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Fleta e inventarit të kopështit “Dhores”, në vlerën 77,756 lekë nuk rezultoi të jetë e nënshkruar as nga komisioni

i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër). Gjithashtu fleta e inventarit të kopështit Çerenisht në vlerën 57,540 lekë nuk është e nënshkruar as nga komisioni i inventarizimit dhe as nga personi me përgjegjësi materiale (pa emër).

6. Në fletet e inventarit të Çerdhes, rezulton një tepricë totale në shumën 10,800 lekë për të cilën nga komisioni nuk pasqyrohet se nga vjen kjo tepricë.

7. Në fletet e inventarit të Kopështit “2-Dhjetori”, rezulton se në një nga fletët e inventarit të materialeve në ngarkim dhe si person përgjegjës zj. E.H, në shumën 2,514,173 lekë, është nënshkruar vetëm nga personi përgjegjës dhe nuk është nënshkruar nga asnjë nga anëtarët e komisionit të inventarizimit.

8. Në fletet e inventarit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, (PMNZSH), rezulton një tepricë totale në shumën 174,927 lekë për të cilën nga komisioni nuk pasqyrohet se nga vjen kjo tepricë.

9. Në fletet e inventarit të shkollës “Karaman Ylli”, rezulton një tepricë totale në shumën 294,780 lekë për të cilën nga komisioni nuk pasqyrohet se nga vjen kjo tepricë.

10. Në fletet e inventarit të shkollës “Zylyftar Veleshja”, rezulton një tepricë totale në shumën 847,656 lekë për të cilën është shtuar një kompjuter desktop në vlerën 119,040 lekë dhe pjesa tjetër prej 728,616 lekë për të cilën nga komisioni nuk pasqyrohet se nga vjen kjo tepricë.

11. Në fletet e inventarit të Qendrës Kulturore, rezulton një diferencë në mungesë në vlerën 120,000 lekë për të cilën komisioni nuk është shprehur se mungon një jelek në kostumin popullor për burra i cila ka vlerën totale 420,000 lekë sipas fletëve të inventarit dhe është nënshkruar nga komisioni i inventarizimit dhe personi përgjegjës E.G.

Referuar verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe komunikimeve me përfaqësues të Bashkisë Skrapar konstatohet se, nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik z. N.G në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Skrapar pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit.

**Për sa më sipër mban përgjegjësi:** N/A z. A.M dhe N/Z z. N.G.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiare dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Skrapar si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se: Drejtoria Ekonomike në Bashkia Skrapar dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës Informatik”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e



evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3, pikat 14 e 15 dhe neni 11.

Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023, rezultoi se nga Bashkia Skrapar, nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk është hartuar regjistër kontabël i përditësuar për aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj., veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 26-33.

Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit për vitin 2023 në lidhje me zërin (Tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj) të cilat paraqiten në kontabilitetin e Bashkia Skrapar, rezultoi se nga Njësia Autorizues në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Njësia Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Skrapar dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkia Skrapar pasi nuk është kryer inventarizim aktiveve (Tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj.).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe neni 15; Ligji nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për procesin e inventarizimit, titullari i Bashkisë, ka nxjerrë urdhërin e brendshëm nr. 478 prot., datë 13.11.2023 “Për inventarizimin e aktiveve qarkulluese në institucionin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet vartëse të saj, të qytetit Çorovodë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit konstatohet se, në disa raste, fletë inventarët fizikë nuk janë të nënshkruara nga punonjësi me përgjegjësi materiale si dhe nga anëtarët e komisionit. Në urdhërin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitit 2023, si dhe në fletët e inventarit, rezulton se, në komision janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit, në kushtet e konfliktit të interesit. Pra këta punonjës kanë nënshkruar edhe si anëtarë të komisionit të kryerjes së inventarizimit edhe në cilësinë e punonjësit me përgjegjësi materiale. Nga komisioni i inventarizimit rezulton se nuk është hartuar një raport lidhur me procesin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, vërejtjet për diferencat e konstatuara, shkaqet në raste të dëmtimeve, etj, pra nuk është përmbushur detyra e përcaktuar nga titullari i njësisë brenda afateve ligjore.

Për shkeljet e mësipërme të konstatuara ngarkohen me përgjegjësi z. A.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Njësia Autorizues të Bashkisë Skrapar; z. N.G, me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave dhe në cilësinë e Njësia Zbatues të Bashkisë Skrapar; znj. I.O, detyrë inspektore e menaxhimit të aseteve, në cilësinë e kryetares së komisionit të inventarizimit; znj. A.K , me detyrë Përgjegjës i sektorit të Arsimit, Sportit dhe

Kulturës, në cilësinë e anëtares së komisionit të inventarizimit dhe znj. A.G, me detyrë Specialiste e Financës, në cilësinë e anëtares së komisionit të inventarizimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 15 “Inventari i aktiveve e detyrimeve”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve”, pika 81-86.

**Shënim:** Në lidhje me drejtimin e auditimit mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, rezulton se kjo pikë nuk është audituar për arsye se pasqyrat financiare nuk ishin përfunduar nga Bashkia Skrapar, gjithashtu procesi i inventarizimit nuk ishte përfunduar dhe njëkohësisht nuk ishin bërë rakordimet me degën e thesarit Skrapar, për mbylljen e të gjitha llogarive kontabël. Kjo pasi, edhe afati i përfundimit të auditimit në terren ishte me datë 23.02.2024, brenda afatit të cilin subjekti ka për mbylljen e llogarive të Pasqyrave Financiare. Për sa më sipër grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion për pasqyrat financiare, të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë plotësisht dhe saktësisht në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të njësisë.

## 2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

### 2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, shërbime dhe mallra, të cilat janë miratuar me VKB-të përkatëse, bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

### 2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, konstatoi si vijon:

Për vitin ushtrimor 2022, Bashkia Skrapar dhe njësia e saj shpenzuese, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 42 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 97,422,625 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 4,381,579 lekë pa TVSh ose 4.34%, të ndara sipas njësive shpenzuese:

#### Aparati i Bashkisë Skrapar:

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 34 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 85,437,059 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 81,727,973 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 810,219 lekë pa TVSh ose 4.6%, si vijon:

Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratave
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>85,437,059</b>	<b>81,727,973</b>
- Të hapura	1	51,998,778	50,628,701
- Të hapura të thjeshtuara	3	16,138,711	15,876,143
- Të vogla	30	17,299,570	15,223,129
<b>Sipas llojit të objekteve</b>			

<b>Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022</b>	<b>Nr.</b>	<b>Fondi Limit</b>	<b>Vlera e Kontratave</b>
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	2	62,907,348	61,290,851
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	32	22,529,711	20,437,122

### **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:**

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 24 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 17,774,145 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 16,963,026 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 811,119 lekë pa TVSh ose 4.56%, si vijon:

<b>Procedurat e periudhës 01.01.2022-31.12.2022</b>	<b>Nr.</b>	<b>Fondi Limit</b>	<b>Vlera e Kontratave</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>16,367,145</b>	<b>15,694,652</b>
- Të hapura të thjeshtuara	2	13,408,813	13,196,152
- Të vogla	6	2,958,332	2,498,500
<b>Sipas llojit të objekteve</b>			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	0	0	0
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	8	16,367,145	15,694,652

Për vitin ushtrimor 2023, Bashkia Skrapar dhe njësia e saj shpenzuese, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 52 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 96,059,466 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 86,712,434 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 9,347,032 lekë pa TVSh ose 9.73%, të ndara sipas njësive shpenzuese:

### **Aparati i Bashkisë Skrapar:**

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 43 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 78,071,973 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 69,582,602 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 8,489,371 lekë pa TVSh ose 12.2%, si vijon:

<b>Procedurat e periudhës 01.01.2023-31.12.2023</b>	<b>Nr.</b>	<b>Fondi Limit</b>	<b>Vlera e Kontratave</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>43</b>	<b>78,071,973</b>	<b>69,582,602</b>
- Të hapura	1	41,247,773	35,972,535
- E hapur e thjeshtuar	3	9,804,937	9,738,160
- Shërbim Konsulence	1	7,301,480	6,980,000
- Të vogla	38	19,717,783	16,891,907
<b>Sipas llojit të objekteve</b>			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime			
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje			

### **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:**

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve, ka kryer gjithsej 55 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 17,987,493 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate të lidhur prej 17,129,832 lekë pa TVSh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 857,661 lekë pa TVSh ose 4.77%, si vijon:

<b>Procedurat e periudhës 01.01.2023-31.12.2023</b>	<b>Nr.</b>	<b>Fondi Limit</b>	<b>Vlera e Kontratave</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>17,987,493</b>	<b>17,129,832</b>
- Të hapura	2	13,520,827	13,103,171
- Të vogla	7	3,125,000	2,850,910
- Blerje pa procedurë	16	1,341,666	17,129,832
<b>Sipas llojit të objekteve</b>			
- Objekte në fushën e investimeve/ndërtime	0	0	0
- Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	25	17,987,493	17,129,832

U audituan gjithsej 14 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 163,431,389 lekë dhe vlerë të kontratave 113,444,166 lekë ose 79.1% e fondit limit total. Në procedurat e audituara kanë marrë pjesë gjithsej 42 OE/BOE, nga të cilat janë kualifikuar 18 OE/BOE. Me 1 OE kanë qenë gjithsej 6 procedura, ndërsa me 1 OE të kualifikuar kanë qenë gjithsej 12 procedura.

Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, janë paraqitur në Anekset P1-P2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.  
Prokurimet e zhvilluara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, janë paraqitur në Anekset P3-P4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

***2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.***

Referuar nivelit të materialitetit, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 14 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Skrapar dhe njësinë e saj shpenzuese, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, me fond limit 163,431,389 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 113,444,166 lekë pa TVSh, nga auditimi i të cilave u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kriteret jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në mënyrë të përmbledhur, shkeljet e konstatuara janë paraqitur më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 “Dokumentimi i procesit” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

- Në 7 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 41,313,973 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 40,322,656 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës” dhe neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësitë e prokurimit”, pikat 2 dhe 4, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5.

- Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 97,422,625 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret e paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

Vendosja e kriterëve të vlerësimit në mënyrë të paargumentuar apo të papërshtatshme dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, rrjedhimisht në mospërputhje me LPP dhe Rregullat e prokurimit publik, shkel qëllimin dhe parimet kryesore të LPP, siç është nxitja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së shoqërive të vogla e të mesme, trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, etj., konkretisht neni 1, “Objekti”; neni 2, “Qëllimi”; neni 3, “Parime të përgjithshme”, pikat 1 dhe 2; neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”; neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”; neni 41, “Kërkesa të veçanta

për kontratat e shërbimeve”; pika 3; neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2 dhe 5, neni 87, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; etj.

- Në 8 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 40,039,475 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 35,263,160 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Duke shpallur fitues OE/BOE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjes”; neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”; neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2.

Procedurat e audituara të ndara në vlerë sipas problematikave janë paraqitur në Aneksin P5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

### **Procedurat e audituara nga prokurimet e AK “Aparati i Bashkisë Skrapar”, për vitin 2022:**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rigjenerimi urban i zonës afër Gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 32 datë 19.10.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 32 datë 19.10.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 05 datë 19.10.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. B.M, Dr. Ubanistike 2. E.Y, P. Prokurimesh 3. E.H, Juriste	1. A.L, Kryetar 2. R.LL, Anëtar 3. N.G, Anëtar
5. Fondi Limit: 10,908,570 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “F” ShPK, me vlerë 10,662,150 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 3594, datë 27.12.2022, me afat 105 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 246,420 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 17.11.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) Skualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

### **Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:**

Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

### **Fondi limit dhe Projekti:**

- Fondi limit është llogaritur nga Njësia e Prokurimit, e cila ka marrë për bazë projektin e hartuar nga studio e projektimit Dricons.

- Projekti dhe Specifikimet Teknike janë hartuar nga OE Dricons dhe janë miratuar nga titullari i Bashkisë Skrapar.

- Procesverbalë për llogaritjen e fondit limit është mbajtur në datën 17.10.2022, i paprotokolluar.

- Leja e ndërtimit për këtë investim është dhënë me nr. 40, datë 19.01.2023;

- Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 53, datë 29.09.2022 “Për një ndryshim në VKB nr. 65, datë 24.12.2021, “Për miratimin e PBA 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”.

Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbal pa datë dhe pa numër protokolli.

- Në datën 04.11.2022, procedura është anuluar nga APP për argumentimin e përdorimit të fondeve, sipas VKM-së nr. 807, datë 16.11.2016;

- Në datën 11.11.2022, nga NjP është mbajtur procesverbal i paprotokolluar në lidhje me shqyrtimin e rekomandimeve të APP-së, disa nga të cilat janë marrë në konsideratë;

- Në pikën 2.3.2. në DT, krahas të tjerave, kërkohet Licenca e kategorisë NP-4A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaje, metro, pista aeroportuale”, e cila nga grupi i auditimit nuk gjendet e argumentuar dhe e mbështetur në LPP, pasi në preventiv nuk ka zëra për të cilët nevojitet kjo lloj licence;

- Në pikën 2.3.3.a) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 4 inxhinierë të llojeve të ndryshme si drejtues teknikë dhe një inxhinier mekanik (jo drejtues teknik), i cili nga grupi i auditimit konsiderohet i tepërt dhe i panevojshëm për zërat e punimeve sipas preventivit. Gjithashtu, për shkak të natyrës dhe vlerës së kontratës, nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë drejtues teknikë. Kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me kërkesën në pikën 2.3.3.e) në DT, ku kërkohet deklarimi i vetëm një drejtuesi teknik;

- Në pikën 2.3.3.b) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë saldator, i cili nga grupi i auditimit konsiderohet i tepërt dhe i panevojshëm për zërat e punimeve sipas preventivit. Grupi i auditimit mendon se nga AK duhet të ishte kërkuar një elektrikist, pasi në preventiv ka punime elektrike dhe pa një elektrikist nuk garantohet realizimi me sukses i kontratës;

- Në pikën 2.3.3.c) në DT, kërkohet një punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.....”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, neni 10 “Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve”, pika 5.

- Në pikën 2.3.3.d) në DT, kërkohet një punonjës i pajisur me certifikatën “Punonjës i ndihmës së shpejtë”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe e pambështetur në ligj;

- Në pikën 2.3.3.f) në DT, kërkohet një punësim mesatar prej të paktën 31 punonjës, “...përveç stafit drejtues, inxhinierëve të kërkuar në pikën 2.4.1., teknikëve të ndërtimit, si dhe drejtuesve të automjeteve të rënda dhe manovratorëve të kërkuar në pikën 2.4.2....”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e paargumentuar dhe konfuzuese për OE pjesëmarrës, pasi fjala “përveç” do të thotë që në total numri i punonjësve të disponueshëm duhet të jetë 56 persona (5 inxhinierë + 20 punonjës specialistë + 31 punonjës të tjerë). Nga grupi i auditimit, konstatohet se ky numër punonjësish është i paargumentuar sipas zërave të punimeve në preventiv;

- Në pikën 2.3.4.a) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 1 ekskavator me goma dhe 1 me zinxhirrë, si dhe kokë tërheqëse me rimorkio. Duke pasur parasysh që në preventiv ka punime gërmimi vetëm në tokë të zakonshme, pa prani lagështire, etj., nga grupi i auditimit kërkesa për ekskavator me zinxhirrë dhe kokë tërheqëse me rimorkio, konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar;

- Matrapiku nuk është i nevojshëm pasi nuk ka prishje ndërtimesh apo thyerje gyrësh e shkëmbinjsh;

- Instrumenti gjeodezik nuk është i nevojshëm, pasi matjet supozohet të kenë përfunduar gjatë projektimit;

- Në pikën 2.3.4.b) në DT, kërkohet: “Duke qënë se më shumë se 60% e punimeve në preventivin e punimeve, kanë të bëjnë me punime betoni e materiale inertesh, në mënyrë që të garantohet realizimi me sukses dhe në kohë i kontratës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të kenë në pronësi, ose me qira, ose me kontratë furnizimi, impiant prodhim betoni dhe impiant prodhim inertesh...”. Përcaktimi se në preventivin e punimeve “...më shumë se 60% e punimeve në preventivin e punimeve, kanë të bëjnë me punime betoni e materiale inertesh...” nuk qëndron, pasi për zërin beton, kërkohet vetëm 250 m<sup>3</sup>, me vlerë 2,785,500 lekë dhe materiale inerte është vetëm zëri “Shtresë çakulli mbeturinë kave...”, 1,150 m<sup>2</sup>, me trashësi 20 cm dhe vlerë totale 1,039,600 lekë. Ky zë, nuk kërkohet prej guri të thyer, por mbeturinë kave. Vlera totale e këtyre zërave është 3,825,100 lekë, pra më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Sa më sipër, këto kritere nga grupi i auditimit konsiderohen të tepërta, konfuzuese dhe të paargumentuara.

- Në pikën 2.3.5. në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE “...duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar... certifikatën PAS 99-2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar) dhe leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.”. Nga grupi i auditimit këto kërkesa konsiderohen të tepërta dhe të paargumentuara, pasi OE nuk ka sisteme menaxhimi të integruara, sipas kuptimit të certifikatës PAS 99-2012 dhe mbetjet të cilat do të përftohen nuk kanë ndikim në mjedis, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar për mjedisin.

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga B.M, E.Y dhe E.H.

### **Vlerësimi i ofertave:**

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

Rezultatet e vlerësimit sipas Raportit Përmbledhës, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	F	10,662,150	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
2	K	10,755,600	<b>Skualifikuar pasi:</b> Nuk plotëson piken 2./1 germa “ b” Kriteret e veçanta të kualifikimit: Operatori ekonomik nuk ka paraqitur formularin e sigurimit te ofertës Nuk plotëson piken 2.3 “Kapaciteti teknik per pune te ngjashme : Ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik, vërtetimi për pune të ngjashme nuk përcaktohet natyra dhe përqindja e pjesëmarrjes se operatorit ekonomik, nga dokumentacioni shoqërues rezulton se operatori ekonomik, ka qene me bashkim operatorësh ne këtë kontrate Nuk plotëson kriterin 2.3.3 germa “a” dhe “f” “Stafi dhe punonjësit”. - Ne listë pagesat e shoqërisë mungon listpagese e muajit shtator për te gjithë punonjësit - Ne listpagesat e shoqërisë rezulton se operatori ekonomik nuk plotëson numrin e punonjësve te kërkuar ne DST, prej 31 (tridhjetë e një) punonjës Nuk plotëson Piken 2.3.4 Mjetet dhe pajisjet Nuk plotëson Piken 2.3.5 Kërkesat e cilësisë
3	A	10,267,900	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Operatori nuk ka paraqitur Formularin vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, siç është specifikuar ne DST. - Nuk plotëson 2.3 “ Kapaciteti teknik” piken 2.3.1 “Pune te ngjashme”: Kontratat e paraqitur nga Operatori ekonomik, nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës. Natyra e objekteve te punëve te paraqitura, nuk është e ngjashme .Punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të rrugore, dhe ndërtim objekti. Nuk plotëson piket 2.3.3 “Stafi dhe punonjësit” : - Germa “a”, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit (Korrik-Shtator 2022), si dhe të shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë

		<p>përkatëse, për 1 (një) Inxhinier Ndërtimi , 1 (një)Inxhinier Hidroteknik, 1 (një)Inxhinier Gjeodet1 (një) Inxhinier Elektrik 1 (një)I inxhinier Mekanik</p> <p>- Germa "b" / "a" , Operatorët ekonomikë nuk ka paraqitur për secilin specialist Kontratë individuale pune e vlefshme, dëshmi kualifikimi profesionale, diploma ose certifikata, lëshuar nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, si dhe Liste pagesat e shoqërisë për periudhën (Korrik-Shtator 2022) në të cilat duhet të figurojnë specialistët e kërkuar në germën "b te pikës 2,3,3 . te DST-ve-</p> <p>Për manovra torët dhe drejtuesit e automjeteve të rënda, nuk ka paraqitur :</p> <p>- Kontratë individuale pune e vlefshme, Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit e lëshuar nga DPSHTRR si dhe Liste pagesat e shoqërisë për periudhën (Korrik-Shtator 2022) në të cilat duhet të figurojnë manovratorët dhe drejtuesit e automjeteve të rënda</p> <p>- Nuk plotëson piken 2.3.4 germa "a,b,c,d ,e , për mjetet dhe pajisjet.</p>
--	--	--

- Nga auditimi, u konstatua se skualifikimet nga KVO qëndrojnë.
- Formulari paraprak për njoftimin e fituesit është me datë 12.12.2022 dhe formulari i njoftimit të fituesit është me datë 22.12.2022. Formularët janë pa numër protokollit.
- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 20.12.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar nga titullari.
- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE "F" ShPK është lidhur me nr. 3594 prot., datë 27.12.2022, me afat 105 ditë.
- Kontrata për mbikëqyrjen e punimeve është me nr. 3521 prot., datë 20.12.2022, ndërmjet AK dhe OE A. ShPK;
- Njoftimi për fillimin e punimeve është me datë 25.01.2023;
- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur në datën 26.01.2023;
- Në datën 05.05.2023 nga OE "F." dhe Mbikëqyrësi është bërë kërkesë për shtyrje të afatit të punimeve, pasi në sheshin e ndërtimit është një pjesë në pronësi private, e pashpronësuar;
- Në datën 10.05.2023, është mbajtur procesverbal për ndërprerjen e punimeve deri në shpronësimin dhe prishjen e objektit privat në sheshin e ndërtimit;
- Në datën 09.06.2023, është mbajtur PV për prishjen e objektit privat, pas miratimit të shpronësimit me VKM-në nr. 309, datë 24.05.2023;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE F., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3., "*Stafi dhe punonjësit*", pasi për shumicën e punonjësve, certifikatat e kualifikimeve janë lëshuar nga shoqëritë R./B. dhe Qendra e Trajnimeve të Avancuara<sup>3</sup>, të cilat nuk janë të akredituara në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit;
- Për punonjësin S. M., i deklaruar si saldator, mungon dëshmia e kualifikimit teknik e cila duhet posaçërisht për punonjësit të cilët operojnë me pajisje elektrike, impiante dhe instalimeve elektrike, në zbatim të Ligjit 8734, datë 01.02.2001, "*Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike*", të ndryshuar;
- Mungon dëshmia për një nga punonjësit e mësipërm, si "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*", në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier*", sipas kërkesave në DT;
- OE "F.", nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., "*Mjetet dhe pajisjet*", pasi:
  - Autobotet e ujit, me qera nga R. B., me targa AA062LV dhe AA827JT nuk disponojnë lejen e transportit, në kundërshtim me kërkesën në DT;
  - Mungon fotografia e rimorkiatorit me targë AER473;

<sup>3</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>



· Ruli i paraqitur nuk vërtetohet që është me vibrim dhe me kapacitetin e kërkuar 9-15 ton. Për këtë disponohet vetëm një kontratë blerje ku nuk jepet asnjë e dhënë teknike dhe një fotografi;

- OE “F.”, nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5., “Kërkesat e cilësisë”, pasi certifikatat ISO të disponueshme janë nga shoqëria ICDQ, e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë për certifikimin e shoqërive<sup>4</sup>;

- OE “F.”, nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5., “Kërkesat e cilësisë”, pasi nuk disponon leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis. Në lidhje me këtë pikë, nga OE “F.” është paraqitur Kontratë shërbimi me nr. 1127 rep. dhe nr. 418 kol., datë 10.07.2021, me objekt “...shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në objektet ndërtimore...”. nga KVO kjo kontratë nuk duhet të ishte marrë në konsideratë, pasi sipas DT, pika 2.16., nuk lejohet “mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” dhe as nënkontraktimi.

**Konkluzion:** Sa më sipër OE “F.” ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “F.” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE “F.” ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **10,908,570 lekë** pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga A.L, Kryetar, R.LL dhe N.G, anëtarë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit** janë të njëjta me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, **pretendimet nuk merren në konsideratë.** Nga materiali hiqet vetëm pjesa e kërkesës për xhiron vjetore, e cila është e zaturuar.

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mur mbajtës përgjatë lumit Osum, te ish-kantieri i NSHN-së”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 28 datë 28.07.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 28 datë 28.07.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 228 datë 28.07.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. A.L, Nënkyetar 2. E.Y, P. Prokurimesh 3. E.H, Juriste	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. B.M, Anëtar
5. Fondi Limit: 51,998,778 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “D” ShPK, me vlerë 50,628,700 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 2764, datë 30.09.2022, me afat 82 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 1,370,077 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 4 OE b) Skualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

<sup>4</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

### **Fondi limit dhe Projekti:**

- Fondi limit është llogaritur nga Njësia e Prokurimit, e cila ka marrë për bazë projektin e hartuar nga studio e projektimit E. & L. C., i miratuar nga titullari i AK.
- Procesverballi për llogaritjen e fondit limit është mbajtur në datën 28.07.2022, i paprotokolluar.
- Leja e ndërtimit për këtë investim është dhënë me nr. 39, datë 05.10.2022;
- Fondet për këtë prokurim janë akorduar nga Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile, njoftuar Bashkisë Skrapar me shkresën nr. 888/4 prot., datë 20.07.2022, “Konfirmim aplikimi në programin Emergjencat Civile 2022”, bashkëlidhur së cilës është Vendimi i Komitetit për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nr. 7, datë 13.07.2022, për projektin “Mur mbajtës përgjatë lumit Osum, te ish-kantieri i NSHN-së”, në vlerën 62,398,534 lekë.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbal pa datë dhe pa numër protokoll.
- Për përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes, etj., është mbajtur PV datë 29.07.2022, i paprotokolluar.
- Për ndryshimin e kriterëve të përzgjedhjes, etj., është mbajtur PV datë 10.08.2022, i paprotokolluar.
- Në pikën 2.3.2. në DT, krahas të tjerave, kërkohen Licencat e kategorive NP-5B “*Punime nëntokësore, ura e vepra arti*”, NP-8A “*Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë*” dhe NS-9B, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, pasi përkufizimet e punimeve për këto kategori licencash janë për punime dhe objekte të natyrave të tjera.
- Në pikën 2.3.3.a) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 3 inxhinierë të llojeve të ndryshme si drejtues teknikë dhe një inxhinier mekanik, një inxhinier mjedisi dhe një inxhinier gjeolog (jo drejtues teknikë). Nga grupi i auditimit kërkesa për inxhinier Markshajder, inxhinier mekanik, inxhinier mjedisi dhe inxhinier gjeolog konsiderohet e tepërt dhe e panevojshme për zërat e punimeve sipas preventivit. Gjithashtu, për shkak të natyrës dhe vlerës së kontratës, nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë drejtues teknikë.
- Në pikën 2.3.3.c) në DT, kërkohet një punonjës “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë....*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5.
- Në pikën 2.3.4.a) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 3 ekskavatorë me zinxhirrë. Duke pasur parasysh që në preventiv ka punime gërmimi vetëm në tokë të zakonshme, pa prani lagështire, etj., nga grupi i auditimit kërkesa për ekskavator me zinxhirrë konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar.
- Matrapiku nuk është i nevojshëm pasi nuk ka prishje ndërtimesh apo thyerje gyrësh e shkëmbinjsh.
- Instrumenti gjeodezik nuk është i nevojshëm, pasi matjet supozohet të kenë përfunduar gjatë projektimit.
- Në pikën 2.3.5. në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE “*...duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar... certifikatat: Certifikatën DS CEN/TR 15128-2005, (Çertifikatë e provës për të vlerësuar konformitetin në çelik, gize dhe*

alumin); *Certifikatën BS EN 13331-1 2002, (Pjesë të parafabrikuara, Metale, sisteme strukturore, masa sigurie, specifikim materiale) dhe Certifikatën SA 8000 :2014, (Certifikatë për standartin e përgjegjshmërisë sociale në vendet e punës)*. Nga grupi i auditimit, konstatohet se kërkesa për certifikatat e mësipër është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi nuk ka punime të cilat kërkojnë certifikime të tilla komplekse.

Gjithashtu, kërkesa për *“Leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.”* është e tepërt dhe e paargumentuar, pasi mbetjet të cilat do të përftohen nga gërmimet nuk kanë ndikim në mjedis, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar për mjedisin;

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 *“Kërkesat për kualifikim”*, neni 2 *“Qëllimi”*, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 39 *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga A.L , E.Y dhe E.H .

### **Vlerësimi i ofertave:**

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

Rezultatet e vlerësimit sipas Raportit Përmbledhës, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	BOE SH & A	43,952,139	<b>Skualifikuar pasi nuk plotëson:</b> - kriteret e pikës 2.3.3 "Stafi dhe punonjësit", germa A,B,C dhe D, të përcaktuara në DST. - nuk ka paraqitur liste pagesat e sigurimeve shoqërore për muajin e fundit "për specialistët dhe drejtuesit e automjeteve, të përcaktuara në germën A dhe B të DST-ve. - nuk ka paraqitur liste pagesën për 3(tre) muajt e fundit, të përcaktuar në germën C - nuk ka paraqitur liste pagesat e punonjësve të shoqërisë për 3(tre) muajt e fundit , të përcaktuar në germën D.
2	F	51,933,600	<b>Skualifikuar pasi nuk plotëson:</b> Oferta është mbi fondin limit, në preventivin e punimeve nuk përcaktohet vlera e fondit rezervë, që nëse shtohet vlera e ofertës së përllogaritur kalon mbi fondin limit.
3	BOE LL	42,841,964	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson piken 2.3 Kapaciteti teknik " pika 2.3.3." Stafi i punonjësve " , germa " A " për drejtuesit teknik të shoqërisë të cilët të figurojnë ne listë pagesat për tre muajt e fundit , - nuk ka paraqitur listë pagesat e muajit maj 2022, korrik 2022. - nuk ka paraqitur dokumentacionin për Ing. Mekanik, të deklaruar në shtojcën nr. 8 - nuk plotëson pikën 2.3 "Kapaciteti teknik " pika 2.3.3." Stafi i punonjësve " , germa " B " , për specialistet , nuk ka paraqitur listë pagesat e muajit maj 2022, korrik 2022 - nuk plotëson piken 2.3 "Kapaciteti teknik " pika 2.3.3." Stafi i punonjësve " , germa " C " , për punonjësit e kualifikuar , nuk ka paraqitur listë pagesat e muajit maj 2022, korrik 2022 - nuk plotëson piken 2.3 "Kapaciteti teknik " pika 2.3.3." Stafi i punonjësve " , germa " D " , për numrin e punonjësve, nuk ka paraqitur listë pagesat e muajit Maj 2022, Korrik 2022 - nuk plotëson piken 2.3 "Kapaciteti teknik " piken 2.3.4 "Mjetet dhe pajisjet " , germa "a" - Për mjetet, Ekskavator me goma , Autovetshkarkues, Kamionçinë , të deklaruar në shtojcën nr. 8 , nuk ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e këtyre mjeteve.
4	D	50,628,700	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>

- Nga auditimi, u konstatua se skualifikimet nga KVO qëndrojnë.

- Formulari për njoftimin e fituesit është me datë 27.09.2022, pa numër protokoll.

- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 27.09.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar nga titullari.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE "D" ShPK është lidhur me nr. 2764 prot., datë 30.09.2022, me afat 82 ditë.

- Në dosjen e prokurimit nuk ndodhet Urdhëri i titullarit për caktimin e personit përgjegjës për të ndjekur ecurinë e zbatimit të kontratës, Plani i monitorimit të kontratës dhe Raportimet në APP për ecurinë e kontratës, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Skrapar, z. A.M.

Sa më sipër, është në kundërshtim me LPP, neni 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës”, si dhe RrPP, neni 107 “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE D, nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3., “Stafi dhe punonjësit”, pasi:

Germa C) certifikatat e kualifikimit “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, për ing. A.B , B.M dhe G.T , janë lëshuar nga shoqëria A., e cila nuk është e akredituar dhe e licencuar në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit<sup>5</sup>;

- OE D , nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., “Mjetet dhe pajisjet”, pasi:

- Për kamionin vetëshkarkues me targë AA078KA dhe kapacitet 10-14 ton, mungon leja e transportit;

- Për autobotin e ujit, me targë AA229EL, nuk disponohet leja e transportit për të tretë dhe me qera.

**Konkluzion:** Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Për sa më sipër, OE D. ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar OE D. ShPK.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga R.LL, Kryetar N.G dhe B.M, anëtarë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit** janë të njëjta me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, **pretendimet nuk merren në konsideratë.** Nga materiali hiqet vetëm pjesa e kërkesës për xhiron vjetore dhe punët e ngjashme, të cilat janë ezauruar.

**3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje autoboti për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta të Bashkisë Skrapar”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 12 datë 16.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 12 datë 16.03.2022	3. Komisioni Vlerësimi i Ofertave: Nr. 03 datë 16.03.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. XH.LL, Nënkryetar 2. XH.S, P. Prokurimesh 3. A.S, Ekspert i jashtëm	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. S.H, Anëtar
5. Fondi Limit: 10,010,550 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “T” ShPK, me vlerë 9,950,000 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 1408, datë 19.05.2022, me afat 15 ditë nga lidhja e kontratës	7. Diferenca me fondin limit: 60,550 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.08.2022	9. Burimi i Financimit: Grant nga Qeveria Japonese	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE

<sup>5</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

		b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

#### Fondi limit:

- Burimi i financimit është grant nga qeveria japoneze, sipas kontratës datë 18 shkurt 2022;  
- Në dosjen e prokurimit nuk disponohet procesverbal për mënyrën e përlllogaritjes së Fondit Limit, por ofertat, nëpërmjet të cilave supozohet të jetë bërë studimi i tregut janë paraqitur me kundërshtitë e bëra për aktin e konstatimit.

#### Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve Teknike dhe kriterëve për kualifikim është mbajtur procesverbal pa datë dhe numër protokollit, ku nuk përcaktohet asnjë specifikim teknik dhe asnjë e dhënë për automjetin që kërkohet të blihet, në kundërshtim me LPP, neni 36, “*Specifikimet teknike*”, pika 1, 3, etj., si dhe Rr PP, neni 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 2., etj.

- Për hartimin e Specifikimeve teknike, nga AK Bashkia Skrapar është kontraktuar si ekspert i jashtëm z. A.S, me profesion Inxhinier Mekanik, në cilësinë e ekspertit të fushës. Për këtë qëllim është lidhur kontrata nr. 708 prot., datë 11.03.2022.

- Nga AK nuk është kërkuar që OE pjesëmarrës të jenë të licencuar për të ushtruar këtë lloj aktiviteti sipas kërkesave të Ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “*Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*”, kapitulli III, “*Shitblerja e mjeteve*”, neni 12, “*Veprimtaria e shitblerjes së mjeteve të reja ose të përdorura*”, pika 1.

- Në DT, pika 2.3., “*Kapaciteti teknik*”, germa a), është kërkuar “*Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më pak se 40% të fondit limit që prokurohet...*”. Kjo kërkesë është në kundërshtim me RrPP, neni 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*”, pika 4.

- Në pikën d), kërkohet disponimi certifikatës ISO 9001:2015 “*Për menaxhimin e cilësisë*”, e cila nga grupi i auditimit konstatohet e tepërt, e papërshtatshme dhe pa lidhje me objektin e prokurimit. OE pjesëmarrës në këtë procedurë nuk kryejnë procese prodhimi, për të cilat mund të nevojitet disponimi i certifikatës ISO 9001:2015 “*Për menaxhimin e cilësisë*”<sup>6</sup>.

- Gjithashtu, konstatohet se procesverbali për miratimin e kriterëve i ngarkuar në SPE nuk është i njëjtë me procesverbalin në dosjen e prokurimit, pasi PV në SPE përmban disa elementë të cilët nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, pasi bëjnë fjalë për një procedurë prokurimi ushqimesh.

Këto kriterë, nuk përmbushin parashikimet e LPP për klauzolat e referuara më sipër, si dhe neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 1 dhe pika 3.

Përgjegjësia për sa më sipër është e Njësisë së prokurimit, e përbërë nga XH.LL, XH.S dhe A.S, si dhe Kryetari të Bashkisë Skrapar, z. A.M.

<sup>6</sup> <https://iso.org/standard/62085.html>

### Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

Rezultatet e vlerësimit sipas Raportit Përmbledhës, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	Albania Motors	-	<b>Skualifikuar pasi nuk ka paraqitur ofertë</b>
2	A GmbH	9,888,888	<b>Skualifikuar pasi nuk plotëson:</b> Nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik, për furnizime të ngjashme. - Në kontrata me Institucione shtetërore, operatori ekonomik ka paraqitur kontratë, me Objekt Makinë me 4 akse. Kontrata nuk përmbush kriterin e furnizimeve të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit. Kontrata mban datën 04.07.2018. - Në rastin e përvojës në sektorin privat, operatori ekonomik ka paraqitur dy fatura shitje, për kamion te përdorur, te cilat nuk provojnë nëse janë likuiduar apo deklaruar në organet tatimore.
3	T	9,950,000	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
4	T	9,320,000	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Në regjistrin tregtarë, ekstraktin e QKB-se , nuk vërteton objektin e veprimtarisë , per Shitje, Blerje apo tregtim te automjeteve të ndryshme . - Nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik për furnizime të ngjashme. Ne kontratën furnizime te ngjashme me institucione shtetërore , Operatori Ekonomik , ka paraqitur kontratën Blerje Automjet teknologjik kamion, për grumbullimin e mbeturave shërbimit te pastrimit me bashkinë Mirdite. Nga verifikimi rezultoi se, ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate ,operatori ekonomik T ka qene në shkelje të nenit 76 germa “g” - operatori ekonomik ka pasur në cilësinë e administratorit, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit. Rezultoi se administratori i operatorit Ekonomik T , ka qene administratore e Operatorit Ekonomik TIMAK , përjashtuar nga prokurimet për periudhën 21.01 2021 deri ne 21.07.2022, publikuar në faqen zyrtare te APP-se në 21.01.2021. Ne rastin e përvojës realizuar ne sektorin privat, operatori ekonomik, paraqet si pune te ngjashme një certifikatë e përfundimit me sukses të projektit me objekt, “ Projekti i furnizimit dhe montimit të superstrukturave në 37 automjete speciale komunale dhe mjete të tjera ne Shkup”. Certifikatë paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin teknik për furnizime te ngjashme me objektin e prokurimit.

- Nga auditimi, u konstatua se skualifikimet nga KVO qëndrojnë.

- Formulari për njoftimin e fituesit është me datë 13.05.2022, pa numër protokoll.

- Raporti përmbledhës, i cili nuk ndodhet në dosjen e prokurimit, është mbajtur në datën 05.06.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar nga titullari.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE “T” ShPK është lidhur me nr. 1408 prot., datë 19.05.2022, me afat 15 ditë.

- Procesverbali i marrjes në dorëzim nga OE, është hartuar në datën 17.06.2022, i nënshkruar nga T.SH, A.S, S.A, S.SH, R.G dhe A.D, si drejtues i automjetit.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me LPP.

<b>4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje nafte për administratën, për ujë – kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2022”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 02 datë 01.02.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 02 datë 01.02.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 01 datë 16.03.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. XH.S, P. prokurimesh 2. E.Y, Spec. Prokurimesh 3. B.Z, P. Menaxhimit të Ujrave	1. N.G, Kryetar 2. R.LL, Anëtare 3. R.G, Anëtar
5. Fondi Limit: 3,333,333 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “G” ShPK, me vlerë 3,333,333 lekë pa TVSh, me kontratë datë 02.03.2022, me afat deri më 31.12.2022	7. Diferenca me fondin limit: 0 lekë (pasi oferta është me marzh fitimi)
8. Data e hapjes së tenderit: 15.02.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE

		c) Kualifikuar: I OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Fondi limit:

Titullari i AK nuk ka ngritur një komision të posaçëm për përllogaritjen e fondit limit. Për këtë arsye, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2, kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit). Në procedurën e prokurimit të marrë në shqyrtim, Njësia e Prokurimit me përbërje si më lart, me anë të një Procesverbali pa datë ka përllogaritur sasinë e naftës që do të blihet me anë të procedurës së prokurimit. Në këtë procesverbal, Njësia e Prokurimit ka pjesëtuar fondin limit 3,333,333 lekë (me TVSh), me çmimin e naftës për litër, të parashikuar në Listën e Çmimeve Mesatare të Konsumit, prej 180.6 lekë me TVSh për litër. Nga ky pjesëtim ka dalë sasia prej 22,148 litra që do të prokurimet. Në dosjen e prokurimit nuk dokumentohet asnjë shkresë e sektorit apo drejtorisë përkatëse që justifikon kërkesën për ndonjë sasi të caktuar naftë. Nuk është bërë pjesë e dosjes së prokurimit dokumentacioni provues mbi sasinë e mjeteve që ka në dispozicion Bashkia Skrapar si dhe sasinë vjetore të naftës që nevojitet për këto mjete gjatë një viti.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 74, pika 3 e VKM nr. 285 datë 19.05.2022.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E.Y, anëtar i Njesisë së Prokurimit, me detyrë specialist prokurimesh.

Kriteret e vlerësimit: Me Urdhër Prokurimi nr. 02, datë 01.02.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga znj. XH.S , z. E.Y dhe z. B.Z në procedurën me objekt “Blerje naftë për administratën, për ujitje – kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2022”, me fondin limit 3,333,333 lekë pa TVSh lekë, nga të ardhurat e Bashkisë Skrapar.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin pa numër dhe pa datë.

Në kriterin 2.3 c) kërkohet: “Subjektet pjesëmarrës në tender të kenë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjes të siguruar për periudhën nëntor 2021 – dhjetor 2021 (Lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve së bashku me listëpagesat sipas formularit). Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese: Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Nentor 2021 – Dhjetor 2021, Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nentor 2021 – Dhjetor 2021.”

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1,4 dhe 5 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5, shkronja b dhe c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, por nuk ka argumentuar teknikisht dhe në mënyrë të zgjeruar mbi numrin konkret të punonjësve (3), të cilën e ka përcaktuar si kriter kualifikues. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

Në kriterin 2.3, shkronja h, kërkohet “Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatë ISO 9001”:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj.”

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë teknike në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

### Vlerësimi i Ofertave:

Titullari i AK, me Urdhërin nr. 01, datë 01.02.2022, me nr. 233 prot., datë 01.02.2022, ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje: N.G , Kryetar, R.LL , Anëtar, R.G , anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, z. N.G si kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Z.G është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosija e z. N.G me detyrë Drejtor Finance dhe Nëpunës Zbatues i Bashkisë Skrapar, si kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të Nëpunësit Zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. A.M dhe z. N.G.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është shpallur fitues OE “G” me ofertën ekonomike 1,880,660 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se:

OE fitues ka dorëzuar në mënyrë të plotë dhe të saktë dokumentacionin e kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimet e Subjektit:**

**1. Mbi mospërlllogaritjen e sasisë së naftës objekt prokurimit, subjekti observon se:**

*Për procedurat e prokurimit për objektet me blerje naftë, është e pa mundur nga ana e sektoreve apo e drejtorive përkatëse të AK, si Zjarrfikësja, Bordi i Kullimit apo Administrata, të bëjnë një kërkesë për sasinë e naftës që u nevojitet gjatë vitit kalendarik, pasi rastet e emergjencës nga Zjarrfikësja/ nevojat për ndërhyrje nga Brodi i Kullimit/ lëvizjet e stafit të administrates për punë, trajnime apo rastet e tjera, nuk mund të parashikohen. Kësisoj AK bazohet mbi Buxhetin e vitit dhe përlllogarit sasinë e pritshme të naftës, bazuar mbi fondin e vënë në dispozicion për vitin Buxhetor.*

**2. Mbi hartimin e kriterëve të paargumentuara, subjekti observon se kriteret 2.3 c) dhe 2.3 h) janë të bazuara në ligj dhe të argumentuara teknikisht.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**1.** Neni 74, pika 3 e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, i ngarkon si detyrë përgjegjësit për prokurimet marrjen e informacioneve të nevojshme lidhur me mallrat objekt prokurimi. Përgjegjësi për prokurimet duhet të kishte kërkuar nga ana e sektorëve dhe drejtorive përkatëse hartimin e një kërkesë lidhur me sasinë e naftës që nevojitej për aktivitetin e zjarrfikësës dhe veprimtaritë lidhur me ujitje-kullimit, duke përdorur si pikë referimi sasinë e shpenzuar vitet paraardhëse në procedura prokurimi me të njëjtin objekt ose me objekt të ngjashëm. Përpos sa më sipër, personi përgjegjës duhet të kishte marrë informacion mbi numrin e mjeteve në dispozicion të Bashkisë Skrapar dhe llogaritjes së nevojave për naftë bazuar në sasinë e harxhuar për përdorimin e mjeteve në vitet paraardhëse. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk mbështetet në bazë ligjore dhe si rrjedhojë nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.



2. Neni 78, pika e 2 e VKM nr. 285 për Rregullat e Prokurimit Publik përcakton se NJP ka për detyrim argumentimin ligjor dhe teknik të kriterëve kualifikuese të vendosura në DST. Nga verifikimi fizik dhe elektronik i procedurave të përzgjedhura për auditim, si dhe observacioneve të dërguara nga subjekti në formë shkresore dhe elektronike, u konstatua sërish se mungon argumentimi teknik lidhur me dy kriteret e sipërpërmendura. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

### 5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2022”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 11 datë 15.03.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 11 datë 15.03.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 03 datë 16.03.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. XH.S, P. Prokurimesh 2. E.Y, Spec. prokurimesh 3. M.B, Spec. Ushqimesh	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. S.H, Anëtar
5. Fondi Limit: 1,896,808 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “S” ShPK, me vlerë 1,880,660 lekë pa TVSh, me kontratë datë 19.05.2022, me afat deri më 31.12.2022	7. Diferenca me fondin limit: 16,148 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 29.03.2022	9. Burimi i Financimit: Buxheti i bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

#### Fondi limit:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Skrapar nr. 11, datë 15.03.2022, me shkresën me nr. 736 prot., datë 15.03.2022, titullari i AK ka iniciuar procedurën e prokurimit të llojit e hapur, e thjeshtuar, me objekt: “Blerje Ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2022”, me fondin limit 1,896,808 lekë pa TVSh. Njësia e Prokurimit përbëhet nga XH.S, me funksion kryetar, me pozicion pune përgjegjës prokurimesh, E.Y. me funksion anëtar, me pozicion pune specialist prokurimesh dhe M.B, me funksion anëtar, me pozicion pune specialiste ushqimi. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit, u konstatua se titullari i AK nuk ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Përlllogaritjen Fondit Limit. Në mungesë të një komisioni të posaçëm për hartimin e fondit limit, këtë funksion e kryen Njësia e Prokurimit ose specialisti i Prokurimeve, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2, ku përcaktohet se kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit).

Njësia e Prokurimit ka përdorur metodën e testimit të tregut për të llogaritur vlerën e fondit limit. Me anë të procesverbalit për testimin e tregut me objekt: “Studim Tregu për çmimet e ushqimeve të Konviktit, Q. Alternative dhe Çerdhes”, Njësia e Prokurimit ka administruar ofertat e tre subjekteve tregtare, duke nxjerrë mesatare e çmimit për çdo njësi.

Njësia e Prokurimit ka hartuar Preventivin me çmimet si dhe grafikun e furnizimit me ushqim. **Shënim:** Janë analizuar kontrata të ngjashme të realizuara në vitet e mëparshme dhe është konstatuar po e njëjta metodë përlllogaritjeje fondit limit.

#### Hartimi i kriterëve:

Me procesverbalin me objekt: “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Në kriterin 2.3., kërkohet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin e saj. Certifikatë ISO 2200-2018 ose ekuivalentin e saj, të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës.”

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë teknike kriterin e mësipërm në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Këto veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 04 datë 16.03.2022, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkolës së mesme për vitin 2022” i cili përbëhet nga znj. R.LL me funksion kryetare, z. N.G me funksion anëtar dhe z. A.T me funksion anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, z. N.G si anëtar i Komisionit të Vlerësimit. Z. G është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosija e z. N.G me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatuesi i Bashkia Skrapar, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 OE “S” ShPK, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertë ekonomike në vlerën 1,880,660 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

OE fitues nuk ka dorëzuar vërtetimin se nuk është dënuar për ndonjë veper penale;

Sipas pikës 2.7., shkronja g në DST, për mjetin me targa AA726VH, në pronësi të OE “S” ShPK mungon dokumentacioni i mëposhtëm:

Vërtetimi i shlyerjes së taksave të mjetit.

Sipas pikës 2.7., shkronja në DST, për mjetin me targa AA531TY, në pronësi të operatorit “S”, mungon dokumentacioni i mëposhtëm:

Vërtetimi i shlyerjes së taksave për mjetin.

Për sa më sipër konstatohet se KVO duhet të kishte skualifikuar OE “S” dhe të kishte përfunduar procedurën pa fitues si rrjedhojë e dorëzimit të një dokumentacioni jo të plotë dhe jo në përputhje me përcaktimet e DST.

Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, pika 1 dhe neni 92 pika 3.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë nga znj. R.LL me funksion kryetare, z. N.G me funksion anëtar dhe z. A.T me funksion anëtar.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Prezantimet e Subjektit:**

Për sa i përket konstatimit të grupit të auditimit se kriteri 2.3, shkronja i: “ Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin e saj. Certifikatë ISO 2200-

2018 ose ekuivalentin e saj, të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës”, është një kriter i paargumentuar teknikisht në lidhje dhe në funksion të kontratës, subjekti observon se: Për kriterin 2.3 shkronja i) në procesverbalin e argumentimit Nj.Prokurimit i është referuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në piken 1, të nenit 44, të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për ISO 9001:2015 ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë. Ndërsa për ISO 2200:2018 është bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në prapësimin e mësipërm, subjekti i është referuar bazës ligjore ku është mbështetur për vendosjen e këtij kriteri, por nuk ka argumentuar teknikisht vendosjen e tij. Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar teknikisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

Për sa më sipër pretendimit i subjektit nuk merret në konsideratë.

**Procedurat e audituara nga prokurimet e AK “Aparati i Bashkisë Skrapar”, për vitin 2023:**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruktion i shkollës “Ramiz Aranitasi”, Çorovodë”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 193 datë 22.05.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 193 datë 22.05.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 194 datë 22.05.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur	1. A.L, Nënkyetar 2. E.Y, P. Prokurimesh 3. J.K, Juriste	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. B.M, Anëtar
5. Fondi Limit: 41,247,773 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “F” ShPK, me vlerë 35,972,535 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 2506, datë 28.09.2023, me afat 120 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 5,275,238 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.07.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit dhe të bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 15 OE b) Skualifikuar: 11 OE c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime AK: C ShPK, nr. 1887/3 prot.	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Vendimi nr. 800 date 23.08.2023

Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

**Fondi limit dhe Projekti:**

- Fondi limit është llogaritur nga Njësia e Prokurimit, e cila ka marrë për bazë projektin e hartuar nga BOE G & HH;
- Projekti dhe Specifikimet Teknike janë hartuar nga BOE G & HH dhe janë miratuar nga titullari i Bashkisë Skrapar;
- Leja e ndërtimit për këtë investim është dhënë me nr. 44, datë 10.10.2023;
- Në preventiv, në dy raste janë përdorur emra markash, konkretisht në kapitullin “Punime të brendshme dhe tualete”, në zërin nr. 23 është kërkuar përdorimi i mermerit “Janina”, ndërsa në zërin nr. 24 dhe në kapitullin “Punime të brendshme fasade dhe të jashtme”, zëri 11, është kërkuar hidroizoluesi “Mapej”. Për të dy këto raste duhet të ishte vendosur togfjalëshi “ose ekuivalente”;
- Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 09, datë 29.06.2022 “Për një ndryshim në VKB nr. 65, datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023, lidhur me disa ndryshime në nivel programi dhe artikulli për Bashkinë Skrapar dhe institucionet e varësisë”;

### Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 26.05.2023, pa numër protokolli.
- Kriteret e vlerësimit janë ndryshuar sipas dy shtojcave, të cilat janë pa datë dhe numër protokolli, nga ku një ka qenë pas rekomandimeve të APP-së dhe një ka qenë pas ankesës së një OE.
- Nga Njësia e Prokurimit nuk janë mbajtur procesverbale për dokumentimin e procesit, në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 2 “*Dokumentimi i procesit*”, pika 1. Gjithashtu, mosmbajtja e procesverbaleve është në kundërshtim edhe me nenin 74 “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*”, pika 3, germa e), etj.
- Në pikën 2.3.2. në DT, krahas të tjerave, kërkohen Licencat e kategorisë NP-7A “*Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje*” dhe NS-8A “*Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri*”, të cilat nga grupi i auditimit nuk gjenden të argumentuara dhe të mbështetura në LPP, pasi në preventiv nuk ka zëra për të cilët nevojiten kjo lloj licencash, sipas klasifikimit të punimeve në VKM-në nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, Lidhja 3.
- Në pikën 2.3.3.a) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 4 inxhinierë të llojeve të ndryshme si drejtues teknikë dhe një inxhinier mekanik e një inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder, (jo drejtues teknikë). Nga grupi i auditimit kërkesa për arkitekt, inxhinier mekanik dhe inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder konsiderohet e tepërt dhe e panevojshme për zërat e punimeve sipas preventivit. Gjithashtu, për shkak të natyrës dhe vlerës së kontratës, nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët të jenë drejtues teknikë;
- Në pikën 2.3.3.c) në DT, kërkohet që OE të disponojë një numër prej të paktën 58 punonjësish, përveç stafit drejtues, inxhinierëve të kërkuar në pikën 2.3.3.a. Nga grupi i auditimit kërkesa për këtë numër punonjësish konsiderohet e tepërt dhe e paargumentuar në përputhje me zërat e punimeve sipas preventivit. Grupi i auditimit mendon se nga AK duhet të ishte kërkuar edhe një karpentier, pasi në preventiv ka punime trarësh betoni dhe pa një karpentier për armaturën nuk garantohet realizimi me sukses i kontratës;
- Në pikën 2.3.3.d) në DT, kërkohet:
  - një punonjës “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.....*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5.
  - kërkohen “*2 punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga një organ i akredituar për dhënien e Ndihmës së Parë*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe e pambështetur në ligj;
  - kërkohen “*2 punonjës me certifikatë trajnimi për punimet në lartësi D.P.I. (montim skeleri, punime të ndryshme fasade, etj.) e dhënë nga një organizëm i akredituar, shqiptar ose i huaj*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt, e paargumentuar dhe e pambështetur në ligj;
- Në pikën 2.3.4.) në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE të disponojë 1 konteiner ndërtimi stacionar (zyrë), i cili nga grupi i auditimit konsiderohet i tepërt dhe i paargumentuar;
- Në pikën 2.3.5. në DT, krahas të tjerave, kërkohet që OE “*...duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar... certifikatën ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)*”. Nga grupi i auditimit kjo kërkesë konsiderohet e tepërt dhe

e paargumentuar, pasi nuk ka punime të lidhura me mjedisin, sipas kuptimit të certifikatës ISO 14001:2015;

Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga A.L , E.Y dhe J.K.

#### Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

#### Rezultatet e vlerësimit sipas Raportit Përmbledhës, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	A	33,899,985	<b>Skualifikuar pasi:</b> Në mbështetje të nenit 26 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2, germa “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, operatori ekonomik “A” sh.p.k., s’kualifikohet për shkak se, operatori ekonomik nuk ju përgjigj Autoritetit Kontraktor, në datën dhe orën e caktuar për paraqitjen e dokumentacionit provues përpara publikimit të “Njoftimit të Fituesit” dhe nisjes së afateve të animimit.(Reklamuar në proces verbalin e KVO-së , datë 27.07 2023.
2	F	35,972,535	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
3	R	36,909,127	<b>Kualifikuar</b>
4	E	37,895,013	<b>Kualifikuar</b>
5	SH	39,685,000	<b>Kualifikuar</b>
6	K	32,021,179	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit , piken 2.2.3 , të DST-ve. - Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore , për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-së, por edhe në sistem nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore . - Nuk plotëson kriterin kapaciteti Teknik , piken 2.3.4 Mjetet dhe pajisjet : - Në (shtojcën 8) formulari përmbledhës i vetdeklarimit, operatori ekonomik nuk ka deklaruar të dhënat në rubrikën “Nr. Kont së qerasë (noterisë)”. - Nga të dhënat e tjera për mjetet me qira të deklaruara, rezultojnë se: - - për mjetin Kamioninë deri në 3.5 ton operatori ka deklaruar mjetin me targa AA738 SP, ku përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistem, rezultojnë të jetë për përdorim vetjak, dhe si e tillë nuk mund ti jepet një pale të trete, kjo në kundërshtim me ligjin “Për Transportet Rrugore”, ku specifikohet qartësisht ndarja midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” dhe certifikatës “Transport për të tretë dhe me qira”. - - për mjetin e deklaruar me qira me targa AA813FY, nga dokumentacioni i dorëzuar në sistem rezultojnë të jetë për përdorim vetjak, dhe si e tillë nuk mund ti jepet një pale të tretë, kjo në kundërshtim me ligjin “Për Transportet Rrugore”, ku specifikohet qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” dhe certifikatës “Transport për të tretë dhe me qira”.
7	C	32,989,799	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, pikën 2.2.3, të DST-ve. Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, në sistem ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore vetëm për vitin 2022. Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “C” shpk, me vendimin nr, 800 datë 23.08.2023, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka Kualifikuar operatorin ekonomik “C” shpk. Komisioni i Vlerësimit të ofertave në zbatim të nenit 26 , pika 6, VKM-së 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ka njoftuar operatorin ekonomik i kualifikuar i pari, për dorëzimin e dokumentacionit provues të kërkuar në piken 2 të këtij nenit 26, si dhe gjithë dokumentet e tjerë shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Operatori ekonomik nuk ju përgjigj njoftimit , për paraqitjen në datën dhe orën e caktuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Skrapar, të dokumentacionit provues të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të VKM-së 285, datë 19.5.2021

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
			“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. (Reklamuar në Proces Verbalin KVO-se, datë 30.08.2023), për këtë shkak , operatori ekonomik “C ” shpk s’kualifikohet.
8	2 N	36,000,000	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit, piken 2.2.3, te DST-ve. - Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, nuk ka paraqitur as në SPE. - Nga të dhënat në ekstrakti Historik e QKB-se datë 30/05/2023 rezulton, -Vendosje të Masës së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, lëshuar nga Drejtoria e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara Rajoni Qendror, ku është kërkuar: Vendosje të masës së sigurimit të detyrimit tatimor, mbi subjektin: “2N” SHPK pajisur me NUIS (Nipt)- L...L. Vendosja e kësaj masë synon të mos lejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore.
9	BOE A & Z	36,664,162	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit , piken 2.2.1 - Operatori Ekonomik Z, nuk ka paraqitur ne sistem deklaratat e xhiros vjetore te realizuar për vitin 2020,2021,2022
10	K	38,789,184	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas kriterëve te veçanta te kualifikimit pika 1. - Nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit , piken 2.2.3 , të DST-ve. Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, por edhe në sistem nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore . - Nuk plotëson piken 2.2.3 A) stafi dhe punonjësit kriterë te vendosura ne DST. - Nuk ka deklaruar në formularin e vetdeklarimit, Arkitektin, Ing.Hidraulik dhe Ing Elektrik. - Nuk ka deklaruar specialistet :Hidraulik 2, elektrikist 1,hekurkthyes 1, murator 3,shtrues pllakash 2, bojaxhi 1 dhe 1 drejtues mjeti (leje drejtimi C) kjo e kërkuar në pikën 2.2.3 B) të DST - Nuk plotëson pikën 2.2.3 C) nuk ka numrin e nevojshëm prej 58 punonjës të kërkuar në këtë pikë të DST-ve.
11	P	40,203,761	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit , piken 2.2.3 , te DST-ve: Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, por edhe në sistem nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore .
12	S	40,815,897	<b>Skualifikuar pasi:</b> - Nuk plotëson kriteret e veçanta te kualifikimit , piken 2.2.3 , te DST-ve. - Operatori ekonomik, nuk ka deklaruar në (shtojcën 8) Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore , për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij sipas të dhënave të QKB-se, por edhe në sistem nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore . - Nuk plotëson pikën 2.2.3, Stafi dhe punonjësit shkronja B) të Kriteret e veçanta të kualifikimit ,të vendosura ne DST. - Arkitekti i paraqitur nuk është drejtues teknik i firmës ne licencën e shoqërisë.
13	S	Pa ofertë	<b>Skualifikuar pasi:</b> Nuk ka paraqitur asnjë dokument te kërkuar në Dokumentet Standarte të Tenderit.
14	T	Pa ofertë	<b>Skualifikuar pasi:</b> Nuk ka paraqitur dokumentacion.
15	B	Pa ofertë	<b>Skualifikuar pasi:</b> Nuk ka paraqitur formularin e ofertës sipas shtojcës 1 2 te ligjit “ Për Prokurimin Publik”.

- Nga auditimi, u konstatua se skualifikimet nga KVO qëndrojnë.

- Në datën 14.07.2023, KVO ka mbajtur PV për shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertave me 5 ditë, për shkak të numrit të madh të OE ofertues.

- Në datën 26.07.2023, ora 10:30, nga KVO është mbajtur PV pasi OE A. ShPK, i cili është kualifikuar i pari, si OE me ofertën më të ulët dhe nuk është paraqitur për të sjellë dokumentacionin. Kërkesa në SPE, OE A. ShPK i është bërë në datën 24.07.2023, ora 09:32, në rubrikën “Kërkesa/komunikime me OE”. KVO ka bërë verifikimet dhe ka pritur për

paraqitjen e dokumentacionit nga OE A. ShPK deri në datën 26.07.2023, ora 10:30, kur është mbajtur PV në fjalë;

- Në datën 02.08.2023, me nr. 1887/3 prot., nga KPP ka dalë formular për publikim, për ankesën e bërë nga OE C. ShPK, i cili është ankuar pasi është skualifikuar nga KVO sepse nuk ka deklaruar në Shtojcën 8, Formulari i vetëdeklarimit, shlyerjen e detyrimeve vendore për të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet sipas të dhënave në QKB dhe në sistem ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022;

- Në datën 04.08.2023, me nr. 2003 prot., ka dalë Urdhër nga Titullari i Bashkisë Skrapar për pezullimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi për shqyrtimin e ankesës;

- Me urdhërin nr. 325, datë 04.08.2023, me nr. 2004 prot., është caktuar znj. E.H si personi për shqyrtimin e ankesës së OE C ;

- Me shkresën nr. 2005 prot., datë 04.08.2023, nga AK ka dalë Vendim për shqyrtimin e ankesës, e cila është refuzuar pasi nuk është gjetur e depozituar në AK, sipas nenit 94, pika 2 të RrPP;

- Me shkresën nr. 1887/8 prot., datë 23.08.2023, nga KPP është dërguar në AK Vendimi nr. 800/2023 prot., datë 23.08.2023, nëpërmjet të cilit AK urdhërohet të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e OE C ShPK, duke e kualifikuar këtë OE;

- Me shkresën nr. 1887/10 prot., datë 04.09.2023, nga KPP është lejuar vazhdimi i procedurës së prokurimit;

- Me shkresën nr. 2196/1 prot., datë 30.08.2023, nga AK është njoftuar KPP për kualifikimin e OE C. ShPK;

- Në datën 30.08.2023, ora 10:00, nga KVO është mbajtur PV pasi OE C. ShPK, i cili është kualifikuar i pari, si OE me ofertën më të ulët dhe nuk është paraqitur për të sjellë dokumentacionin. Kërkesa në SPE, OE C. ShPK i është bërë në datën 25.08.2023, ora 14:01, në rubrikën “*Kërkesa/komunikime me OE*”. KVO ka bërë verifikimet dhe ka pritur për paraqitjen e dokumentacionit nga OE A. ShPK deri në datën 30.08.2023, ora 10:00, kur është mbajtur PV në fjalë;

- Për njoftimin e fituesit, në datën 07.09.2023 është hartuar Formulari paraprak, ku është shpallur fitues OE C. ShPK, i cili nuk është paraqitur;

- Në datën 15.09.2023 është hartuar Formulari paraprak, ku është shpallur fitues OE F. ShPK dhe formulari i njoftimit të fituesit pas përfundimit të afatit të ankesave, është me datë 26.09.2023. Formularët janë pa numër protokolli.

- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 25.09.2023, i paprotokolluar dhe është miratuar nga titullari. Në raportin përmbledhës nuk janë renditur të gjithë OE pjesëmarrës, pasi nga 15 OE janë dhënë detaje për kualifikimin/skualifikimin e 10 OE, etj., në kundërshtim me LPP, neni 99 “*Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit*”, pikat b/i dhe ë).

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE “F” ShPK është lidhur me nr. 2506 prot., datë 28.09.2020, me afat 120 ditë.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- OE F., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3., “*Stafi dhe punonjësit*”, pasi për shumicën e punonjësve, certifikatat e kualifikimeve janë lëshuar nga shoqëritë R/B dhe Qendra e Trajnimeve të Avancuara<sup>7</sup>, të cilat nuk janë të akredituara në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit.

- Certifikatat “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” dhe “*Specialist për punimet në lartësi*”, për ing. G.I, janë lëshuar nga shoqëria K C<sup>8</sup>, e cila nuk është e akredituar dhe e licencuar në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit.

<sup>7</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

<sup>8</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

- Certifikatat e kualifikimeve “Specialist për punime në lartësi”, janë lëshuar nga shoqëria “Q. T. A.”<sup>9</sup>, e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit.

- OE F., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., “Mjetet dhe pajisjet”, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për autobot uji. Në formularin e vetëdeklarimit, në rubrikën “Mjete me qera”, është paraqitur mjete me targë AA062LV, por dokumentacioni nuk është ngarkuar në SPE.

- OE F., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5., “Kërkesat e cilësisë”, pasi certifikatat ISO të disponueshme janë nga shoqëria ICDQ, e cila nuk është e akredituar në Republikën e Shqipërisë për certifikimin e shoqërive<sup>10</sup>.

**Konkluzion:** Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Për sa më sipër, OE F. ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar OE F. ShPK.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga: R.LL, kryetar, N.G dhe B.M , anëtarë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit** janë të njëjta me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, **pretendimet nuk merren në konsideratë.** Nga materiali hiqet vetëm pjesa e kërkesës për xhiron vjetore dhe punët e ngjashme, të cilat janë ezauruar.

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i mjediseve sportive/ndërtim fushe sporti, pranë shkollës “Zylyftar Veleshnja””</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 58 datë 10.02.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 58 datë 10.02.2023	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 59 datë 10.02.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. B.M, Drejtor i Urbanistikës 2. E.Y, P. Prokurimësh 3. E.H, Juriste	1. A.L, Kryetar 2. R.LL, Anëtar 3. N.G, Anëtar
5. Fondi Limit: 4,521,937 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: BOE “A” ShPK dhe “B” ShPK, me vlerë 4,488,960 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 1011, datë 20.04.2023, me afat 62 ditë	7. Diferenca me fondin limit: 32,977 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 17.03.2023	9. Burimi i Financimit: Grant nga Bashkimi Evropian	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

<sup>9</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

<sup>10</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>



Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, neni 18.

#### Fondi limit dhe Projekti:

- Fondi limit është llogaritur nga Njësia e Prokurimit, e cila ka marrë për bazë projektin e hartuar nga studio e projektimit H.
  - Projekti dhe Specifikimet Teknike janë hartuar nga OE H. dhe janë miratuar nga titullari i Bashkisë Skrapar.
  - Procesverbalë për llogaritjen e fondit limit është pa datë dhe i paprotokolluar.
  - Leja e ndërtimit për këtë investim është dhënë me nr. 43, datë 28.04.2023.
  - Fondet për këtë prokurim janë përfituar nga BE, projekti “BE për bashkitë”, nëpërmjet kontratës nr. EUC4M-CfP2-2022/A2 prot., datë 10.10.2022.
- Përgjegjësia për sa më sipër është e Njesisë së Prokurimit, e përbërë nga B.M , E.Y dhe E.H.

#### Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbal pa datë dhe pa numër protokoll.
  - Nga Njësia e Prokurimit nuk janë mbajtur procesverbale për dokumentimin e procesit, në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 2 “*Dokumentimi i procesit*”, pika 1. Gjithashtu, mosmbajtja e procesverbaleve është në kundërshtim edhe me nenin 74 “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*”, pika 3, germa e), etj.
  - Në pikën 2.2.1. në DT, kërkohet “...*vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të objektit të prokurimit...*”. Nga auditimi, u konstatua se kërkesa e mësipërme është në mospërputhje me RrPP, neni 43, “*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*”, pika 2, germa c.
  - Në pikën 2.4.3. në DT, kërkohet një punonjës “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë....*”. Nga grupi i auditimit konstatohet se kjo kërkesë është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10327 datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, neni 10 “*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*”, pika 5.
- Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “*Kërkesat për kualifikim*”, neni 2 “*Qëllimi*”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 1 dhe pika 3.
- Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga B.M , E.Y dhe E.H.

#### Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.
- Në procedurë ka marrë pjesë vetëm një ofertues, BOE “A” ShPK & “B” ShPK, i cili ka ofertuar vlerën 4,488,960 lekë pa TVSh dhe është shpallur fitues.
- Formulari paraprak për njoftimin e fituesit është me datë 03.04.2022, pa numër protokoll.
- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 03.04.2022, i paprotokolluar dhe është miratuar nga titullari.
- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe BOE “F” ShPK është lidhur me nr. 1011, datë 20.04.2023, me afat 62 ditë.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- Asnjë nga OE nuk ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit të biznesit nga QKB;
- OE B. nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e energjisë elektrike;
- OE B. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3., “*Stafi dhe punonjësit*”, pasi për bojaxhiun, hekurkthyesit dhe niveluesit e betonit, certifikatat e kualifikimeve janë lëshuar nga shoqëria D. C., e cila nuk është e akredituar dhe e licencuar në Republikën e Shqipërisë për trajnimin e punonjësve/personelit<sup>11</sup>;
- Certifikata për personin përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është lëshuar nga R&T Consulence, e cila nuk është e akredituar për trajnimin dhe certifikimin e personelit;
- OE B., nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., “*Mjetet dhe pajisjet*”, pasi:
  - Kamioni me targë AA983CM, i vetëdeklaruar si kamion me vinç, nuk disponon lejen e transportit për të tretë, në kundërshtim me kërkesën në DT;
  - OE B. nuk plotëson kërkesën për Instrument gjeodezik, pasi kontrata e qerasë e paraqitur me shoqërinë “G”, është për 3 copë GPS pajisje survejimi me aksesori;
- OE A. ShPK, i cili sipas kontratës së bashkëpunimit do të kryejë vetëm shtrimin me tartan, nuk përmbush pikën 2.3.1. në DT, “*Për të provuar përvojën e mëparshme*”, pasi kontrata e paraqitur prej tij është “*Rivitalizim i objektit të kinemasë Përmet*”, e cila nuk ka lidhje me shtrimin e tartanit;

**Konkluzion:** Sa më sipër BOE A. ShPK & B. ShPK, nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE A. ShPK & B. ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, neni 92 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 2.

Duke shpallur fitues BOE A. ShPK & B. ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën 4,488,960 lekë pa TVSh me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga: A.L, Kryetar, R.LL dhe N.G, anëtarë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit** janë të njëjta me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, **pretendimet nuk merren në konsideratë.** Nga materiali hiqet vetëm pjesa e kërkesës për xhiron vjetore, e cila është ezauruar.

**3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje nafte për administratën, për ujtitje - kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2023”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 33 datë 25.01.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 33 datë 25.01.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 34 datë 25.01.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. E.Y, Nënkyetar 2. R.G, P. Shërbimesh 3. B.Z, P. Bordi Ujitjes dhe Kullimit	1. N.G, Kryetar 2. R.LL, Anëtar 3. S.A, Anëtar

<sup>11</sup> <https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>

5. Fondi Limit: 3,750,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE "G" ShPK, me vlerë 3,750,000 lekë pa TVSh, me kontratë datë 27.02.2023, me afat deri më 31.12.2023	7. Diferenca me fondin limit: 0 lekë pa TVSh (pasi oferta është me marzh fitimi)
8. Data e hapjes së tenderit: 13.02.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

### Fondi limit:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Skrapar nr. 33, datë 25.01.2023, me shkresën me nr. 138 prot., datë 25.01.2023, është iniciuar procedura e prokurimit të llojit e hapur, e thjeshtuar, me objekt: *"Blerje naftë për administratën, për ujitje-kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2023"*, me fondin limit 3,750,000 lekë me TVSh. Njësia e Prokurimit përbëhet nga E.Y, me funksion kryetar, me pozicion pune përgjegjës prokurimesh, R.G me funksion anëtar, me pozicion pune përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe B.Z, me funksion anëtar, me pozicion pune përgjegjës bordi, ujitjes dhe Kullimit. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes e prokurimit, u konstatua se titullari i AK nuk ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Përlllogaritjen Fondit Limit. Në mungesë të një komisioni të posaçëm për hartimin e fondit limit, këtë funksion e kryen Njësia e Prokurimit ose specialisti i Prokurimeve, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 78, pika 2, ku përcaktohet se kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit).

Në procedurën e prokurimit të marrë në shqyrtim, Njësia e Prokurimit, me anë të një Procesverbalit të datës 26.01.2023, pa numër, të firmosur nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, ka përlllogaritur sasinë e naftës që do të prokurohet.

Me anë të këtij procesverbalit, Njësia Prokurimit ka pjesëtuar fondin limit prej 4,500,000 lekë (me TVSh) me çmimin e naftës për litër, të përcaktuar me vendimin e Bordit të Transparencës të datës 26.01.2023, në vlerën e 206 lekë për litër me TVSh. Nga ky pjesëtim ka dalë sasia prej 21,844 litra që do të prokurohej. Në dosjen e prokurimit nuk dokumentohet asnjë shkresë e sektorit apo drejtorisë përkatës që justifikon kërkesën për ndonjë sasi të caktuar naftë. Nuk është bërë pjesë e dosjes së prokurimit dokumentacioni provues mbi sasinë e mjeteve që ka në dispozicion Bashkia Skrapar dhe sasia e përafërt që nevojitet për furnizimin e këtyre mjeteve me naftë, në kundërshtim me nenin 74, pika 3 VKM nr. 285 datë 19.05.2022.

Për sa më sipër mban përgjegjësi, z. E.Y, anëtar i Njesisë së Prokurimit, me detyrë përgjegjës prokurimesh.

Në bazë të përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Njësia e Prokurimit duhet të kishte përlllogaritur fondin limit dhe sasinë e karburantit që do të prokurohej përpara Urdhërit të Prokurimit të lëshuar nga ana e titullarit të AK. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*.

### Hartimi i kritereve:

Njësia e prokurimit me procesverbalin pa datë dhe me vetëm me dy nga tre firmat e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, ka miratuar dhe argumentuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Nga auditimi konstatohet se nga Njësia e Prokurimit janë vendosuar kritere të paargumentuara, konkretisht:

Në pikën 2.3.c), kërkohet: *"Subjektet pjesëmarrës në tender të kenë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjes të siguruar për periudhën Nentor 2022 – Dhjetor 2022 (Lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve së bashku me listëpagesat sipas formularit). Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën nëntor 2021 – dhjetor 2021.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën nëntor 2021 – dhjetor 2021.”

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1,4 dhe 5 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, por nuk ka argumentuar teknikisht dhe në mënyrë të zgjeruar mbi numrin konkret të punonjësve (3), të cilën e ka përcaktuar si kriter kualifikues. Veprimet dhe mosveprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2.

Në kriterin 2.3, shkronja h, kërkohet: “Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatë ISO 9001”:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj.”

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë teknike në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 34/2 datë 25.01.2023, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje nafte për administratë, për ujitje-kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2023”, i cili përbëhet nga z. N.G, me funksion kryetar, znj. R.LL, me funksion anëtar dhe znj. S.A, me funksion anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, z. N.G si kryetar i Komisionit të Vlerësimit. Z. G është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosija e z. N.G me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Skrapar, si kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. A.M dhe z. N.G.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është shpallur fitues OE “G” shpk me ofertën ekonomike 3,750,000 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

OE fitues “G” ShPK nuk ka dorëzuar vërtetimin se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

Bazuar në sa më lart, KVO duhej të kishte skualifikuar OE “G” SHPK dhe të kishte mbyllur procedurën e prokurimit pa fitues.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, pika 1 dhe neni 92 pika 3.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

*1. Për procedurat e prokurimit për objektet me blerje Naftë, është e pa mundur nga ana e sektoreve apo e drejtorive përkatëse të AK, si Zjarrfikësja, Bordi i Kullimit apo Administrata, të bëjnë një kërkesë për sasinë e naftës që u nevojitet gjatë vitit kalendarik, pasi rastet e emergjencës nga Zjarrfikësja/ nevojat për ndërhyrje nga Brodi i Kullimit/ lëvizjet e stafit të administrates për punë, trajnime apo rastet e tjera, nuk mund të parashikohen. Kësisoj AK bazohet mbi Buxhetin e vitit dhe përlllogarit sasinë e pritshme të naftës, bazuar mbi fondin e vënë në dispozicion për vitin Buxhetor.*

*2. Mbi konstatimin se: Njësia e Prokurimit me procesverbalin pa datë dhe me vetëm me dy nga tre firmat e anëtarëve të Nj.Prokurimit, ka miratuar dhe argumentuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, subjekti pretendon se:*

*Procesverbali për “Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” është procesverbal tip i APP dhe hidhet në SPE nga ana e AK. Gjithashtu bazuar mbi VKM nr.285 datë 19.05.2022, neni 2, pika 3 “Dokumentimi i proceseve që zhvillohen në sistemin e prokurimit elektronik bëhet automatikisht në sistem”. Ndërsa mungesa e firmës është një gabim i anëtarit të grupit. Por duke qenë që personi që ka harraur të hedhë firmën është edhe personi që ka hedhur procedurën në SPE, besojmë që ky gabim mund të konsiderohet si një gabim njerëzor.*

*3. Për sa i përket argumentimit teknik të kriterit 2.3 c), subjekti i është referuar si bazë ligjore pikës 1, 4 dhe 5 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është parë e arsyshme një numër minimal prej 3 punonjësish për mbarë vjatjen e punës.*

*-Për sa i përket argumentimit teknik. Për kriterin 2.3 h) në procesverbalin e argumentimit Nj.Prokurimit i është referuar pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat, objektet prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*1. Sa i përket pretendimit nr.1: Neni 74, pika 3 e VKM nr. 285 datë 19.05.2022, i ngarkon si detyrë përgjegjësit për prokurimet marrjen e informacioneve të nevojshme lidhur me mallrat objekt prokurimi. Përgjegjësi për prokurimet duhet të kishte kërkuar nga ana e sektorëve dhe drejtorive përkatëse hartimin e një kërkesë lidhur me sasinë e naftës që nevojitej për aktivitetin e zjarrfikësës dhe veprimtaritë lidhur me ujitje-kullimit, duke përdorur si pikë referimi sasinë e shpenzuar vitet paraardhëse në procedura prokurimi me të njëjtin objekt ose me objekt të ngjashëm. Përpos sa më sipër, personi përgjegjës duhet të kishte marrë informacion mbi numrin e mjeteve në dispozicion të Bashkisë Skrapar dhe llogaritjes së nevojave për naftë bazuar në sasinë e harxhuar për përdorimin e mjeteve në vitet paraardhëse. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk mbështetet në bazë ligjore dhe si rrjedhojë nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*2. Sa i përket pretendimit nr.2: Procesverbalet në formë shkresore duhet të jenë të plotësuar me datën përkatëse dhe firmat e Njësisë apo Komisionit të Prokurimit në përputhje me përcaktimet e Normave Tekniko-Profesionale, neni 12, 13 dhe neni 18. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*3. Sa i përket pretendimit nr. 3: Neni 78, pika e dy e VKM nr. 285 për Rregullat e Prokurimit Publik përcakton se NJP ka për detyrim argumentimin ligjor dhe teknik të kriterëve kualifikuese të vendosura në DST. Nga verifikimi fizik dhe elektronik i procedurave të përzgjedhura për auditim, si dhe observacioneve të dërguara nga subjekti në formë shkresore dhe elektronike, u konstatua sërish se mungon argumentimi teknik lidhur me dy kriteret e sipërpërmendura.*

*Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

<b>4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2023”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 24 datë 18.01.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 24 datë 18.01.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 25 datë 18.01.2023
4. Lloji i Procedurës: Kërkesë për Propozim	1. E.Y, P. Prokurimesh 2. E.H, Juriste 3. M.B, Spec. Ushqimi	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. A.T, Anëtar
5. Fondi Limit: 1,533,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “4 S” ShPK, me vlerë 1,499,200 lekë pa TVSh, me kontratë datë 28.02.2023, me afat deri më 31.12.2023	7. Diferenca me fondin limit: 33,800 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.01.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

#### Fondi limit:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Bashkia Skrapar nr. 24, datë 18.01.2023, me nr. 134 prot. datë 18.01.2023, është ngritur Njësia e Prokurimit, me përbërje: z. E.Y, kryetar, me pozicion pune përgjegjës prokurimesh, znj. E.H, anëtare, me pozicion pune juriste dhe znj. M.B, anëtar, me pozicion pune specialiste ushqimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes e prokurimit, u konstatua se titullari i AK nuk ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Përlllogaritjen Fondit Limit. Në mungesë të një komisioni të posaçëm për hartimin e fondit limit, këtë funksion e kryen Njësia e Prokurimit ose specialisti i Prokurimeve, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 78, pika 2, ku përcaktohet se kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit). Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit, u konstatua se Njësia e Prokurimit ka përdorur metodën e testimit të tregut për të llogaritur vlerën e fondit limit. Me anë të procesverbalit për testimin e tregut me objekt “*Studim Tregu për çmimet e ushqimeve të Konviktit*”, të datës 18.01.2023, të firmosur nga vetëm dy anëtarë të Njesisë së Prokurimit, Njësia e Prokurimit ka administruar ofertat e tre subjekteve tregtare, duke nxjerrë mesataren e çmimit për çdo njësi. Për sa më sipër fondi limit i kësaj procedure është llogaritur në vlerën 1,533,000 lekësh pa TVSh. Në bazë të përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Njësia e Prokurimit duhet të kishte përlllogaritur fondin limit për mallrat objekt që do të prokuroheshin përpara Urdhërit të Prokurimit nga ana e titullarit të AK. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Njësia e Prokurimit ka hartuar Preventivin me çmimet së bashku me grafikun e lëvrimit të mallrave në perputhje me përcaktimet e VKM, nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 15, pika 3, shkronja b.

#### Hartimi i kriterëve:

Me datë 23.03.2023 është administruar procesverbali për hartimin e dokumenteve të tenderit. DST janë firmosur nga gjithë NJP, në përputhje me Kreu V, “*Zhvillimi i procedurave*”.

Në kriterin 2.3, shkronja i *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin e saj. Certifikatë ISO 2200-2018 ose ekuivalentin e saj, të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës.*

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 79 pika 1 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “*Për prokurimin publik*” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP dhe AKU-së nr. 1081, prot., datë 2018 “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e*

*produkteve ushqimore*". Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë teknike kriterin e mësipërm në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Këto veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr. 25 datë 18.01.2023, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2023" i cili përbëhet nga znj. R.LL, me funksion kryetar, z. N.G, me funksion anëtar dhe z. A.T, me funksion anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, z. N.G si anëtar i Komisionit të Vlerësimit. Z. G është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosja e z. N.G me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Skrapar, si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. A.M dhe z. N.G.

Në këtë procedurë kanë marrë dy OE, përkatësisht, M. ShPK me ofertë në vlerën e 1,451,795 lekë pa TVSh dhe S. ShPK me ofertë në vlerën e 1,499,200 lekë pa TVSh.

OE M. është skualifikuar nga procedura për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues në përputhje me kriterin 2.3. shkronja c të përcaktuar në DST.

Pas skualifikimit të OE MC Catering, NJP ka shpallur fitues OE S. ShPK.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e OE S u konstatua se:

1. Sipas kriterëve të veçanta në DST, konkretisht kriteri 2.3, shkronja c, OE nuk ka dorëzuar Lejen higjieno-sanitare të lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor dhe Licencë nga QKL për artikujt e qumështit dhe nënproduktet e tij.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë nga znj. R.LL, z. N.G, z. A.T.

Konkluzion: OE "S" shpk nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte, KVO nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, "Parimet e procesit të përzgjedhjes", pika 1 dhe neni 92 pika 3.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimet e Subjektit:**

*Për sa i përket konstatimit, -Në kriterin 2.3, shkronja i Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin e saj. Certifikatë ISO 2200-2018 ose ekuivalentin e saj, të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës.*

*- Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar bazës ligjore, konkretisht nenit 79 pika 1 të Ligjit nr.162. datë 23.12.2022 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP dhe AKU-së nr.1081, prot. Datë 2018 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore*

- Subjekti pretendon se ka argumentuar ligjërisht kriterit të mësipërm, duke iu referuar nenit 79 pika 1 të Ligjit nr.162. datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP dhe AKU-së nr.1081, prot. Datë 2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të vecanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në prapësimin e mësipërm, subjekti i është referuar bazës ligjore ku është mbështetur për vendosjen e këtij kriteri, por nuk ka argumentuar teknikisht vendosjen e tij. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Studim-Projektim “Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Corovodë””**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 285 datë 05.07.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 24 datë 18.01.2023	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 25 datë 18.01.2023
4. Lloji i Procedurës: Shërbime Konsulence	1. A.L, Nënkyetar i Bashkisë Skrapar 2. E.Y, P. Prokurimesh 3. J.K, Juriste	1. R.LL, Kryetar 2. N.G, Anëtar 3. B.M, Anëtar
5. Fondi Limit: 7,301,480 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “A” ShPK & “H” ShPK, me vlerë 6,980,000 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit: 321,480 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 30.01.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë Faza e parë: Pjesëmarrës në tender 6 OE, Skualifikuar 5 OE, Faza e dytë: Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

**Fondi limit:**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Skrapar nr. 285, datë 05.07.2023, me nr. 1699 prot., datë 05.07.2023, është ngritur Njësia e Prokurimit, me përbërje: z. A.L, kryetar, me pozicion pune Nënkyetar i Bashkisë Skrapar, z. E.Y, anëtar, me pozicion pune përgjegjës sektori dhe znj. J.K, juriste, me pozicion pune juriste. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit, u konstatua se titullari i AK nuk ka urdhëruar ngritjen e një Komisioni për Përlllogaritjen Fondit Limit. Në mungesë të një komisioni të posaçëm për hartimin e fondit limit, këtë funksion e kryen Njësia e Prokurimit ose specialisti i Prokurimeve, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2, ku përcaktohet se kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit).

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit dhe këqyrjes së fletës së inventarit (e pafirmosur nga Dorëzuesi dhe Marrësi), u konstatua mungesa e dokumentacionit përkatës që vërteton përlllogaritjen e fondit limit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, pika 2.

Hartimi i kriterëve: Me procesverbalin me objekt: “Për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim, specifikimeve teknike dhe kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të datës 07.07.2023, të firmosur nga anëtarët e NJP, Njësia e Prokurimit ka dhënë argumentat e saj mbi Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

Në kriterin 2.4., “Kërkesat e Cilësisë”, kërkohet: “Për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, ofertuesit duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e shërbimit, si më poshtë:



- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente)
- ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor) (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (Siguria dhe shëndeti në punë) (ose ekuivalente)

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe VKM-së nr. 285 datë 12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1).

Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar teknikisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 286 datë 05.07.2023, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Studim-Projektim “Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Corovodë””, i cili përbëhet nga znj. R.LL, me funksion kryetar, z. B.M, me funksion anëtar dhe z. N.G, me funksion anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezultoi se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, z. N.G si anëtar i Komisionit të Vlerësimit. Z. G është me pozicion pune Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues. Vendosija e z. N.G me detyrë Drejtor Finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Skrapar si anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezultoi të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. A.M dhe z. N.G.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 5 OE: A. ShPK, S. ShPK, BOE AMK ShPK dhe H. ShPK, N. ShPK. Pas shqyrtimit të bërë nga KVO, në fazën e parë të procedurës së prokurimit u skualifikuan këta operatorë ekonomikë: A, S, N, duke u kualifikuar: BOEA MK ShPK dhe H. ShPK dhe N. ShPK. Në fazën e dytë të procedurës, N. ShPK nuk ka paraqitur dokumentacion, duke rezultuar që BOE AMK ShPK dhe H. ShPK të jetë fituese e kësaj procedure.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se BOE fitues ka dorëzuar në mënyrë të plotë dhe të saktë dokumentacionin e kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimet e Subjektit:**

**1. Për sa i përket konstatimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes së prokurimit dhe këqyrjes së fletës së inventarit ( e pafirmosur nga Dorëzuesi dhe Marrësi), u konstatua mungesa e dokumentacionit përkatës që vërteton përlllogaritjen e fondit limit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021, për Rregullat e Prokurimit Publik, neni 76, pika 2.

- Subjekti pretendon se titullari i AK me urdhërin nr.197/1 datë 23.05.2023 “Për hartim detyrë projektimi, bazën e projektit si dhe fondin limit për projektin: Studim projektim “Rikualifikim urban në lagjen 5 shtatori Corovodë.

**2. Për sa i përket konstatimit:** -Në kriterin 2.4, “Kërkesat e Cilësisë”, si më poshtë.

*Për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, ofertuesit duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e shërbimit, si më poshtë:*

ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente)

ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor) (ose ekuivalente)

ISO 45001-2018 (Siguria dhe shëndeti në punë) (ose ekuivalente)

*-Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 “Kërkest e cilësisë”, pika 1).*

*-Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar teknikisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, neni 78, pika 2.*

*-Në dokumentacion bashkëngjitur observacionit, subjekti ka prapësuar konstatimin më lart, duke vënë në dukje se argumentimi teknik i certifikatave ndodhet në brendësi të këtyre certifikatave. Pavarësisht paraqitjes së funksionit të përgjithshëm që certifikatat kanë të përcaktuar në brendësi të tyre, neni 78, pika 2 e VKM nr. 25 për Rregullat e Prokurimit Publik, përcakton se argumentat lidhur me kriteret e vendosura duhet të shpjegojnë qartë lidhjen e këtyre kriterëve me objektin konkret të kontratës. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**1.** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar në formë shkresore dhe elektronike, nuk u konstatua urdhëri i sipërmendur. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë.

**2.** Në dokumentacion bashkëngjitur observacionit, subjekti ka prapësuar konstatimin më lart, duke vënë në dukje se argumentimi teknik i certifikatave ndodhet në brendësi të këtyre certifikatave. Pavarësisht paraqitjes së funksionit të përgjithshëm që certifikatat kanë të përcaktuar në brendësi të tyre, neni 78, pika 2 e VKM nr. 258 për Rregullat e Prokurimit Publik, përcakton se argumentat lidhur me kriteret e vendosura duhet të shpjegojnë qartë lidhjen e këtyre kriterëve me objektin konkret të kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

#### **Për zbatimin e dispozitave ligjore “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, të blerjeve me vlera të vogla”.**

Me urdhërin nr. 33, datë 26.01.2022, nga titullari i AK, z. A.M, për vitin 2022 është krijuar Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël me përbërje: E.Y (kryetar), me detyrë Specialist i Prokurimeve, XH.S (anëtar) me detyrë përgjegjëse sektori në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe R.G, me detyrë përgjegjës sektori në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse. Me urdhërin nr. 22, datë 18.01.2023 nga titullari i AK, z. A.M, është krijuar Komisioni për Blerjet me Vlerë të Vogël për vitin 2023, me përbërje: E.Y, (kryetar) me detyrë specialist i prokurimeve, T.SH (anëtar), me detyrë specialiste finance dhe A.H (anëtare) me detyrë specialiste finance. Me urdhërin nr. 493, titullari i AK, z. A.M ka ndryshuar përbërjen e komisionit si më poshtë: E.Y, (kryetar) me detyrë specialist i prokurimeve, T.SH (anëtar), me detyrë specialiste finance dhe A.G (anëtare) me detyrë specialiste finance.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Regjistri i Realizimeve i Prokurimeve me Vlerë të Vogël për vitin 2022) u konstatua copëzim fondi, konkretisht në 5 procedura prokurimi: “Blerje materiale për organizimin e dekorimeve për festat e fundvitit”, me fond limit 1,000,000 lekë, “Blerje Shpenzime të ndryshme për pritje-përcjellje, organizim evente dhe raste të tjera”, me fond limit 666,666 lekë, “Blerje materiale të ndryshme për festën e fëmijëve”, me fond limit 100,000 lekë, “Blerje materiale të ndryshme për organizim evente për 80-Vjetorin e Çlirimit”, me fond limit 100,000 lekë, “Blerje pllakatë, certifikatë dhe medalje

për rastet e ceremonive”, me fond limit 100,000 lekë. Vlera e procedurave të sipërmendura ka tejkaluar shumë tavan të vlerës 1 milion lekë, të përcaktuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 1, si dhe Udhëzimin nr. 5 datë 26.06.2021, “Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 1. Procedurat e mësipërme kanë funksion të ngjashëm, ndërkohë që shumatorja e 5 fondeve limit është 1,966,666 lekë. Për sa më sipër kemi të bëjmë me shmangien e rregullave të prokurimit, veprime dhe mosveprime që vijnë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 2, paragrafi 2 dhe Udhëzimit nr. 5 datë 26.06.2021, “Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3.

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Regjistri i Realizimit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël për vitin 2023) u konstatua copëzim fondi, konkretisht në 3 procedura prokurimi: “Blerje-Shërbime të ndryshme për pritje-përcjellje, organizim evente dhe raste të tjera”, me fond limit 1,000,000 lekë “Blerje materiale për organizimin e dekorit për festat e fundvitit 2023” me fond limit 600,000 lekë, “Organizime për festën e Çlirimit”, me fond limit 500,000 lekë, “Shpenzime për organizimin e festës së Rakisë”, me fond limit 500,000 lekë, “Blerje materiale të ndryshme për festën e fëmijëve”, me fond limit 100,000 lekë. Procedurat e mësipërme kanë funksion të ngjashëm, ndërkohë që shumatorja e 5 fondeve limit është 2,700,000 lekë duke tejkaluar vlerën 1,000,000 lekë të përcaktuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 1, si dhe Udhëzimit nr. 5 datë 26.06.2021, “Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 1. Për sa më sipër kemi të bëjmë me shmangien e rregullave të prokurimit, veprime dhe mosveprime që vijnë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 2, paragrafi 2 dhe Udhëzimit nr. 5 datë 26.06.2021, “Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 3.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

*Për sa i përket konstatimit për copëzim fondi në procedurat me vlerë të vogël për vitin 2022 dhe vitin 2023, subjekti pretendon se nuk kemi të bëjmë me procedura prokurimi me funksion të ngjashëm në rastin e dekorit ose organizimi eventesh.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Legjislacioni në fuqi për procedurat për prokurimin dhe në vecanti Udhëzimi nr. 5 datë 26.06.2021, “Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 1, përcakton se nuk duhet të prokurohen së bashku mallrat, punët apo shërbimet të me objekt të njëjtë ose të ngjashëm. Procedurat e përzgjedhura për t’u audituar për vitin 2022 dhe vitin 2023 janë procedura me objekt të ngjashëm, të cilat e tejkalojnë shumë tavan prej 1 milion lekësh të reja.

Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Procedurat e audituara nga prokurimet e AK “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar”, për vitin 2022:**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Materiale Ndërtimi për nevojat Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2022”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 08 datë 09.09.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 08 datë 09.09.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 42 datë 15.09.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. E.H, Juriste 2. L.H, Anëtar	1. V.N, Kryetar 2. E.M, Anëtar

	3. D.M, Anëtar	3. E.K, Anëtar
5. Fondi Limit: 3,908,666 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE "B" ShPK, me vlere 3,799,050 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 02, datë 14.10.2022, me afat deri në 31.12.2022	7. Diferenca me fondin limit: 109,616 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 26.09.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 18.

#### Fondi limit:

- Për hartimin e fondit limit nuk është mbajtur procesverbal dhe në dosje disponohet vetëm preventivi i materialeve, i nënshkruar nga preventivuesi, tekniku E.M dhe Drejtori i NShP, E.O.
- Nuk dokumentohet cila metodë është përdorur për të përllogaritur fondin limit, në kundërshtim me LPP, neni 34 *"Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit"* dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, *"Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës"*;
- Nga auditimi, u konstatua se për këtë procedurë prokurimi duhet të ishte zgjedhur *"Marrëveshje kuadër"*, duke pasur parasysh vëllimet e mallrave dhe afatin e lëvrimit të tyre; Përgjegjësia për llogaritjen e fondit limit është e teknikut z. E.M dhe z. E.O, Drejtor i NShP, ndërsa për zgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit është e z. E.O, Drejtor i NShP.

#### Kriteret e vlerësimit:

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 15.09.2022, i paprotokolluar;
  - Nga Njësia e Prokurimit nuk janë mbajtur procesverbale për dokumentimin e procesit, në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 2 *"Dokumentimi i procesit"*, pika 1. Gjithashtu, mosmbajtja e procesverbaleve është në kundërshtim edhe me nenin 74 *"Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit"*, pika 3, germa e) etj.
  - Në pikën 2.3.3. në DT kërkohet që OE pjesëmarrës të disponojnë *"Leje mjedisore, kodi III.1.b."*, e cila nga grupi i auditimit konstatohet e tepërt dhe e pambështetur në ligj, pasi OE ofertues nuk ka pse të jetë njëkohësisht edhe prodhues i materialeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të lejes mjedisore në fjalë;
  - Në pikën 2.3.6., kërkohet disponimi i një kamioni me kapacitet mbajtës 20-25 ton. Nga grupi i auditimit, kjo kërkesë konstatohet e papërshtatshme, pasi nisur nga vëllimet e mallrave dhe nga afati i lëvrimit të tyre edhe një mjet me kapacitet mbajtës 10-15 ton mund të ishte shumë i përshtatshëm për të garantuar realizimin me sukses të kontratës;
  - Për automjetin duhet të ishte kërkuar edhe leja e transportit, e lëshuar nga autoritetet vendore; Këto kriteret, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 *"Kërkesat për kualifikim"*, neni 2 *"Qëllimi"*, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 39 *"Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike"*, pika 1 dhe pika 3.
- Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.H, L.H dhe D.M.

#### Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

Rezultatet e vlerësimit sipas Raportit Përmbledhës, janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesmarrës	Oferta	Arsyet e kualifikimit/skualifikimit
1	B	3,799,050	<b>Kualifikuar dhe shpallur fitues</b>
2	K	10,755,600	<p><b>Skualifikuar pasi:</b>                      Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në sistem, nga ky operator ekonomik rezultoi se nuk plotëson kriteret e vendosura në DST Konkretisht pikat e mëposhtme:                      2.2.2. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar të leshuara nga bashkia në territorin e të cilit ushtron aktivitetin ky operator.                      2.3.3 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Leje mjedisore Tipi B kodi III.1.b të përcaktuar në dokumentat standarde të tenderit.                      2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet të përcaktuara në DST:                      Per këto kriter OE ka deklaruar mjetet e kerkuara por nuk ka specifikuar kapacitetin e mjetit dhe nuk ka hedhur në SPE dokumentat e mëposhtme:                      a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet:                      1. Leje qarkullimi (e vlefshme)                      2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)                      3. Police sigurimi (e vlefshme)                      b) për mjetet me qera,                      1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, I cili duhet të jete deri në përfundim të kontrates.                      2. Leje qarkullimi (e vlefshme)                      3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)                      4. Police sigurimi (e vlefshme)                      2.3.5 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur për mallin objekt prokurimi, raportin e testimit ose/dhe raportin e analizave ose/dhe skedë teknike, ku të pasqyrohen të gjitha karakteristikat e produktit, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.</p>

- Nga auditimi, u konstatua se skualifikimet nga KVO qëndrojnë.

- Formulari për njoftimin e fituesit është me datë 30.09.2022, pa numër protokoll.

- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 11.10.2022, i paprotokolluar, i miratuar nga titullari.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE “B” ShPK, është lidhur me nr. 02 prot., datë 14.10.2022, me afat deri në 31.12.2022, me vlerë 3,799,050 lekë pa TVSh;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- Në Formularin e vetëvlerësimit, OE B nuk ka specifikuar cilët nga punonjësit janë drejtues të automjeteve dhe cilët janë punëtorë ngarkim-shkarkimi. Nga verifikimi i listëpagesave, u konstatua se për muajin gusht 2022, në listëpagesë janë paraqitur 6 persona, të cilët sipas kodeve të profesioneve rezultojnë:

Kodi	Profesioni
1120.10	Drejtitor ekzekutiv në tregti
8111.11	Minator në karrierë
8322.01	Shofer
2421.06	Konsulent menaxhimi
2146.01	Inxhinier minierash
9623.03	Faturist

Sa më sipër, OE B nuk e plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2. në DT, pasi nuk ka të punësuar “2 (dy) punonjës duhet të jene si drejtues të automjeteve 2 (dy) punëtor ngarkim shkarkimi”;

- OE B. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., pasi raportet e testimi janë vetëm për artikullin granil mali i thyer, me përmasa të ndryshme. Për asnjë nga artikujt e tjerë të kërkuar nuk është paraqitur raport testimi.

**Konkluzion:** Sa më sipër OE B. ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT. KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE B. ShPK, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Në këto kushte, KVO ka vepruar në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.

Duke shpallur fitues OE B. ShPK, i cili nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, AK ka lidhur kontratë në vlerën **3,799,050 lekë** pa TVSH me OE të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga V.N, E.M dhe E.K, anëtarë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit** janë të njëjta me ato të paraqitura për Aktin e Konstatimit, pa paraqitur asnjë element, dokument apo material tjetër të panjohur nga Grupi i Auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër, **pretendimet nuk merren në konsideratë.** Nga materiali hiqet vetëm pjesa e kërkesës për xhiron vjetore, e cila është ezauruar dhe konstatimi për mungesën e urdhërit të titullarit, për caktimin e personit i cili duhet të hartojë fondin limit, pasi sipas LPP, person përgjegjës kur nuk ngrihet komisioni i posaçëm, është NjP.

**2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje naftë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Bashkia Skrapar për vitin 2022”**

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 01 datë 03.02.2022	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 01 datë 03.02.2022	3. Komisioni Vlerësimi Ofertave: Nr. 05 datë 14.02.2022
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. E.H, Juriste 2. L.H, Anëtare 3. D.M, Anëtar	1. V.N, Kryetar 2. E.M, Anëtar 3. E.K, Anëtar
5. Fondi Limit: 9,500,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “G” ShPK, me vlere 9,357,102 lekë pa TVSh, me kontratë datë 02.03.2022, me afat deri në 31.12.2022	7. Diferenca me fondin limit: 102,898 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 15.02.2022	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 2 OE b) Skualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

**Fondi Limit:**

Titullari i AK nuk ka ngritur një komision të posaçëm për përllogaritjen e fondit limit. Për këtë arsye, në zbatim të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2, kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit). Në procedurën e prokurimit të marrë në shqyrtim, Njësia e Prokurimit me përbërje si në tabelën më lart, me anë të një Procesverbali të datës 03.02.2022, ka përllogaritur sasinë e naftës që do të blihet me anë të procedurës së prokurimit, duke përdorur çmimin e naftës të paraqitur në bursën PLATTS. Nga kryerja e veprimeve matematikore, NJP ka përllogaritur një sasi prej 62,000 litra naftë që do të prokurohej. Në bazë të përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Njësia e Prokurimit

duhet të kishte përllogaritur sasinë e karburantit që do të prokurohej përpara lëshimit të Urdhërit të Prokurimit nga ana e titullarit të AK. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 76, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

#### Hartimi i kriterëve:

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, është bërë me procesverbalin pa numër, me datë 14.02.2022.

Në kriterin 2.7., kërkohet: *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjes të siguruar për periudhë, tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion si më poshte:*

- *Një vërtetim nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilim muaj, për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*
- *Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, por nuk ka argumentuar teknikisht dhe në mënyrë të zgjeruar mbi numrin konkret të punonjësve (3), të cilën e ka përcaktuar si kriter kualifikues. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2.

Në kriterin 2.3.8., kërkohet: *Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatë ISO 9001:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj.*

Njësia e Prokurimit ka argumentuar kriterin e mësipërm duke ju referuar nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2022 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit nuk ka argumentuar në mënyrë teknike në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Veprimet dhe mosveprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Titullari i AK, me Urdhërin nr. 05, datë 14.02.2022, me nr. 09 prot., datë 14.02.2022, ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje: V.N, Kryetar, E.M, Anëtar, E.K, anëtar.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. V.N si kryetar i Komisionit të Vlerësimit. Z. N është me pozicion pune përgjegjës i sektorit të financës, duke mbajtur gjithashtu detyrën e nëpunësit zbatues. Vendosja e z. V.N, me detyrë përgjegjës finance dhe nëpunës zbatues i Ndërmarrjs së Shërbimeve si kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK z. E.O dhe z. V.N.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është është shpallur fitues OE “G ” me ofertën ekonomike 9,397,102 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga verifikimi fizik dhe elektronik i dokumentacionit të dorëzuar nga OE “G”, u konstatua mungesa e vërtetimit se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale lidhur me veprimtarinë profesionale, sipas kërkesës me shkronjën d, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, shtojca 7, DST.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, pika 1 dhe neni 92 pika 3.

Për sa më sipër mban përgjegjësi KVO i përbërë nga z. V.N me funksion kryetar, z. E.M me funksion anëtar dhe z. E.K me funksion anëtar.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

*1. Për sa i përket konstatimit të kriterëve të paargumentuara teknikisht, përkatësisht: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjës të siguruar për periudhë, tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion si më poshtë: Një vërtetim nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilim muaj, për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatë ISO 9001”:2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalentin e saj.*

*Subjekti pretendon se ka argumentuar teknikisht nevojën e saj për numrin konkret prej 3 (tre) punonjësve të OE, si dhe pajisjen me Certifikatën ISO, duke radhitur në dokumentacionin bashkëngjitur Observacionit disa prej argumentave teknikë pse ka vendosur këto kriterë.*

*2. Referuar konstatimit se OE G SHPK nuk ka dorëzuar vërtetimin se nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë vepër penale të lidhur me veprimtarinë profesionale, subjekti pretendon se OE ka dërguar Formularin e Vetëdeklarimit në dokumentacionin e dorëzuar fizikisht dhe elektronikisht në SPE.*

*3. Për sa i përket konstatimit “Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këto procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, , z. V.N si kryetar i Komisionit të Vlerësimit. Z. N është me pozicion pune përgjegjës i sektorit të financës, duke mbajtur gjithashtu detyrën e nëpunësit zbatues. Vendosja e Z.N V.N , me detyrë përgjegjës finance dhe nëpunës zbatues i Ndërmarrjs së Shërbimeve, si kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.”*

*-Subjekti e pranon këtë parregullsi, duke u justifikuar me mungesën e burimeve njerëzore.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*1. Neni 78, pika e 2 e VKM nr. 285 për Rregullat e Prokurimit Publik përcakton se NJP ka për detyrim argumentimin ligjor dhe teknik të kriterëve kualifikuese të vendosura në DST. Gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik dhe elektronik të procedurës të përzgjedhur për auditim, konkretisht DST, nuk u konstatuan argumentat e paraqitura në Observacion. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*2. VKM nr. 285, për Rregullat e Prokurimit Publik, Neni 26, pika 6, detyron KVO të kërkojë dokumentacion provues për një pjesë të pikave të vetëdeklarimit që kryhet nga operatori ekonomik,*



përfshirë këtu edhe dokumentacionin provues se OE nuk është dënuar me vendim të formës së prere për ndonjë vepër penale në lidhje me veprimtarinë profesionale. Nga verifikimi fizik dhe elektronik në SPE, u konstatua mungesa e dokumentacioni të të sipërpërmendur. Për sa më sipër ky pretendim i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**3. Argumenti është i pabazuar në ligj dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.**

**Procedurat e audituara nga prokurimet e AK “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar”, për vitin 2023:**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Materiale Ndërtimi për nevojat Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2023”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 07 datë 08.06.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 07 datë 08.06.2022	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 35 datë 08.06.2023
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar	1. E.H, Juriste 2. L.H, Anëtar 3. D.M, Anëtar	1. V.N, Kryetar 2. E.M, Anëtar 3. E.K, Anëtar
5. Fondi Limit: 3,962,494 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “B ” ShPK, me vlere 3,920,031 lekë pa TVSh, me kontratë nr. 62, datë 14.07.2023, me afat deri në 31.12.2023	7. Diferenca me fondin limit: 42,463 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit: 06.07.2023	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

**Nga auditimi, u konstatua si më poshtë:**

Të gjithë procesverbalet e mbajtur gjatë zhvillimit të procedurës janë të paprotokolluar, në kundërshtim me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

**Fondi limit:**

- Për hartimin e fondit limit nuk është mbajtur procesverbal dhe në dosje disponohet vetëm preventivi i materialeve, i nënshkruar nga preventivuesi, tekniku E.M dhe Drejtori i NShP, E.O.

- Nuk dokumentohet cila metodë është përdorur për të përllogaritur fondin limit, në kundërshtim me LPP, neni 34 “Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit” dhe Rregullat e prokurimit publik, neni 12, “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës”.

- Nga auditimi, u konstatua se për këtë procedurë prokurimi duhet të ishte zgjedhur “Marrëveshje kuadër”, duke pasur parasysh vëllimet e mallrave dhe afatin e lëvrimit të tyre; Përgjegjësia për llogaritjen e fondit limit është e teknikut z. E.M dhe z. E.O, Drejtor i NShP, ndërsa për zgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit është e z. E.O, Drejtor i NShP.

**Kriteret e vlerësimit:**

- Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, nga NJHDT është mbajtur procesverbali datë 23.06.2023, i paprotokolluar;

- Nga Njësia e Prokurimit nuk janë mbajtur procesverbale për dokumentimin e procesit, në kundërshtim me Rregullat e prokurimit publik, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 1.

Gjithashtu, mosmbajtja e procesverbaleve është në kundërshtim edhe me nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3, germa e), etj.

- Në pikën 2.3.3. në DT kërkohet që OE pjesëmarrës të disponojnë “Leje mjedisore, kodi III.1.b.”, e cila nga grupi i auditimit konstatohet e tepërt dhe e pambështetur në ligj, pasi OE

ofertues nuk ka pse të jetë njëkohësisht edhe prodhues i materialeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve të lejes mjedisore në fjalë, ndërsa kërkesa që kjo leje të jetë jo më larg se 50 km nga Bashkia Skrapar, nga grupi i auditimit konstatohet e tepërt, e pambështetur në ligj dhe diskriminuese për OE të cilët mund të jenë më larg se 50 km nga Bashkia Skrapar, por për arsye të ndryshme mund të ofertojnë çmim më të favorshëm;

- Në pikën 2.3.6., kërkohet disponimi i një kamioni me kapacitet mbajtës 20-25 ton. Nga grupi i auditimit, kjo kërkesë konstatohet e papërshtatshme, pasi nisur nga vëllimet e mallrave dhe nga afati i lëvrimin të tyre edhe një mjet me kapacitet mbajtës 10-15 ton mund të ishte shumë i përshtatshëm për të garantuar realizimin me sukses të kontratës;

- Për automjetin duhet të ishte kërkuar edhe leja e transportit, e lëshuar nga autoritetet vendore; Këto kritere, nuk përmbushin parashikimet e LPP, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 2 “Qëllimi”, pikat c), ë), dhe d), si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 1 dhe pika 3.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.H, L.H dhe D.M.

#### Vlerësimi i ofertave:

- Për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga KVO nuk është mbajtur procesverbal, por KVO është mjaftuar vetëm me gjurmët e lëna në SPE.

Sipas Raportit Përmbledhës, në procedurë ka marrë pjesë vetëm OE “B” ShPK, me ofertën 3,920,031 lekë pa TVSh, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;

- Formulari për njoftimin e fituesit është me datë 11.07.2022, pa numër protokollit.

- Raporti përmbledhës është mbajtur në datën 12.07.2023, i paprotokolluar, i miratuar nga titullari.

- Kontrata ndërmjet AK Bashkia Skrapar dhe OE “B” ShPK, është lidhur me nr. 62 prot., datë 14.07.2023, me afat deri në 31.12.2023, me vlerë 3,920,031 lekë pa TVSh;

Nga shqyrtimi i ofertës fituese dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë AK, rezultoi si më poshtë:

- Në Formularin e vetëvlerësimit, OE B nuk ka vendosur referencat e dokumentacionit mbështetës për deklaratimet e bëra;

- OE B , nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4., pasi raportet e testimit janë vetëm për artikullin granil mali i thyer, me përmasa të ndryshme. Për asnjë nga artikujt e tjerë të kërkuar nuk është paraqitur raport testimi.

**Konkluzion:** Megjithëse KVO në vlerësimin e kësaj procedure prokurimi është mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 2, sipas të cilit mangësitë e sipërpërmendura mund të konsiderohen si devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, nga KVO duhet të ishte specifikuar kjo gjë në një procesverbal të posaçëm, si dhe duhet të ishte pasqyruar në Raportin Përfundimtar, drejtuar titullarit të AK.

Për sa më sipër, OE B. ShPK nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar OE B. ShPK.

Në këto kushte, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi 1.

Për veprimet/mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për vlerësimin e ofertave, i përbërë nga V.N, E.M dhe E.K, anëtarë.

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Naftë për Nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për Vitin 2023”</b>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 01 datë 23.01.2023	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: 1. E.H, Juriste 2. L.H, Anëtare 3. D.M, Anëtar	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: 1. V.N, Kryetar 2. E.M, Anëtar 3. E.K, Anëtar
4. Lloji i Procedurës: E hapur e thjeshtuar		
5. Fondi Limit: 9,558,000 lekë pa TVSh.	6. Oferta fituese: OE “G” ShPK, me vlere 9,183,140 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit: 374,860 lekë pa TVSh
8. Data e hapjes së tenderit:	9. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkise	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 1 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

### Fondi Limit:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Bashkia Skrapar nr. 01, datë 23.01.2023, me shkresën nr. 15 prot. datë 23.01.2023, titullari i AK ka iniciuar procedurën e prokurimit të llojit e hapur, e thjeshtuar, me objekt: “Blerje naftë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Bashkia Skrapar për vitin 2023”, me fondin limit 9,558,000 lekë pa TVSh. Njësia e Prokurimit përbëhet nga E.H, me funksion kryetar, me pozicion pune juriste, L.H me funksion anëtar, pozicion pune përgjegjës sektori i gjelbërimit, dhe D.M, me funksion anëtar, me pozicion pune mbikqyrës. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes e prokurimit, u konstatua se titullari i AK nuk ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Përllogaritjen Fondit Limit. Në mungesë të një komisioni të posaçëm për hartimin e fondit limit, këtë funksion e kryen Njësia e Prokurimit ose specialisti i Prokurimeve, në zbatim të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2, ku përcaktohet se kjo përgjegjësi i takon specialistit të prokurimeve ose Njesisë së Prokurimit, (në rastin konkret Njesisë së Prokurimit). Në procedurën e prokurimit të marrë në shqyrtim, Njësia e Prokurimit me përbërje si në tabelën më lart, me anë të një procesverbali të datës 23.01.2023, ka përllogaritur sasinë e naftës që do të blihet me anë të procedurës së prokurimit, duke përdorur çmimin e naftës duke iu referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Nga kryerja e veprimeve matematikore, NJP ka përllogaritur një sasi prej 58,000 litra naftë që do të prokurohej.

### Hartimi i kritereve:

Me procesverbalin e datës 30.01.2023, të pafirmosur nga anëtarët e NJP, me objekt: “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Në kriterin 2.3.7., kërkohet që **Operatori ekonomik ofertues**, për realizimin e kesaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **3 persona** për periudhën, 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

- List pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së ofertave.

Për sa më sipër, NJP ka argumentuar kriterin duke u mbështetur në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pavarësisht referimit në bazën ligjore të sipërpërmendur, NJP nuk ka argumentuar teknikisht dhe në mënyrë të zgjeruar mbi numrin konkret të punonjësve (3), të cilën e ka përcaktuar si kriter kualifikues. Veprimet dhe mosveprimet bie në kundërshtim me

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2.

#### Vlerësimi i Ofertave:

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. V.N si kryetar i Komisionit të Vlerësimit. Z. N është me pozicion pune përgjegjës i sektorit të financës, duke mbajtur gjithashtu detyrën e nëpunësit zbatues. Vendosija e z. V.N , me detyrë përgjegjës finance dhe nëpunës zbatues i Ndërmarrjs së Shërbimeve, si kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.

Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK z. E.O dhe z. V.N.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 OE “G” ShPK, i cili është kualifikuar dhe shpallur fituese po ky operator me ofertën 9,183,140 lekë pa TVSh.

Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 2 dhe 84 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Operatori fitues nuk ka dorëzuar vërtetimin se nuk është dënuar për ndonjë veper penale sipas kërkesës d të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit, shtojca 7, DST.

Për sa më sipër konstatohet se KVO duhet të kishte skualifikuar OE “G” ShPK dhe të kishte përfunduar procedurën pa fitues si rrjedhojë e dorëzimit të një dokumentacioni jo të plotë dhe jo në përputhje me përcaktimet e DST.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi KVO i përbërë nga V.N (kryetar), E.M (Anëtar), S. M (Anëtar).

KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, pika 1 dhe neni 92 pika 3.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

#### **Pretendimet e Subjektit:**

1. Për sa i përket konstatimit të kriteve të paargumentuara teknikisht, përkatësisht: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të pakten 3 (tre) punonjës të siguruar për periudhë, tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion si më poshtë: Një vërtetim nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilim muaj, për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Në observacion, subjekti pretendon se ka argumentuar teknikisht kriterin mesipërm duke radhitur disa prej këtyre argumentave.

2. Referuar konstatimit se OE G SHPK nuk ka dorëzuar vërtetimin se nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë vepër penale të lidhur me veprimtarinë profesionale, subjekti pretendon se OE ka dërguar Formularin e Vetëdeklarimit në dokumentacionin e dorëzuar fizikisht dhe elektronikisht në SPE.

3. Për sa i përket konstatimit “Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në këtë procedurë prokurimi të përzgjedhur për auditim, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, , z. V.N si kryetar i Komisionit të Vlerësimit. Z. N është me pozicion pune përgjegjës i

sektorit të financës, duke mbajtur gjithashtu detyrën e nëpunësit zbatues. Vendosija e Z.N V.N , me detyrë përgjegjës finance dhe nëpunës zbatues i Ndërmarrjs së Shërbimeve, si kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1. Sa i përket pretendimit nr. 1 Neni 78, pika e 2 e VKM nr. 285 për Rregullat e Prokurimit Publik përcakton se NJP ka për detyrim argumentimin ligjor dhe teknik të kriterëve kualifikuese të vendosura në DST. Gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik dhe elektronik të procedurës të përzgjedhur për auditim, konkretisht DST, nuk u konstatuan argumentat e paraqitura në Observacion. Për sa më sipër pretendim i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

2. Sa i përket pretendimit nr.2, Neni 26, pika 6, VKM nr. 285, për Rregullat e Prokurimit Publik, detyron KVO të kërkojë dokumentacion provues për një pjesë të pikave të vetëdeklarimit që kryhet nga operatori ekonomik, përfshirë këtu edhe dokumentacionin provues se OE nuk është dënuar me vendim të formës së prere për ndonjë vepër penale në lidhje me veprimtarinë profesionale. Nga verifikimi fizik dhe elektronik në SPE, u konstatua mungesa e dokumentacioni të të sipërpërmendur. Për sa më sipër ky pretendim i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

3. Sa i përket pretendimit nr. 3, argumenti është i pabazuar në ligj dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.**

Në Bashkinë Skrapar, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, në bazë të vlerës së kontratës janë përzgjedhur për auditim objektet:

Nr.	Objekti	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Kontraktori	Shënime
1	“Ndërtim mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish kantieri N.N, Bashkia Çorovodë”	50,628,700	OE “D” ShPK	Me shkelje
2	“Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”	12,746,600	OE “F” ShPK	Me shkelje

**1. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë”, Bashkia Skrapar.**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2764 prot., datë 30.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A.M, dhe sipërmarrësit të punimeve OE “D” ShPK me licencë NZ. 2383/23, me administrator znj. S.SH. Vlera e kontratës është 50,628,700 lekë pa TVSh ose 60,754,440 lekë me TVSh. Afati i realizimit të kontratës është 82 ditë e përlllogaritur nga data e fillimit të punimeve dhe garancia e punimeve është 24 (njëzet e katër) muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për këtë objekt është lidhur kontratë shërbimi me nr. 2753 prot, datë 29.09.2022, ndërmjet Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A.M dhe OE “HH” ShPK me administrator z. F.B, me Lic. MK. 2018/22. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 856,492 lekë me TVSh me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontratë kolaudimi punimesh ndërtimi ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe OE “A” ShPK me administrator z. LL.T, me nr. lic. MK. 1666/3. Vlera e kontratës së kolaudimit 202,400 lekë me TVSh. Leja infrastrukurore për objektin e kontraktuar është lëshuar nga Kryetari Bashkisë Skrapar, me nr. 39, datë 05.10.2022.

Punimet kanë filluar në datën 24.10.2022, ndërsa Njoftimi për përfundimin e punimeve është me shkresën nr. 319 prot., datë 16.12.2022 nga mbikëqyrësi i punimeve. Akti i kolaudimit është realizuar me datë 23-24 dhjetor 2022.

Certifikata e Përkohshme e marrjes në dorëzim është hartuar në datën 29.12.2022, nga grupi i marrjes në dorëzim: B.Z, G.M dhe Z.M, sipas Urdhërit nr. 419, datë 29.12.2022 të Titullarit të Bashkisë Skrapar.

Me shkresën datë 07.11.2022, dërguar në mbikëqyrësit nga OE dhe shkresën nr. 06/11 prot., datë 07.11.2022, dërguar në Bashkinë Skrapar nga mbikëqyrësi i punimeve, është kërkuar të rishikohet preventivi i punimeve për të miratuar ndryshimet përkatëse nga palët. Me procesverbalin datë 16.11.2022, janë miratuar nga palët (Bashkia Skrapar, Mbikëqyrësi punimeve dhe Kontraktori) ndryshimet në projektin e zbatimit dhe volumet përkatëse sipas ndryshimeve që kanë pësuar.

Në procesverbalin e rishikimit të volumeve vlera e punimeve më tepër rezultojnë të jetë 9,409,290 lekë pa TVSh dhe vlera e punimeve më pak 6,998,400 lekë pa TVSh. Kjo diferencë mbulohet nga fondi rezervë, sipas Procesverbalit të përdorimit të fondit rezervë të miratuar nga Autoriteti Kontraktor më datë 16.11.2022. Ditari i punimeve fillon nga data 27.10.2022 deri më datë 12.12.2022. Dosja e punimeve përmban procesverbale të ndryshme mbi zbatimin e punimeve, procesverbale për punimet e maskuara dhe testimet të ndryshme mbi rezistencën kubike të betoneve.

#### Lidhur me Raportet e testimet dhe Certifikatat e cilësisë së materialeve.

Pjesë e dosjes së zbatimit janë Raportet e testimet për betonin e brezit të mureve, ku rezultojnë se janë 4 raporte testi, përkatësisht në datat: 30.11.2022, 09.12.2022, 12.12.2022 dhe 17.12.2022. Gjithashtu në dosje ndodhet Certifikata e origjinës nr. 270, datë 06.12.2022, për materialin rrjeta gabion. Rezultojnë se në dosje mungon Raport testi për gurin e përdorur për ndërtimin e murit, i cili sipas specifikimeve teknike duhet të përmbushë kërkesat në përmasa dhe formë. Raporti i testimet për zhavorrin e përdorur për mbushjen anash murit dhe certifikata e cilësisë për rrjetën e gabionit me përmasa (1x1x1) m. Kërkesa këto të përcaktuara specifikimeve teknike, kushtet e kontratës dhe referuar pikës 3, kreu II, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”.

Lidhur me zbatimin e kontratës rezultojnë diferenca në volume, si vijon:

Seksioni	Nr. An.	Përshkrimi	Sasia e munguar	Çmimi	Vlera lekë
2	<b>Punime murature</b>				
	3.243/1	Beton M-200 për brez betoni	25 m <sup>3</sup>	12,500	312,500
	3.771/e	Transport betoni me autobetonier	25 m <sup>3</sup>	1000	25,000
<b>Totali</b>					<b>337,500</b>
<b>TVSh</b>					<b>67,500</b>
<b>Totali me TVSH</b>					<b>405,000</b>

- Zëri “Beton M-200 për brez betoni”, në librezën e masave është pasqyruar 173 m<sup>3</sup> dhe në situacionin përfundimtar është deklaruar 173 m<sup>3</sup>. Nga matjet në terren (në një segment 300 ml) dhe referuar librezës së masave, rezultoi se vëllimi real është 148 m<sup>3</sup>. Pra janë deklaruar 25 m<sup>3</sup> beton, më tepër në situacionin përfundimtar.

- Zëri “Transport betoni me autobetoniere”, në librezën e masave është pasqyruar 173 m<sup>3</sup> dhe në situacionin përfundimtar është deklaruar 173 m<sup>3</sup>. Nga matjet në terren dhe referuar librezës së masave, rezultoi se vëllimi real është 148 m<sup>3</sup>. Pra janë deklaruar se është transportuar 25 m<sup>3</sup> beton, më tepër në situacionin përfundimtar.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; UKM nr. 2, datë 13.05.2005, pika 3, kreu II dhe Kontrata e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2764 prot, datë 30.09.2022.

## **2. Mbi realizimin e kontratës me objekt “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”, Bashkia Skrapar.**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 3594 prot., datë 27.12.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A.M, dhe sipërmarrësit të punimeve OE “F” ShPK me licencë NZ. 4048/19, me administrator z. F.M . Vlera e kontratës është 10,662,150 lekë pa TVSh ose 12,746,600 lekë me TVSh. Afati i realizimit të kontratës është 105 ditë e përllogaritur nga data e fillimit të punimeve dhe garancia e punimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë” është lidhur kontratë shërbimi me nr. 352 prot, datë 20.12.2022, ndërmjet Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A.M dhe OE “A” ShPK me administrator znj. N.M, me Lic. MK. 2892/7. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 267,663 lekë me TVSh me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontratë kolaudimi punimesh ndërtimi nr. 2194, datë 28.08.2023, ndërmjet Bashkisë Skrapar dhe OE “D & P ” ShPK me administrator z. H.LL, me licence nr. MK. 4190. Vlera e kontratës së kolaudimit 24,180 lekë me TVSh. Punimet kanë filluar në datën 26.01.2023, ndërsa Njoftimi për përfundimin e punimeve është me shkresën datë 17.07.2023 nga mbikëqyrësi i punimeve. Me Amendamentin nr. 01, protokolluar me nr. 3594/1, datë 06.04.2023, është miratuar shtyrja e afatit të punimeve, e kushtëzuar me daljen e VKM përkatëse për shpronësimin e një objekti ndërtesë, i cili preket nga zbatimi i projektit. Akti i kolaudimit është realizuar me datë 20.10.2023.

Certifikata e Përkohshme e marrjes në dorëzim është hartuar në datën 13.11.2023, nga grupi i marrjes në dorëzim B.M, G.M dhe J.D.

Me shkresën datë 23.03.2023, dërguar në mbikëqyrësit nga OE dhe shkresën datë 28.03.2023, dërguar në Bashkinë Skrapar nga mbikëqyrësi i punimeve, është kërkuar të rishikohet preventivi i punimeve për të miratuar ndryshimet përkatëse nga palët. Me procesverbalin datë 12.06.2023, janë miratuar nga palët (Bashkia Skrapar, Mbikëqyrësi punimeve dhe Kontraktori) ndryshimet në projektin e zbatimit dhe volumet përkatëse sipas ndryshimeve që kanë pësuar, ndërsa ky procesverbal nuk është miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në procesverbalin e rishikimit të volumeve vlera e punimeve më tepër rezulton të jetë 1,444,800 lekë pa TVSh dhe vlera e punimeve më pak 1,444,800 lekë pa TVSh. Ditari i punimeve fillon nga data 26.01.2023 deri më datë 05.04.2023 dhe nga data 09.06.2023 deri 17.07.2023. Dosja e punimeve përmban procesverbale të ndryshme mbi zbatimin e punimeve, procesverbale për punimet e maskuara dhe testimet të ndryshme mbi rezistencën kubike të betoneve.

### Lidhur me Raportet e testimit dhe Certifikatat e cilësisë së materialeve.

Pjesë e dosjes së zbatimit janë Raportet e testimit për betonin, ku rezulton se është një raport testimi, datë 27.10.2023, për 3 kubikë mostra e marrë datë 18.02.2023 dhe 23.02.2023. (sipas specifikimeve teknike duhen deri 15 m<sup>3</sup>, ndërsa mbi këtë volum duhen kryer për çdo 30 m<sup>3</sup>). Në dosje ndodhet certifikatë ISO 9001-2015 për hekurin e betonit nga “Kurum Internacional” ShA. Gjithashtu, ndodhen raporte për “zall i fraksionuar” për prodhim betoni, kryer nga laborator i shoqërisë ndërtuese “F” ShPK.

Rezulton se duhet të kryheshin më shumë prova laboratorike për betonet për sasinë mbi 30 m<sup>3</sup>. Rezulton se mungon Raporti i testimit për pllakat e gurit, për çakëll mbeturinë kave përdorur për shtresën e sheshit. Nuk janë të plota certifikatat e cilësisë për ndriçuesit, shtyllat metalike të ndriçimit dhe për të gjithë materialet elektrike të përdorura. Mungojnë certifikatat e cilësisë për tapetin e gomës, për lodrat e fëmijëve, për tubot PVC 250 mm, për stolat dhe tavolinat, etj.

Kërkesa këto të përcaktuara në specifikimet teknike, kushtet e kontratës dhe referuar pikës 3, kreu II, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”.

Projekti bazë i zbatimit dhe projekti i ndryshuar, nuk kanë të përshkruar me skica dhe përmasa, detajet lidhur me zërat e punimit që realizohen, mungon detaji për shtresën e pllakave, për shtresat e sheshit dhe trotuarit, për muret dhe rampat, etj.

Gjithashtu librezat e masave nuk ka të përshkruar me skica dhe përmasa zërat e punimeve të realizuar sipas volumeve përkatëse.

Nga verifikimi vizual në objekt konstatohet rënie e disa pllakave që kanë veshur muret mbajtëse të shkallëve, si dhe tapeti i gomës dhe lojërat për fëmijë ka pësuar dëmtime. Aktualisht objekti është brenda periudhës së garancisë së punimeve.

Lidhur me zbatimin e kontratës rezultojnë diferenca në volume, si vijon:

Nr. An.	Përshkrimi	Sasia e munguar	Çmimi	Vlera lekë
<b>Punime gjërmimi dhe mbushje</b>				
2.121/1	Brez b/a C16/20, mbi mur guri	12.5 m <sup>3</sup>	1700 (14,200-12,500)	21,250
3.243/1	Beton C 16/20, shtresë me t=15 cm, për shesh, rampa, shkallët	5.5 m <sup>3</sup>	11,500	63,250
3.343/1	Strukturë monolite betoni C 16/20	4.56 m <sup>3</sup>	12,500	57,000
An 164	F.v. fidanë pemë dekorative	3	13,000	39,000
<b>SHUMA pa TVSh</b>				<b>216,600</b>

- Zëri “Brez b/a C16/20 mbi Mur guri”, në situacionin përfundimtar është deklaruar 15.78 m<sup>3</sup>. Nga verifikimi i të dhënave në librezën e masave, rezultoi se brenda këtij zëri është përfshirë edhe volumi 12.5 m<sup>3</sup>, i cili është punim që i përket zërit 3.243/1 “Shtresë b/a”, për rrjedhojë është krijuar një diferencë në çmim në vlerën 1,700 lekë (14,200-11,500), duke përfituar më tepër 21,500 lekë (1,700 lekë\*12.5 m<sup>3</sup>).

- Zëri “Beton C 16/20, shtresë t=15 cm mbi mur guri”, në situacionin përfundimtar është deklaruar 209.5 m<sup>3</sup>, aq pasqyron edhe librezat e masave, Në fakt duke ju referuar të dhëna në librezën e masave, rezulton se përlogaritjet nuk janë të sakta për rrjedhojë është situacionuar më tepër volumi 5.5 m<sup>3</sup> (209.5-204), e cila është përfituar më tepër nga kontraktori.

- Zëri “Strukturë monolite betoni C 16/20, për krijim disnivelesh në rampa dhe shkallë”, në situacionin përfundimtar është deklaruar 87.3 m<sup>3</sup>, aq pasqyron edhe librezat e masave. Në fakt duke ju referuar të dhënave në librezën e masave, ky zë është realizuar në masën volumi 82.74 m<sup>3</sup>. Brenda këtij zëri rezultoi se është përfshirë edhe volumi 4.56 m<sup>3</sup>, i cili është punim që i përket zërit An. 5 “F.V. Stola guri me ulëse dërrase”, për rrjedhojë është krijuar një diferencë volumi 4.56 m<sup>3</sup> (87.3-82.74), e përfituar më tepër nga kontraktori.

- Zëri “F.V fidanë pemësh dekorative”, në situacionin përfundimtar janë deklaruar 19 copë të vendosura. Nga verifikimi i bërë në terren, rezultoi se ishin vendosur 16 fidanë pemë dekorative. Pra janë deklaruar 3 fidanë më tepër në situacionin përfundimtar.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; UKM nr. 2, datë 13.05.2005, pika 3, kreu II dhe Kontrata e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3594 prot, datë 27.12.2022.

Për sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, është paraqitur observacion në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 72/4, datë 19.04.2024, ardhur në KLSH me nr. 36/5, datë 22.04.2024, nga znj. N.M përfaqësuesi i subjektit “A” shpk, kontraktuar për mbikëqyrjen e punimeve.

**Pretendimet e Subjektit:**

*Raportet e testimit dhe Çertifikatat e cilësisë së materialeve.*



Përsa i përket raport Testimeve të betonit të hedhur në objekt në akt Konstatim shprehet se janë marrë mostra vetëm në datat 18.02.2023 dhe 23.02.2023, por në fakt kemi marrë mostra dhe kemi kryer raport testimi edhe në datat 08.02.2023 dhe 10.02.2023, të cilat vërtetohen me Raport Testimin nr.141, dt.27.10.2023. Njëkohësisht nga ana e Kontraktorit të punimeve është vënë në dispozicion Çertifikata ISO, raport analizat për inertet e përdorura për betonin si dhe Receptura e betonit e markës C16/20, të cilat vërtetojnë më së miri cilësinë e prodhimit dhe hedhjes së tij në objekt. Këto dokumenta gjenden në dosjen teknike të objektit si dhe një kopje e tyre bashkëlidhet me këtë Observacion.

Përsa i përket çertifikatave të cilësisë për shtyllat metalike të ndriçimit dhe gjithë materialeve elektrike të përdorura, Ju bëjmë me dije se edhe këto materiale të instaluar në objekt janë konform standarteve e kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit dhe janë prodhime të kompanisë së çertifikuar në këtë fushë siç është E. sh.p.k. nga e cila janë blerë materialet e lartpërmendura, çertifikimet e kësaj kompanie gjenden në dosjen teknike të objektit si dhe një kopje e tyre gjendet bashkëlidhur observacionit.

Përsa i përket çertifikatave të cilësisë së pllakave të gurit, stolave dhe tavolinave, kontraktori në gjetjen dhe përgatitjen e materialeve prej guri, është referuar në specifikimet teknike të projektit ku shprehet se këto të fundit do të realizohen me material të zonës, pra me gurë të zonës së Skraparit, i cili është i çertifikuar edhe nga Komuniteti Europian dhe përdoret dhe eksportohet gjerësisht në vendet e europiane. Pra si përfundim të situatës 1, Ju shprehim se çdo material i përdorur në objekt është i çertifikuar sipas standarteve dhe kushteve teknike të zbatimit.

Përsa i përket konstatimit vizual të rënies së disa pllakave të gurit në muret e shkallëve, kjo qëndron, duke shprehur angazhimin e menjëhershëm të kontraktorit të punimeve për rivendosjen e tyre në vendet e munguara. Ky proces u realizua menjëherë pas konstatimit në vend nga ana Juaj duke u vendosur çdo mungesë e gjetur dhe plotësuar të gjithë objektin me shtresë pllaka guri, i cili u evidentua me foto të rivendosjes para jush.

Diferenca në volume e punimeve.

-Zëri «Brez b/a C16/20 mbi mur guri» në situacionin përfundimtar është deklaruar 15.78 m<sup>3</sup> dhe nga verifikimi i librezës së masave rezulton se është përfshirë edhe në zërin 3.243/1 «Shtresë b/a» duke përfutur më tepër 21,500lekë.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi në librezën e masave për zërin «Brez b/a C16/20 mbi mur guri» është pasqyruar vetëm sasia e betonit të hedhur si brez mbi muret e gurit të realizuar në objekt nga kontraktori dhe njëkohësisht nuk ka përsëritje të këtij volumi edhe në librezën e hartuar për zërin tjetër 3.243/1, «Shtresë b/a», pasi në volumin e këtij zëri është përfshirë vetëm shtresa e betonit t=15cm e të gjithë sheshit, sheshit të shkallëve, sheshit të rampave ngjitëse e zbritëse në shesh etj. **Pra si përfundim mund të shprehim se kjo vlerë prej 21,500lekë e përfutur padrejtësisht, nuk qëndron.**

-Zëri «Beton C16/20 shtrese me t=15cm, për sheshin, rampat, shkallët», e cila është deklaruar në sasinë 209.5m<sup>3</sup> në situacionin përfundimtar, por sipas përlllogaritjeve të librezës së masave gjendet një diferencë 5.5m<sup>3</sup> më pak, e cila është përfutur më tepër nga kontraktori.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi volumi i pasqyruar në situacionin përfundimtar është i bazuar në përlllogaritjet volumetrike të pasqyruara në librezën e masave e cila shpreh qartë çdo volum betoni të hedhur në objekt për këtë punimi. Duke iu referuar përlllogaritjeve të librezës del qartë që volumi i përlllogaritur është i saktë në sasinë 209.5m<sup>3</sup> dhe jo 204 m<sup>3</sup> siç pretendohet në këtë akt konstatim. **Pra si përfundim mund të shprehim se kjo vlerë prej 63,250 lekë e përfutur padrejtësisht, nuk qëndron.**

-Zëri «FV pusëtë plastike 40x40x40, kapak të fortë RICE 1084+1086» ku në situacionin përfundimtar janë pasqyruar 14copë dhe nga verifikimi i bërë në teren rezultojnë se ishin vetëm 10copë, pra janë përfutur më tepër 4copë puseta.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi në situacionin përfundimtar ashtu edhe në objekt janë vendosur 14copë puseta plastike të cilat përkojnë me shtyllat metalike të ndriçimit të objektit të cilat janë evidente në objekt por 4copë prej tyre kanë qenë të mbuluar nga pllakat e gurit të cilat janë përdorur për shtrimin e shesheve, shkallëve dhe rampave të objektit. Këto puseta janë zbuluar nga punonjës të kontraktorit dhe janë fotografuar dhe përcjellë tek Ju duke plotësuar sasinë reale të instaluar dhe deklaruar në situacionin përfundimtar. **Pra si përfundim mund të shprehim se kjo vlerë prej 10,800lekë e përfutur padrejtësisht, nuk qëndron.**

-Zëri «F.V kuadër komandimi komplet me santeri+fotoelement», i cili në situacionin përfundimtar është deklaruar 1copë i vendosur. Nga verifikimi në vend i zërit të punimit rezulton i painstaluar, duke u deklaruar në situacionin përfundimtar.

Ky konstatim qëndron pjesërisht, pasi në momentin e verifikimit në terren nuk është gjetur, por ky kuadër është prergatitur dhe instaluar në objekt gjatë zbatimit të punimeve për realizimin e kontratës, pasi pa këtë element nuk mund të vendosen në shfrytëzim dhe punë sistemi i ndriçimit i realizuar në objekt. Ky kuadër është hequr nga kontraktori dhe depozituar në ambientet ndihmëse të bashkisë Skrapar, pas përfundimit të punimeve, si rrjedhojë e dhunës dhe dëmtimeve të vazhdueshme të pajisjeve elektrike, panelit të komandimit, stolave, tavolinave, fidanëve të pemëve të mbjella dhe lodrave të cilat janë rivendosur në objekt më shumë se 2 herë nga ana e kontraktorit, të cilat janë bërë nga persona të papërgjegjshëm të qytetit. Ky panel është i gatshëm të vendoset në çdo moment në objekt nga ana e kontraktorit të punimeve, në çastin që do të sigurohet mundësia e rivendosjes së tij. **Pra si përfundim mund të shprehim se kjo vlerë prej 28,500lekë e përfutuar padrejtësisht, nuk qëndron.**

-Zëri «Pusetë b/a shiu 40x40cm, h =100 cm, me kapak zgare hekuri», i cili në situacionin përfundimtar janë deklaruar 4copë të vendosura. Nga verifikimi i bërë në terren rezultoi se janë vendosur 3copë (2 copë me kapak gize dhe 1copë me kapak betoni). Pra është deklaruar 1pusetë më tepër në situacionin përfundimtar.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi në objekt janë realizuar aktualisht 4 copë puseta të cilat janë evidentuar edhe nga Ju 3 prej tyre, ndërsa puseta e 4 nuk është evidentuar pasi kjo pusetë ndodhet nën shtresën e pllakave të gurit të sheshit në afërsi të sheshit të lodrave e cila lidhet me pusetën me kapak betoni që ndodhet në pjesën e lulishtes në krahun perëndimor të sheshit dhe mbledhin ujrat e shiut të sheshit e njëkohësisht edhe ujrat e ndotura të pallatit aty pranë. **Pra si përfundim mund të shprehim se në objekt kemi realizuar 4 copë puseta sa është deklaruar edhe në situacionin përfundimtar e se kjo vlerë prej 16,500lekë e përfutuar padrejtësisht, nuk qëndron.**

-Zëri «F.V. Fidanë Pemë dekorative», në situacionin përfundimtar janë deklaruar 19 copë fidanë. Nga verifikimi i bërë në terren, rezultoi se ishin vendosur 16 fidanë pemë dekorative, pra janë deklaruar 3 fidanë më tepër.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi nga ana e kontraktorit në momentin e furnizimit dhe vendosjes së këtyre fidanëve në objekt, kanë qenë prezent edhe përfaqësues të ndërmarrjes së gjelbërimit të bashkisë Skrapar të cilët kanë asistuar në pozicionimin dhe procesin e mbjelljes së tyre në objekt dhe gjithashtu konfirmohet se në objekt kanë ardhur dhe mbjellë më shumë se 19 fidanë të deklaruar në situacionin përfundimtar e konkretisht janë vendosur 23 fidanë, por siç e shprehëm edhe më lart, gjatë periudhës së pas përfundimit të punimeve, janë dëmtuar nga qytetarë të papërgjegjshëm dhe shkullur duke reduktuar numrin e fidanëve që u gjetën prezent në momentin e verifikimit nga ana Juaj. **Pra si përfundim mund të shprehim se kjo vlerë prej 39,000lekë e përfutuar padrejtësisht, nuk qëndron.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

**Lidhur me observacionet e paraqitura të sipërcituar, sqarojmë:** Për Raportet e testimi të betonit, sqarojmë se argumentet tuaja pranohen pjesërisht nga grupi i auditimit, konkretisht, për provat laboratorike të betonit, duke pranuar marrjen e monstarve në datë 08.02.2023 dhe datë 10.02.2023, por gjithsesi nuk është i plotë numëri monstarve të marra për prova laboratorike, kjo referuar specifikimeve teknike.

Gjithashtu lidhur me sqarimet për certifikatat e cilesise për materialet, të cilat i keni shoqëruar me dokumentacion bashkëlidhur observacionit, pranohen nga grupi i auditimit. Nuk pranohen pretendimi i paraqitur që i përket certifikatave të cilësisë së pllakave të gurit, stolave dhe tavolinave, pasi nuk janë të shoqëruara më dokumentacion faktues, sipas specifikimeve teknike.

Lidhur me konstatimin e rënies së disa pllakave të gurit në muret e shkallëve, për të cilin ju sqaroni se është zgjidhur duke rivendosur pllakat në object, process që e keni shoqëruar me foto bashkëlidhur observacionit, pranohet argumenti juaj.

**Për diferencat në volume, sqarojmë** se pretendimet tuaja pranohen pjesërisht, si vijon:

Lidhur me konstatimin për Zërin «Brez b/a C16/20 mbi mur guri», pretendimi juaj nuk pranohet pasi nuk është I argumentuar. Ju sqarojmë se konstaimi ynë bazohet në të dhënat e librezës së masave, ku konstahet se volumi 12.5 m<sup>3</sup>, i cili është punim që i përket zërit “Shtresë b/a t=15 cm për shkallët dhe rampat”, këto 2 zëra kanë çmime të ndryshme, për rrjedhojë është krijuar një diferencë në çmim, më hollësisht jemi shprehur në aktin e konstatimit,

Lidhur me konstatimin për Zërin «Beton C16/20 shtrese me t=15cm, për sheshin, rampat, shkallët», pretendimi juaj nuk pranohet pasi nuk është I argumentuar. Ju sqarojmë se konstaimi ynë bazohet në të dhënat e librezës së masave, rezultoi se përlllogaritjet nuk janë të sakta.

Lidhur me konstatimin për Zërin «F.V kuadër komandimi komplet me santeri+fotoelement», ku ju sqaroni Ky kuadër është vendosur në object, por është hequr nga kontraktori dhe depozituar në ambientet ndihmëse të Bashkisë Skrapar, pas përfundimit të punimeve, si rrjedhojë e dhunës dhe dëmtimeve të vazhdueshme, argumenti juaj pranohet, por duhet të tërhiqet nga ambjentet e bashkisë dhe të instalohet në object në prezencë të përfaqësuesëve të Bashkisë Skrapar, duke e shoqëruar me mbajtjen e një procesverbali ku të pasqyrohet funksionimi në objekt i tij.

Lidhur me konstatimin për Zërin «FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë RICE 1084+1086», ku ju sqaroni se në objekt janë vendosur 14 copë puseta plastike, por 4 copë prej tyre kanë qenë të mbuluara nga pllakat e gurit, ndërsa këto puseta janë zbuluar nga punonjës të kontraktorit dhe janë fotografuar dhe përcjellë tek Ju duke plotësuar sasinë reale të instaluar dhe deklaruar në situacionin përfundimtar.

Lidhur me konstatimin për Zërin «Pusetë b/a shiu 40x40cm, h =100 cm, me kapak zgare hekuri», keni paraqitur të njëjtin argumentim.

Lidhur me konstatimin për Zërin «F.V. Fidanë Pemë dekorative», ku ju pretendoni se ato janë vendosur në object të plota në prezencë edhe të punonjësve të Bashkisë Skrapar, por, pas përfundimit të punimeve, janë dëmtuar nga qytetarë të papërgjegjshëm. Grupi i auditimit nuk i pranon argumentet tuaja, pasi pavarësisht pretendimit tuaj nuk ka ndonjë document apo procesverbal të mbajtur lidhur me dëmtimin e fidaneve apo pemëve të vendosuar në object. Gjithsesi çdo zëvendësim i pemëve të munguara nga kontraktori, gjatë ose pas përfundimit të periudhës së garancisë dhe marrjes përfundimtare në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor, duhet të evidentohet nga Bashkia Skrapar.

## **2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

2.5.1. *Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;*

2.5.2. *Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.*

Për Bashkinë Skrapar, Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Rregullorja e Planit të Përgjithshëm të Territorit janë miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

### Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Skrapar, rezulton se për afatin e auditimit 01.01.2022 deri në 31.12.2023, ka pasur 35 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh, nga të cilat 10 aplikime për pajisje me leje zhvillimi (miratuar 6/refuzuar 4); 8 aplikime për pajisje me leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m<sup>2</sup>, rikonstruksione dhe shtesa në ndërtime ekzistuese deri 250 m<sup>2</sup> (miratuar 7/refuzuar 1); 10 aplikime për pajisje me deklaratë paraprake për kryerje punimesh (miratuar 9/refuzuar 1); 2 aplikime për pajisje me certifikatë përdorimi (miratuar 2/refuzuar 0); 5 aplikime për pajisje me leje infrastrukture (miratuar 5/refuzuar 0). Informacioni i mësipërm është evidentuar në tabelën përmbledhëse në Aneksin L1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPKZHT), nga Bashkia Skrapar, janë miratuar 4 leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m<sup>2</sup> dhe 2 certifikata përdorimi, të pasqyruara në Aneksin L1. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të

tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit, u konstatua se në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancave nga kufiri i pronës, parcelës minimale të lejuar për zhvillim, lartësisë maksimale të lejuar të objektit, si dhe ajo e katit përdhe, si më poshtë:

**1.** Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me adresë në fshatin Nishovë, Bashkia Skrapar, me zhvillues znj. E.B, për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës, më konkretisht, skaji verilindor i objektit në zhvillim nuk respekton distancën minimale të lejuar (3 metra) nga kufiri verior, duke miratuar një distancë prej 1.15 metra. Gjithashtu, skaji juglindor nuk respekton distancën minimale të lejuar (3 metra) nga kufiri lindor, duke miratuar një distancë prej 2.38 metra. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 35 të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1.

- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë e lejuar të çatisë, pasi referuar pasaportës së njësisë strukturore, lartësia maksimale e lejuar është 2 kate + çati deri në 1.20 m, ndërsa lartësia e çatisë së objektit të miratuar është 1.5 metra.

- Objekti i miratuar nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar, i cili është 0.2, referuar pasaportës së njësisë strukturore. Intensiteti faktik i objektit në zhvillim është 0.58, veprim ky jo në përputhje me nenin 38 të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 2, si dhe në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Skrapar.

**2.** Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, Nj. Adm. Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH , për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga kufiri i pronës, më konkretisht, skaji veriperëndimor i objektit në zhvillim nuk respekton distancën minimale të lejuar (3 metra) nga kufiri perëndimor, duke miratuar një distancë prej 2.2 metra. Gjithashtu, skaji juglindor nuk respekton distancën minimale të lejuar (3 metra) nga kufiri lindor, duke miratuar një distancë prej 2 metra. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 35 të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1;

- Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe, kur ky kat ka funksion shërbim. Referuar nenit 37 të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 3, nënpika c), lartësia minimale e lejuar për katin përdhe me funksion shërbim është 4 metra, ndërsa lartësia faktike e këtij kati për objektin në zhvillim është 3.06 metra;

- Parcela në të cilën zhvillohet objekti, nuk plotëson kriterin e parcelës minimale të lejuar, pasi kjo parcelë ka sipërfaqen prej 300 m<sup>2</sup>, ndërsa parcela minimale e lejuar duhet të ketë sipërfaqen 350 m<sup>2</sup>, në kundërshtim me pasaportën e njësisë strukturore ZU.26.1, referuar PPV-së të Bashkisë Skrapar.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. A.M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Skrapar; z. B.M, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT dhe z. A.L, në cilësinë e nëpunësit pranë DPKZHT; Veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 35, pika 1, pika 3, nënpika c); neni 38, pika 2; Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Skrapar, Pasaporta e njësisë strukturore ZU/26/1.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në 3 raste, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, si më poshtë:

**1.** Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me adresë në fshatin Nishovë, Bashkia Skrapar, me zhvillues znj. E.B, për të cilën nga Kryetari i Bashkisë Skrapar është miratuar Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

- Mungojnë vërtetimet e statusit dhe regjistrimit në QKB, për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore (arkitektonik, konstruktiv, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe rilevimi topografik), veprime jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon raporti i auditimit të efikasitetit energjetic, së bashku me dokumentacionin shoqërues, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “*Për efikasitetin e energjisë*”, pika 5, nënpika b);

- Plani i rilevimit nuk është i plotësuar me të gjitha të dhënat e nevojshme, pasi mungon përmasimi i parcelës në zhvillim, veprim jo në përputhje me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç);

- Emërtimi i objektit në deklaratat e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e rilevimit topografik, projektit konstruktiv dhe atij të mbrojtjes nga zjarri nuk është i saktë, veprime jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e);

- Nga auditimi i projektit ndërtimor, është konstatuar se në asnjë rast nuk specifikohet dhe evidentohet objekti ekzistues, si dhe nuk ka një vlerësim nga ana e inxhinierit konstruktor mbi qëndrueshmërinë e strukturës ekzistuese. Si rrjedhim, projekti ndërtimor dhe arkitektonik nuk është i plotë, veprim jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1/1;

- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të përditësuara, pasi referuar Ligjit nr. 111/2018 “*Për kadastrën*”, neni 17 “*Certifikatat*”, pika 4 dhe 6, Vendimit nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartelat janë rifreskuar në datën 15.12.2020, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 18.03.2022;

- Në dokumentin e planvendosjes së miratuar, si dhe të lejes së ndërtimit nuk jepet informacion mbi respektimin e kondicioneve urbane, më konkretisht, mungon informacion mbi përdorimin e tokës dhe strukturave të lejueshme, intensitetin e ndërtimit, si dhe koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1, nënpika a), b), c);

- Nga auditimi i dokumentacionit të aplikimit dhe miratimit të kësaj procedure është konstatuar se projekti arkitektonik dhe konstruktiv nuk janë të njëjtë me projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit, si dhe planvendosjen e miratuar. Për këtë arsye, projekti arkitektonik dhe konstruktiv konsiderohen të pavlefshëm. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika i) dhe ii). Si rrjedhojë e këtij veprimi, nuk mund të nxirren përfundime mbi përlllogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI).

**2.** Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, NjA Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH, për të cilën nga Kryetari i Bashkisë Skrapar është miratuar Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

- Mungojnë vërtetimet e statusit dhe regjistrimit në QKB, për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore (arkitekturik, konstruktiv, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe rievimi topografik), veprime jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Emërtimi i objektit në deklaratat e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projektit arkitekturik, projektit konstruktiv, projektit të mbrojtjes nga zjarri, si dhe raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë nuk janë të sakta, veprime këto jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika e);
- Projekti arkitekturik nuk është i plotë, pasi në sistemin elektronik të lejeve është ngarkuar vetëm një prerje teknike, nga dy të tilla që kërkohen në rregulloret e veprimtarive ndërtimore, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika i);
- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të përditësuara, pasi referuar Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, neni 17 “Certifikatat”, pika 4 dhe 6, Vendimit nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartelat janë rifreskuar në datën 18.02.2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 28.12.2022;
- 3. Çertifikatë përdorimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, NjA Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH, për të cilën nga Kryetari i Bashkisë Skrapar është marrë Vendimi nr. 09, datë 29.09.2023;**
- Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 2;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, veprim jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika i);
- Mungojnë aktet përkatëse të lëshuara nga shoqëria “U” ShA, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane, veprime këto në kundërshtim me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);
- Mungon situacioni përfundimtar i punimeve, veprim jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika e).
- Mungon planvendosja e miratuar, veprim ky jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika f);
- Mungon projekti “as-built” (i zbatuar), veprim jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika g). Projekti “as built” mund të jetë i njëjtë me projektin arkitekturik të miratuar vetëm për ato raste kur nuk ka pasur shmangie nga projekti i miratuar. Nga auditimi në terren për rastin nën shqyrtim, është konstatuar se çatia nuk është ndërtuar sipas projektit të miratuar, por ka shmangie në pjerrësinë e saj dhe në pozicionimin e kulmit. Mungesa e projektit as-built kushtëzon dhënien e opinionit mbi shfrytëzimin e hapësirës nën çati, si dhe lartësinë faktike të saj;
- Mungojnë fotografi të objektit në të gjitha orientimet, veprim jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika j);
- Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, bashkë me licencat, veprim jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika k);

- Mungon “Projekti për mirëmbajtjen e objektit”, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik, veprim jo në përputhje me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. A.M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Skrapar; z. B.M, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT dhe z. A.L, në cilësinë e nëpunësit pranë DPKZHT.

Për sa është trajtuar në pikën 2.5 të Projekt Raportit të Auditimit, nga funksionarët e Bashkia Skrapar, z. A.M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, z. B.M, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT dhe z. A.L, në cilësinë e nëpunësit pranë DPKZHT, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

1. Në lidhje me mangësitë e konstatuara të akteve të miratimit për ushtrimin e aktivitetit, shprehen se: “Së pari pika 1, nënpika ë) e nenit 15 thotë: ‘grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit’, pra nuk ka të bëjë me lejet apo licencat etj. Qëndrimi juaj për këtë pikë duhet të jetë shumë i saktë pasi mund të kemi keqinterpretime juridike. Nga ana jonë është kryer verifikimi nëse këta operator kanë statusin aktiv në momentin e shqyrtimit të dokumentacionit për leje ndërtimi. Ju sjellim në vëmendje se përse duhet të jetë kusht në sistem ky dokument kur nuk duhet më shumë se 1 minutë kohë për t’a verifikuar në faqen e QKB-së. Kjo lehtësisht e verifikueshme nga ana juaj pasi mund të shikoni në çdo kohë ekstraktin historik dhe statusin e këtyre subjekteve.”

2. Në lidhje me mungesën e preventivit të punimeve, shprehen se: “Preventivi i punimeve për këtë objekt ndodhet i hedhur në sistem. Në çdo moment mund t’ju vëmë në dispozicion userin e passëordin për t’a verifikuar. Nuk mund të vijonim shqyrtimin pa patur preventivin e punimeve në sistem. Me anë të këtij preventivi kemi llogaritur dhe TNI. Kjo shumë lehtë e verifikueshme.”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

1. Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehemi se, së pari, në nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me VKM-në nr. 457, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të këshillit të ministrave, ‘Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit’, të ndryshuar”, pika 1, nënpika ë), përcaktohet qartësisht se: “Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit”. Duhet t’i referoheni dokumentit të ndryshuar të Vendimit të Këshillit të Ministrave, në vijim link-u:

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=6955&token=d8cd8Dbc781f6ea3d7e4d6b4fdc446b976dc54a> .

Është e vërtetë se verifikimi i statusit të subjekteve të ndryshme është një procedurë e thjeshtë, gjithsesi, arsyeja se pse kjo procedurë është parashikuar në VKM-në e sipërcituar është se subjekti ndërtues/zhvillues dhe të gjithë subjektet të cilat kanë hartuar projektin ndërtimor duhet të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në periudhën kur aplikohet për t’u pajisur me leje ndërtimi. Vetëm pasi vërtetohet se këto subjekte janë të regjistruar në QKB, gëzojnë statusin aktiv për ushtrimin e aktivitetit sipas disiplinave, Bashkia ka të drejtën të shqyrtojë dhe miratojë projektet ose aplikimet e hartuara nga këto subjekte. Fakti se funksionarët e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, e kanë verifikuar këtë situatë në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, vërtetohet vetëm nga prania e vërtetimit të regjistrimit në QKB dhe / ose ekstraktit historik të subjektit, dokumenta të cilat duhet të jenë të nënshkruara elektronikisht dhe të ngarkuar në sistem nga aplikanti i praktikës. Verifikimi i të drejtës së ushtrimit të aktivitetit nga subjekti ndërtues/zhvillues dhe të gjithë subjektet të cilat kanë hartuar projektin ndërtimor kryhet përgjatë shqyrtimit të aplikimit për pajisje me leje punimesh, edhe jo pasi është miratuar leja e ndërtimit. Për sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2. Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehemi se, pas verifikimit në sistemin elektronik të lejeve, është konstatuar se preventivi është pjesë e dokumentacionit të ngarkuar. **Observacioni juaj pranohet dhe konstatimi nuk do të jetë pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

**Shënim:** Të gjitha observacionet mbi Projekt Raportin e Auditimit, të cilat janë të njëjta me observacionet mbi akt-konstatimet, nuk do të trajtohen, nuk do të bëhen pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe qëndrimi i grupit të auditimit nuk do të ndryshojë, pasi janë trajtuar në dokumentin e

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste, Bashkia Skrapar, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si më poshtë:

1. Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me adresë në fshatin Nishovë, Bashkia Skrapar, me zhvillues znj. E.B, për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, me problematikat si më poshtë:

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), mbi marrjen e konformitetit të dokumentave të pronësisë.

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), mbi marrjen e konformitetit për zhvillimin e objektit në tokë natyrore.

2. Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, Nj. Adm. Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Skrapar, me problematikat si më poshtë:

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), mbi marrjen e konformitetit të dokumentave të pronësisë, U vendore (UK), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Agjencisë së Auditimit të Energjisë (AEE), si dhe Policisë për Mbrojtjen ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit (PMNZSH).

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. A.M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Skrapar; z. B.M, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT dhe z. A.L, në cilësinë e nëpunësit pranë DPKZHT; Veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6.

Për sa është trajtuar në pikën 2.5 të Projekt Raportit të Auditimit, nga funksionarët e Bashkia Skrapar, z. A.M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, z. B.M, në cilësinë e drejtorit të DPKZHT dhe z. A.L, në cilësinë e nëpunësit pranë DPKZHT, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

1. Në lidhje me mos-kërkimin e mendimit nga ASHK, shprehen se: “*Ju observojmë se kemi të bëjmë me një ngërç ligjor. Nga eksperiencat e mëparshme nuk kemi patur asnjëherë mendim nga ASHK, pavarësisht këkesës sonë për mendim-dhënie në sistem. Sa i takon ndryshimit të VKM nr. 408 me nenin e sipërcituar, ASHK nuk mund të pajisin asnjë institucion apo individ me dokumentacion pa aplikuar në e-albania dhe duke paguar tarifën e aplikimit. Nga ana e Bashkisë Skrapar kur i është nevojitur dokumentacion nga ana e ASHK ka ndjekur aplikimin në E-Albania dhe ka paguar tarifën e aplikimit dhe pas kësaj janë është dashur më shumë se një muaj kohë për të marrë dokumentacionin e kërkuar pasi sipas rregullores së tyre një aplikim për ASHK-në e Skraparit mund ta shqyrtojë ASHK-ja e Sarandës apo e Tropojës etj.*”

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me argumentimin tuaj, shprehemi se, Drejtoritë Vendore të ASHK-së e kanë detyrim ligjor, i rrjedhur nga VKM-ja nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6, që të ngarkojnë në sistemin elektronik të lejeve dokumentat e rifreskuar të pasurisë mbi të cilën pretendohet të zhvillohet objekt ose statusin e saj. Ky shërbim është pa pagesë. Historiku që Bashkia Skrapar ka me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës nuk mund të jetë shkak për mos-



zbatimin e ligjit dhe përcaktimeve rregullatorë. Afati kohor i pritjes së përgjigjes nga autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit është 10 ditë pune. Duke marrë parasysh faktin se aplikimit për leje ndërtimi nën auditim, janë shqyrtuar dhe miratuar për 14 ditë dhe 11 ditë (respektivisht), afati 10 ditor i pritjes së mendimit nga ASHK nuk do të sillte problem në respektim e afateve të shqyrtimit të procedurës. Për sa më sipër, **pretendimi juaj nuk merret në konsideratë**.  
Shënim: Të gjitha observacionet mbi Projekt Raportin e Auditimit, të cilat janë të njëjta me observacionet mbi akt-konstatimet, nuk do të trajtohen, nuk do të bëhen pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe qëndrimi i grupit të auditimit nuk do të ndryshojë, pasi janë trajtuar në dokumentin e Projekt Raportin e Auditimit.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 raste zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “*Njoftimit të fillimit të punimeve*”. Ky dokument aplikohet dhe miratohet pas marrjes së lejes së ndërtimit dhe shërben për dokumentimin e datës së fillimit të punimeve (duke qenë se çdo zhvillues ka të drejtën e fillimit të punimeve deri në një vit pas miratimit të lejes së ndërtimit), si dhe për caktimin e kolaudatorit dhe mbikëqyrësit të punimeve, kur kërkohet me ligj, si më poshtë:

**1.** Leje ndërtimi për rikonstrukcion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me adresë në fshatin Nishovë, Bashkia Skrapar, me zhvillues znj. E.B, për të cilën nga Kryetari i Bashkisë Skrapar është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

**2.** Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, Nj. Adm. Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH, për të cilën nga Kryetari i Bashkisë Skrapar është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

Fillimi i ndërtimit të objektit në mungesë të dokumentit të njoftimit të fillimit të punimeve është në kundërshtim me VKM-në nr. 610, datë 22.09.2022, “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij...*”, neni 41, pika 1, nënpika gj), si dhe neni 43, pika 1, nënpika c).

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. Z.M, në cilësinë e inspektorit të ndërtimit në Bashkinë Skrapar.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 610, datë 22.09.2022, “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*”, neni 41, pika 1, nënpika gj); neni 43, pika 1, nënpika c).

## **2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për vitet 2022 dhe 2023, nuk është ngritur dhe nuk funksionon Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në mospërputhje me nenin 4, të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”. Për vitet 2022 dhe 2023, në strukturën organizative, është përcaktuar një pozicion pune si inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për periudhën objekt auditimi, ky post pune mbulohet nga z. Z.M, me arsim të mesëm, jo në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar, i cili përcakton detyrimin për arsimimin e lartë të inspektorëve dhe llojin e arsimit të kërkuar.

**Për sa më sipër, përgjegjësi mban kryetari i Bashkisë Skrapar, z. A.M.**

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 4, neni 11.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e Subjektit:**

*Bashkia Skrapar ka argumentuar se ngritja e Ë është e pamundur për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe se veprimtaria e kësaj strukture është mbuluar nga një punonjës pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pretendimi i subjektit se Bashkia Skrapar nuk ka ngritur strukturën e Ë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, nuk është i bazuar në ligj. Punonjësi i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, z. Z.M , i cili mbulon mbrojtjen dhe kontrollin e territorit për Bashkinë Skrapar, nuk ka arsimimin e duhur të përcaktuar në nenin 11 të Ligjit nr.9870, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë.

**2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

- 2.7.1. *Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.*
- 2.7.2. *Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.*
- 2.7.3. *Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Me shkresën e KLSH nr. 628/22, datë 30.10.2023 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Skrapar.

- Nga Bashkia Skrapar në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, pra janë pranuar të gjitha rekomandimet me përjashtim të një rasti për masë administrative, i cili nuk është pranuar.

- Bashkia Skrapar ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim.

- Plan-veprimi i masave për zbatimin e rekomandimeve është miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. A.M me shkresën nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023.

- Pavarësisht hartimit të Plan-Veprimit nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar, ky institucion nuk ka kthyer përgjigje ndaj dërgimit të raportit përfundimtar të auditimit tematik për Zbatimin e rekomandimeve brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me Ligjin nr 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja j.

- Për sa i përket zbatimit të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rezulton se:

- Përgjatë periudhës në të cilën është kryer puna audituese, Bashkia Skrapar ende nuk ka dërguar ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, megjithëse ky institucion është brenda afatit 6-mujor për ta dërguar raportin e zbatimit të rekomandimeve.

- Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 10 masa organizative, 13 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me

ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhura të munguara. I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Skrapar t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, të japë masë disiplinore për 13 punonjës, të cilët janë vënë përpara përgjegjësisë në Raportin Përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se:

- Nga 10 Masa organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 10 masa organizative, është zbatuar një masë, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk janë zbatuar 6 masa.
- Nga 13 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të tyre, janë pranuar 13 masa, 1 masë është pjesërisht e zbatuar, ndërkaq janë zbatuar 2 masa dhe nuk janë zbatuar 10 masa.
- Nga 13 masa disiplinore janë pranuar të 13-ta masat, janë zbatuar 8, nuk janë zbatuar 5 prej tyre.

Rekomandimet e lëna dhe statusi i zbatimit të tyre janë paraqitur në vijim:

## **B. Masa organizative:**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, caktimin e koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të bashkisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë sigurisë së Sistemeve IT sipas përcaktimeve në aktet ligjore.

**Statusi:** Në proces zbatimi

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për krijimin e një njësie të plotë të Auditit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM dhe Manualin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**Statusi:** I pazbatuar

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 210 "Toka, Troje, Terrene" nr. 211 "Pyje, kullota, plantacione".

**Statusi:** Në proces zbatimi

**10.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

**Statusi:** Në proces zbatimi

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Kadastrës, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

**Statusi:** I pazbatuar

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit

të lejeve të miratuara.

**Statusi: I pazbatuar**

**19.2. Rekomandimi:** Të merren masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i tyre të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi inxhinierik i inspektorit/kryeinspektorit, kjo për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

**Statusi: I pazbatuar**

**19.3. Rekomandimi:** Të hartohen dhe të administrohen me procesverbal dhe në dosjet përkatëse praktikantët e konstatimit të situatave ndërtimore. Procesverbalet të jetë sipas formatit të miratuar. Lidhur me konstatimet e mbajtura për punime ndërtimore pa leje, në çdo rast të mbahet penaliteti përkatës duke vendosur gjobë, shoqëruar me pezullimin e punimeve dhe prishjen e ndërtimit pa leje kur është rasti.

**Statusi: I zbatuar**

**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 241/54 prot., datë 13.04.2021 “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rikërkua” si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 21.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

- Për zbatimin e 2 masave organizative,
- Për të ndjekur gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e shumës 1,127,669 lekë të 3 masave shpërblim dëmi.
- Për zbatimin e rekomandimit për Masa me Efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 1,250,000 lekë.
- Për zbatimin e dy rekomandimeve për detyrime për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat në vlerën 891,325,200 lekë.
- Vënien në dijeni në mënyrë shkresore të KLSH-së brenda afatit 20 ditor mbi planin e veprimit dhe brenda atij 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

**Statusi: I pazbatuar**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht, Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimi, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**Statusi: I pazbatuar**

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike**

**1.1.-8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 577,473 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Statusi: I pazbatuar**

**9.1.-11.1. Rekomandim:** Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të

kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 20,213 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**Statusi: I pazbatuar**

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 4,926 mijë lekë (principal dhe kamatë vonesë).

**Statusi: Pjesërisht i zbatuar**

**13.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.

**Statusi: I pazbatuar**

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK SHA Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.

**Statusi: I pazbatuar**

**15.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

**Statusi: I pazbatuar**

**16.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 15,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

**Statusi: I pazbatuar**

**17.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 1,800,000 lekë.

**Statusi: I pazbatuar**

**18.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 603,000 lekë.

**Statusi: I zbatuar**

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.

**Statusi: I pazbatuar**

**19.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, të marrë masat e nevojshme për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të qirasë me tarifën simbolike 1 euro të lidhura me subjektin HEC “V.” Sh.P.K, duke ndjekur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Për rastin e kontratës së qirasë me objekt “tokë pa fryt” të lidhur me subjektin “E.” SH.A, përpara përfundimit të afatit të kontratës së qirasë më datë 16.07.2023 dhe në rast se subjekti i mësipërm do të shfaqë interes për rinovimin e saj, t’i drejtohet ministrisë përgjegjëse për

ekonominë, me qëllim marrjen e konfirmimit për të rinovuar kontratën e qirasë për objektin e mësipërm.

**Statusi: Pjesërisht i zbatuar**

**19.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimit Pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

- Me shkresën nr. 61 prot., datë 06.03.2023, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor i ka dërguar shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me objekt marrjen e masave për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

- Me shkresën nr. 63 prot., datë 06.03.2023, Ndërmarrja e Shërbimeve Pyjore i ka dërguar shkresë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, me objekt bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në zbritjen nga fondi të sipërfaqeve të shfrytëzueshme, për subjektet: “T” ShPK, me nipt J...G; “S” ShPK, me nipt K...U; “B” ShPK, me nipt K...T; “A” ShPK, me nipt K...D dhe “V ” ShPK.

**Statusi: I zbatuar**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimit, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**Statusi: I pazbatuar**

**C.1. Masa disiplinore**

**F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Në mbështetje të shkronjës (c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64, shkronja g, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

b- Masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për:

**Znj. XH.S**, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kritereve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura.

**Statusi: I zbatuar**

**Znj. S.H**, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kritereve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 2 (dy) procedura.

**Statusi: I zbatuar**

**Znj. H.B.**, përgjegjëse e STTV nga muaji Mars i vitit 2021 dhe në vazhdim, për mangësitë e konstatuara në 12 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

**Statusi: I pazbatuar**

c- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

**Z. N.G.**, Drejtor i Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura.

**Statusi: I pazbatuar**

**Z. B.M.**, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në 2 raste, për mos bashkëpunimin me sektorin e taksave dhe tarifave vendore në përcjelljen e informacionit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Skrapar, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura.

**Statusi: I pazbatuar**

**Znj. M.B.**, Inspektore Kadastrore për vitin 2020 për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

**Statusi: I zbatuar**

**E.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta:**

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç”, të nenit 1, Kreu IV dhe nenet 37 dhe 44 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Masat disiplinore të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm: Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për lA m nga puna”, për:

**Z. V.K.**, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 11 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

**Statusi: I zbatuar**

b- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

**Z. A.L.**, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura.

**Statusi: I zbatuar**

**Znj. XH.LL.**, me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 4 (katër) procedura.

**Statusi: I pazbatuar**

**Z. XH.LL.**, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 4 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

**Statusi: I zbatuar**

**Z. M.H.**, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 3 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

**Statusi: I zbatuar**

**Znj. L.N.**, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

**Statusi: I zbatuar**

**Z. S.B**, Inspektor i taksave në NJA Çepan për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

**Statusi: I pazbatuar**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimit, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**Statusi: I pazbatuar**

#### **H. Njoftimi i departamentit të administratës publike dhe komisionerit të mbikëqyrjes të shërbimit civil**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Skrapar pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

**Statusi: I pazbatuar**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: z. A.M, me detyrë kryetar i Bashkisë Skrapar, z. N.G, me detyrë Drejtor Finance, znj. R.LL, me detyrë drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve dhe z. E.O, me detyrë drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Skrapar.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 15, “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*” dhe neni 30, “*Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*”.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, për procedurën e mësipërme nga personat e atakuar, punonjës të Bashkisë Skrapar, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 72/4 prot., datë 19.04.2024, i protokolluar në KLSH me nr. 36/5 prot., datë 22.04.2024 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** *Për Rekomandim 2.1: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për krijimin e një njësie të plotë të Auditit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM dhe Manualin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave*  
- Subjekti pretendon se nuk disponon burime njerëzore për të plotësuar vakancat në Njësinë e e Auditimit të Brendshëm.

**Qëndrimin i grupit të auditimit:** Pretendimi i subjektit nuk bazohet në asnjë prej akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me auditimin e brendshëm në institucionet publike. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** *Për rekomandimin 12.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Kadastrës, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.*

- Subjekti pretendon se Sektori i Tatim-Taksave dhe inspektorët e të ardhurave kanë plotësuar në regjistra të gjitha familjet që kanë tokë bujqësore.

**Pretendimi i subjektit:** *Për rekomandimin 19.1 dhe rekomandimin 19.2*



- Subjekti pretendon se Në Bashkinë Skrapar, detyrën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), e kryen një punonjës i vetëm me emërtimin inspektor i mbrojtjes së territorit, pjesë e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit. Ngritja e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Skrapar është pothuajse e pamundur, jo vetëm për specifikën e veçantë që mbart kjo strukturë, por edhe për shkak të mungesës së theksuar të burimeve njerëzore, në përputhje me kriteret ligjore.

**Qëndrimet i grupit të auditimit:** Pretendimi i mësipërm i subjektit nuk mbështetet në bazë ligjore apo dokumente. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për sa i përket rekomandimit 20.1, subjekti pretendon se do të marrë masat për hartimin e një plani të veçantë pune për sa më sipër.

**Qëndrimet i grupit të auditimit:** Pretendimi i mësipërm i subjektit nuk mbështetet në bazë ligjore apo dokumente. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për sa i përket rekomandimit 1.1, subjekti pretendon se i Bashkisë në zbatim të rekomandimeve ka miratuar një Plan veprimi, për të cilin do të marrë të gjitha masat për zbatimin e tyre.

**Qëndrimet i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht, Plani i Veprimit me nr. prot. 281/1, datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimi, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 1.1-8.1: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 577,473 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

- Subjekti pretendon se kryetari i Bashkisë Skrapar ka adresuar problematikat e konstatuara nga auditimi i procedurave të prokurimit, duke vënë në dijeni punonjësit e Bashkisë Skrapar, të cilët emërohen si pjesë e NJP dhe KVO.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga auditimi i procedurave të vitit 2022 dhe vitit 2023 u konstatuan të njëjtat problematika të konstatuara në raportet e mëparshme të auditimit. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 9.1-11.1: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 20,213 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

- Subjekti pretendon se Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve ka adresuar problematikat e konstatuara nga auditimi i procedurave të prokurimit, duke vënë në dijeni personat përgjegjës të NJP dhe KVO.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga auditimi i procedurave të vitit 2022 dhe vitit 2023 u konstatuan të njëjtat problematika të konstatuara në raportet e mëparshme të auditimit. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 12.1, subjekti pretendon se: Sektori i Tatim Taksave, ka nxjerrë të gjitha njoftim vlerësimet tatimore, për subjektet që rezultonin debitorë, të pasqyruar në tabelat nr. 5, 6, 7, 8, 9, të Raportit Përfundimtar të hartuar nga grupi i auditimit të KLSH-së, për vitin 2020-2021. Nga 4,926 mijë lekë, të identifikuar nga KLSH-ja, kanë ngelur pa arkëtuar, deri në fund të vitit 2023, 1,988,866 lekë, që u përket 24 subjekteve.

- Për të gjithë subjektet debitorë që përfshihen në këtë vlerë kanë filluar procedurat ligjore për vjeljen e debisë, me forcë, (janë bllokuar llogaritë bankare, janë njoftuar subjektet se do të kalojmë në bllokim pasurie dhe aktiviteti, sikurse parashikohet në ligj), procedura të cilat janë në proces pune për vitin

2024.-Ky rekomandim në pjesën më të madhe është zbatuar, pjesa e mbetur është në proces zbatimi duke përdorur masat shtrënguese, për vjeljen e tyre.

-Sektori i tatim taksave është orientuar që vjeljen ta bëjë me mënyrat e tjera dhe jo me bllokim pasurie, për faktin se bllokimi i pasurisë në ASHK, bëhet me aplikim kundrejt pagesës, ndaj, për të mos rënduar gjendjen financiare të bashkisë përdorim mënyrat e tjera të masave shtrënguese.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në Projekt-Raportin dërguar Bashkisë Skrapar, observacionet e dërguar për Akt-Verifikimin nr.1, grupi i auditimit ka pranuar pjesërisht pretendimet e subjektit, duke e konsideruar këtë rekomandim si pjesërisht të zbatuar.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 13.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.

- Subjekti pretendon se regjistrat e taksave dhe tarifave vendore janë përmirësuar dhe se deri në vitin 2023 ka mbetur pa u arkëtuar 1.274.171 lekë respektivisht nga 18 subjekte. Sipas pretendimeve të Bashkisë Skrapar, kane filuar procedurat ligjore për vjeljen me forcë të shumës së paarkëtuar ende.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar në mënyrë elektronike nga subjekti, u konstatua se subjektet debitorë nuk kanë arkëtuar ende shumën prej 1.274.171 lekëve. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 14.1: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK SHA Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifat vendore për kategorinë "Familjar" të mbliidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit

- Subjekti pretendon se me kthimin e UK SHA Skrapar në shoqëri rajonale, do të këtë në vëmendje rekomandimin e KLSH

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 15.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë "Familje", ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

-Subjekti pretendon se në regjistrat e Njësive Administrative, vlerat e detyrimeve për taksat e pasurisë së paluajtshme janë të pandryshuara, ndërsa tarifat vendore ndryshojnë në varësi të familjeve rezidente (për familjet që largohen me vendbanim nuk llogariten tarifat, detyrimi ngelet vetëm për taksat për këto familje). Ndryshimi i vlerës vjen si rezultat i IA mit të familjeve me vendbanim tjetër dhe sigurisht që do të ulet vlera e detyrimit për shërbimet.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi i subjektit nuk mbështetet mbi asnjë të dhënë dokumentare lidhur me realizimin ose jo të rekomandimit të sipërcituar. Për sa më sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 16.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 15.337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

- Subjekti pretendon se është e vështirë të arkëtohet vlera e sipërmendur për shkak të IA meve nga vendbanimi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi i mësipërm është i pabazuar në ligj dhe për rrjedhojë nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Pretendimi i subjektit:** Për rekomandimin 17.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 1,800,000 lekë.

- Subjekti pretendon se Vlera 1,800,000 lekë, është detyrim për pajisje me licenea për tregtim karburanë për dy subjekte. Një subjekt e ka arkëtuar vlerën 900 000 lekë, ndërsa tjetri është tregtim gazi, si lëndë djegëse për përdorim familjar, jo mjete motorike. Ky subjekt është në proces gjyqësor, me pretendimin se detyrimi i tij nuk është 1,000,000 lekë siç e ka përeaktuar KLSH-ja, por 100,000 lekë (tarifë e cila është paguar).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se nuk është arkëtuar plotësisht vlera prej 1.800.000 lekëve, dhënë si rekomandim. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Prendimi i subjektit:** Për rekomandimin 18.1, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 603,000 lekë.

- Subjekti pretendon se vlera 603,000 lekë, përfaqëson detyrimet e subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Skrapar, por nuk janë taksuar dhe arkëtuar tarifatat përkatëse. Nga verifikimi i vlerave të përpiluara nga grupi i auditimit, doli se disa subjekte e kishin paguar detyrimin. Vlera përfundimtare nuk është 603 000 lekë, por 419,277 lekë, vlerë e cila është arkëtuar sipas rekomandimeve. Ky detyrim është shlyer tërësisht nga subjektet përkatëse.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në rrugë elektronike, u konstatua se subjektet kanë shlyer shumën prej 419.277 lekëve. Për sa më sipër ky pretendim merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Prendimi i subjektit:** Për rekomandimin 19.1: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.

- Subjekti pretendon se tre prej subjekteve e kanë bërë pagesën e tyre, një prej subjekteve ka shpallur falimentin, ndërsa pjesa tjetër janë në proces gjyqësor

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar në rrugë elektronike, u konstatua se vlera prej 45.514.301 lekëve nuk është arkëtuar. Për sa më sipër pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

**Prendimi i subjektit:** Për rekomandimin 19.2: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, të marrë masat e nevojshme për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të qirasë me tarifën simbolike 1 euro të lidhura me subjektin HEC V SH.P.K, duke ndjekur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për rastin e kontratës së qirasë me objekt “tokë pa fryt” të lidhur me subjektin E SHA, përpara përfundimit të afatit të kontratës së qirasë më datë 16.07.2023 dhe në rast se subjekti i mësipërm do të shfaqë interes për rinovimin e saj, t’i drejtohet ministrisë përgjegjëse për ekonominë, me qëllim marrjen e konfirmimit për të rinovuar kontratën e qirasë për objektin e mësipërm.

- Për sa i përket pikës së parë të rekomandimit, subjekti pranon se është zbatuar. Për sa i përket pikës së dytë, kontrata e subjektit me E SHA, ka mbaruar më datë 16.07.2023 dhe nuk është rinovuar. Për sa më sipër pretendimi merret pjesërisht në konsideratë.

**Prendimi i subjektit:** Për rekomandimin 1.1: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

- Subjekti pretendon se Kryetari i Bashkisë në zbatim të rekomandimeve ka miratuar një Plan veprimi, për të cilin do të marrë të gjitha masat për zbatimin e tyre.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe statusit të realizimit të tyre, u konstatua se pjesa më e madhe e rekomandimeve janë të pazbatuara. Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e plotë të tyre.

Për sa më sipër pretendim i subjektit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

## 2.8. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

Në Bashkinë Skrapar nuk pati çështje të tjera për të audituar.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se: Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve në Bashkinë Skrapar nuk ka hartuar një program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike, si dhe mungon një program strategjik dhe vjetor për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Nuk ka koordinator për MFK-në dhe koordinator risku. Për vitin 2022 dhe vitin 2023 nuk janë dokumentuar takimet vjetore të GMS. Nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet IT. Në Bashkinë Skrapar nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk është miratuar gjurma e auditimit. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Verime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1/1 germa b, neni 46, neni 15, neni 16, Manualin për MFK, Kreu 3, paragrafi 3.1., Kreu II, kap. 2.2.6., kapitulli V, Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8/b; neni 12, neni 27 pikat 1 dhe 2, neni 21, pika 2, neni 8, pika 4, neni 16 pika 2, UMF nr. 30 datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nenet 121 dhe 122. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 24-32 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë dhe përbërjes së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, u konstatua se NJAB e Bashkisë Skrapar përmban vetëm një punonjës nga tre që parashikon pika 3 e VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. NJAB Skrapar nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit të njësisë të menaxhimit të Bashkisë Skrapar.

Verime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10; neni 14, pika b; VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik”, neni 3, pika 3; Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 24-32 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar duhet të marrë masa që në vijimësi, Njësia e Auditimit të Brendshëm:

- Të funksionojë gjithmonë sipas strukturës së përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi, me jo më pak se tre punonjës, përfshirë edhe përgjegjësin e kësaj njësie.
- Të krijojë një dosje të përhershme të auditimit, sipas përcaktimeve të Manualit të AB.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë Skrapar, u konstatua se: për vitin 2023, planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është **662,726 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë realizuar në shumën **579,917 mijë lekë** me një diferencë prej **82,088 mijë lekë** ose në masën **88%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar 13,803 mijë lekë dhe është realizuar 5,158 mijë lekë ose në masën 37%. Gjithashtu, zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 38% pasi, janë planifikuar investime 154,708 mijë lekë dhe janë realizuar 117,212 mijë lekë ose 68%. Zëri shpenzime operative është planifikuar 104,841 mijë lekë dhe është realizuar 75,119 lekë ose në masën 72%.

Për vitin 2022, planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është **689,416 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzimet janë **640,379 mijë lekë**, me një diferencë **49,036 mijë lekë** ose në masën **93%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve të tjera operative, i cili është planifikuar 16,921 mijë lekë dhe është realizuar 10,987 mijë lekë ose në masën 65%. Gjithashtu, zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim në masën 11%, pasi janë planifikuar investime 225,727 mijë lekë dhe janë realizuar 200,779 mijë lekë ose në masën 89%. Zëri shpenzime operative është planifikuar 79,327 mijë lekë dhe është realizuar 71,920 mijë lekë ose në masën 91%.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81 dhe UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisive të vetëqeverisjes vendore”.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, si një nga zërat kryesorë të shpenzimeve për secilin vit buxhetor, në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e buxhetit. Mosarritja e pritshmërive vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Skrapar në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe sektorët e tjerë të Bashkisë Skrapar, të marrin masa për:

- Hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.
- Çdo viti buxhetor të përgatitë dhe të paraqesë për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor dhe në vijim Këshilli Bashkiak Skrapar të marrë vendimet brenda afateve.

### **Menjëherë e në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti mbi vlerën e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore, rezulton se:

- Detyrimet më 31.12.2021 paraqiten në shumën 19,432,104 lekë, janë krijuar gjatë vitit 2022 vlera prej 76,938,342 lekë, më total në shumën 96,360,446 lekë. Janë likujduar gjatë vitit 2022 vlera prej 77,827,037 lekë dhe mbetet për likuidim në fund të **vitit 2022 vlera prej 18,533,409**

**lekë** (sipas aneksi B. 10, bashkëlidhur PRA).

- Detyrimet më 31.12.2022 paraqiten në shumën 18,533,409 lekë, janë krijuar gjatë vitit 2023 vlera prej 36,981,155 lekë, më total në shumën 55,514,564 lekë. Janë likuiduar gjatë vitit 2023 vlera prej 41,458,611 lekë dhe mbetet për likuidim në fund të vitit **2023 vlera prej 14,055,953 lekë** (sipas aneksi B. 11, bashkëlidhur PRA).

Kjo gjendje e faturave të palikujduara vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave dhe planifikimit të tyre në mënyrë jo të argumentuar, duke çuar në rritjen e procedurave të prokurimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 55 “Probleme financiare”, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, UMF nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 29, 59, 60, 61. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e njësisë vendore gjatë vitit në vazhdim.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, konstatohet se për disa zëra, realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nën-pika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të gjendjes së të ardhurave vjetore të bashkisë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi kryerjen e procedurave të inventarizimit për vitin 2023, rezultoi se Nëpunësi Zbatues i caktuar nga titullari i njësisë publike, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia dhe njësitë në varësi, në lidhje me zërat: tokë, truall, ndërtesa, pyje, kullota etj., të cilat paraqiten në kontabilitetin por që nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e tyre, veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pikat 26-33, pika 74. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 43-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, të ngriejë një grup pune me specialistë të fushës dhe të kryejë analizën e situatës së aktiveve të njësisë, duke vlerësuar Asetet që ka në administrim, plotësimin me dokumentacion pronësor, si dhe kryerjen e regjistrimeve përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim identifikimin e pronës dhe vlerësimin e saj.

Të marrë masat e duhura për përditësimin e regjistrit të aktiveve, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të miratuar për të ulur riskun e shpërdorimeve të pasurive publike dhe mirëmenaxhimin e tyre.

### **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2024**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin e procesit të inventarizimit, u konstatua se në disa raste, fletëinventarët fizikë nuk janë nënshkruar nga punonjësi me përgjegjësi materiale si dhe nga anëtarët e komisionit. Në urdhërin e krijuar për kryerjen e procesit të inventarizimit të vitit 2023, si dhe në fletët e inventarit, rezulton se, në komision janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit. Nga komisioni i inventarizimit rezulton se nuk është hartuar një raport lidhur me procesin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, vërejtjet për diferencat e konstatuara, shkaqet në raste të dëmtimeve, etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë jo në përputhje Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 15 “Inventari i aktiveve e detyrimeve”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve”, pikat 81-86. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 43-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, të kryhen analizat e situatës për mos përmbushjen e procesit të inventarizimit të aktiveve me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive, marrjen e masave përkatëse për punonjësit të cilët nuk kanë zbatuar urdhërin e titullarit të Njësisë si dhe të kryhet procesi i inventarizimit sipas Udhëzimit përkatës.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i **14** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Skrapar dhe njësinë e saj shpenzuese (Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike) për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, me fond limit 163,431,389 lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 113,444,166 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së auditimit, kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e procesverbaleve të ndryshëm në dosje, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 2 “Dokumentimi i procesit” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18.

- Në 7 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 41,313,973 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 40,322,656 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, etj. Këto fenomene janë konstatuar edhe në blerjet me vlerë të vogël.

- Në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804,204 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 97,422,625 lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kritere të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në 8 procedura nga 18 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 40,039,475 lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 35,263,160 lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues

nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

- Në procedurat me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme.

Komisionet për blerjet e vogla kanë vepruar në mospërputhje.

(Procedurat e audituara të ndara në vlerë sipas problematikave janë paraqitur në Aneksin P5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit).

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”; neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, neni 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; neni 98, “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1 dhe 6; neni 36 “Specifikimet teknike”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 5; neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1; neni 67, “Klasifikimi i ofertave” neni 78, pika 4, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”; neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, paragrafi i fundit; neni 85 “Lidhja e kontratës”, pika 2, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe/ose Drejtori i Njësisë Shpenzuese ( sipas rastit) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës, parcela minimale e lejuar për zhvillim, lartësia maksimale e lejuar e objektit, si dhe ajo e katit përdhe, në **2 raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B, për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022;

- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 35, pika 1; neni 38 të pika 2; nenit 37, pika 3, nën-pika c); Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Skrapar, si dhe pasaportën e njësisë strukturore ZU.26.1, referuar PPV-së së Bashkisë Skrapar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Skrapar të marrë të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, në çdo rast të respektohet distancat nga kufiri i pronës, lartësia maksimale e lejuar, ajo e katit përdhe dhe e çatisë, intensiteti maksimal dhe parcela minimale e lejuar.



## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, në **tre raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstrukcion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B, për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.
- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.
- Çertifikatë përdorimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 09, datë 29.09.2023.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 9, pika 1, nënpika a), b), c); neni 10, pika 1, nënpika ç; neni 15, pika 1, nënpika e), ë), dh); pika 1/1, pika i) dhe ii); neni 27/1, pika 2; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), e), f), g), gj), i), j), k); neni 45, pika c); Ligjin nr. 124/2015 “Për efincencën e energjisë”, pika 5, nënpika b); Ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”, neni 17, pika 4 dhe 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar, të marrë masa:

- Për çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkojë të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.
- Përpara miratimit lejeve të sigurohet mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve si: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efincencës së energjisë, etj.
- Të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Skrapar nuk ka kërkuar dhe respektuar në asnjë rast mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në **dy raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstrukcion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B , për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.
- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me adresë në fshatin Mollas, Nj. Adm. Qendër, Bashkia Skrapar, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar para miratimit të lejeve të ndërtimit të kërkojë mendimin e autoriteteve përkatëse mbi konformitetin e objektit në zhvillim në raport me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Gjithashtu të kërkojë dhe marrë mendim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi statusin juridik të pronave në zhvillim.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “Njoftimit të fillimit të punimeve”, në **dy raste** për objektet:

- Leje ndërtimi për rikonstrukcion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati, me zhvillues znj. E.B, për të cilën është marrë Vendimi nr. 34, datë 20.04.2022.

- Leje ndërtimi për agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit, me zhvillues z. A.XH, për të cilën është marrë Vendimi nr. 23/1, datë 23.01.2023.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me VKM-në nr. 610, datë 22.09.2022, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij...”, neni 41, pika 1, nën-pika gj) dhe neni 43, pika 1, nën-pika c).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Struktura e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të merren të gjitha masat për të mos lejuar zhvillimin e objekteve në mungesë të dokumentit të fillimit të punimeve, sipas parashikimeve ligjore, si dhe të ushtrojë masat parandaluese dhe administrative të parashikuara, për të gjitha rastet kur konstatohet kjo kundërvajtje.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi përbërjen dhe veprimtarinë e IMTV në Bashkinë Skrapar, u konstatua se për vitet 2022 dhe 2023, Bashkia Skrapar nuk ka ngritur strukturën e IMTV. Inspektori që mbulon mbrojtjen e territorit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka arsimimin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi. Këto veprime dhe mosveprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 106-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara. Gjithashtu, të marrë masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i punonjësve të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi i përshtatshëm i inspektorit/kryeinspektorit, për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr. 628/22, datë 30.10.2023, nga KLSH është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Skrapar.

- Nga Bashkia Skrapar në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, pra janë pranuar të gjitha rekomandimet me përjashtim të një rasti për masë administrative i cili nuk është pranuar.

- Bashkia Skrapar ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim.

- Plan-veprimi i masave për zbatimin e rekomandimeve është miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. A.M me shkresën nr. 281/1 prot, datë 06.11.2023. Pavarësisht hartimit të Plan-veprimit nga ana e drejtimit të Bashkisë Skrapar, ky institucion **nuk ka kthyer përgjigje** ndaj dërgimit të raportit përfundimtar të auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me

Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja j.

- Përsa i përket zbatimit të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rezultoi se gjatë periudhës në të cilën është kryer puna audituese, Bashkia Skrapar ende **nuk ka dërguar ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna**, megjithëse ky institucion është brenda afatit 6-mujor për ta dërguar raportin e zbatimit të rekomandimeve.

#### **Nga auditimi rezultoi se:**

- Nga 10 Masa organizative, janë pranuar plotësisht 10 masa organizative, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, dhe **nuk janë zbatuar 6 masa**.

- Nga 13 Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të tyre, janë pranuar 13 masa, 1 masë është pjesërisht e zbatuar, janë zbatuar dy masa dhe nuk janë **zbatuar 10 masa**.

- Nga 13 Masa disiplinore, janë pranuar të 13-ta masat, janë zbatuar 8, **nuk janë zbatuar 5 prej tyre**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 107-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

#### **A. Masa Organizative:**

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për krijimin e një njësie të plotë të Auditit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM dhe Manualin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave.

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Kadastrës, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

**19.2. Rekomandimi:** Të merren masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i tyre të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi inxhinierik i inspektorit/kryeinspektorit, kjo për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 241/54 prot., datë 13.04.2021 “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rikërkua” si dhe Akt Verifikimit nr. 1 të datës 21.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

- Për zbatimin e 2 masave organizative,

- Për të ndjekur gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e shumës 1,127,669 lekë të 3 masave shpërblim dëmi.

- Për zbatimin e rekomandimit për Masa me Efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 1,250,000 lekë.

- Për zbatimin e dy rekomandimeve për detyrime për taksat dhe tarifave vendore me efekte në të ardhurat në vlerën 891,325,200 lekë.

- Vënien në dijeni në mënyrë shkresore të KLSH-së brenda afatit 20 ditor mbi planin e veprimit dhe brenda atij 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht, Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimit, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1.-8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 577,473 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**9.1.-11.1. Rekomandim:** Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 20,213 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

**13.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK SHA Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifavat vendore për kategorinë “Familjar” të mbliidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.

**15.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të patakuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

**16.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 15,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

**17.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 1,800,000 lekë.

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

**Menjëherë**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimit, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**C.1. Masa disiplinore .**

**F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

**Znj. H.B,** përgjegjëse e STTV nga muaji Mars i vitit 2021 dhe në vazhdim, për mangësitë e konstatuara në 12 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

c- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

**Z. N.G.**, Drejtor i Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura;

**Z. B.M.**, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në 2 raste, për mos bashkëpunimin me sektorin e taksave dhe tarifave vendore në përcjelljen e informacionit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Skrapar, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura.

**E.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta.**

**Znj. XH.LL.**, me detyrë Nënkryetare e Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 4 (katër) procedura.

**Z. S.B.**, Inspektor i taksave në NJA Çepan për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konkretisht Plan i Veprimit me nr. 281/1 prot., datë 06.11.2023, Kryetari i Bashkisë Skrapar ka caktuar drejtoritë dhe sektorët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Pavarësisht këtij Plani Veprimit, nuk janë marrë masat për zbatimin konkret të tyre.

**Menjëherë**

**C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronjat b dhe c, Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të Bashkisë Skrapar, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **621,600 lekë me TVSh**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë”, me vlerë të kontratës 50,628,700 lekë me TVSh, fituar nga OE “D” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **337,500 lekë (pa TVSh)**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; UKM nr. 2, datë 13.05.2005, pika 3, kreu II dhe Kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2764 prot, datë 30.09.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Skrapar të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **337,500 lekë me TVSh** nga OE “D” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në

kontratën me nr. 2764 prot, datë 30.09.2022, me objekt “Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë”, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Brenda datës 30.09.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rugën e Dëshmorëve, Çorovodë”, me vlerë të kontratës 12,746,600 lekë me TVSh, fituar nga OE “F” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në vlerën **216,600 lekë (pa TVSh)**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3; UKM nr. 2, datë 13.05.2005, pika 3, kreu II dhe Kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3594 prot, datë 27.12.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Skrapar të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **216,600 lekë me TVSh** nga OE “F” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3594 prot, datë 27.12.2022, me objekt “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rugën e Dëshmorëve, Çorovodë”, vlerë e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Gjithashtu, në përfundim të periudhës së garancisë së punimeve, të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, për të gjithë elementet e projektit, përfshirë puseta elektike, puseta shiu, pemë/fidanë, kuadër komandimi komplet, etj. dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre nga kontraktori.

**Brenda datës 30.09.2024**

#### **D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit nga taksat dhe tarifave vendore që kanë ndaj Bashkisë Skrapar, u konstatua se deri më datën 31.12.2022, borxhi tatimor është në vlerën 85,872 mijë lekë. Përgjatë vitit 2022 vlera debitorë e krijuar është 9,324,913 lekë, si dhe vlera debitorë e krijuar gjatë vitit 2023 është 10,634,682 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive deri më datën 31.12.2023, janë në vlerën **105,832 mijë lekë**, e përbërë nga:

- Detyrime nga abonentët familjarë në vlerën **95,805,410 lekë**
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **7,985,028 lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **561,579 lekë**;
- Qira trualli në vlerën **480,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët,

duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale **105,832 mijë lekë**, e cila përbëhet nga:

- **95,805,410 lekë** detyrime nga **abonentët familjarë**;

- **7,985,028 lekë** detyrime nga **biznesi i madh**;

- **561,579 lekë** detyrime nga **biznesi i vogël**;

- **480,000 lekë** detyrime nga qiratë e truallit;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare;

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Skrapar, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohet vlera e detyrimeve të paarkëtuara, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**Brenda datës 31.12.2024**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2023, u konstatua se:

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja, në periudhën e audituar më parë, madje edhe nga vlera e maturuar gjatë periudhës objekt auditimi. Vlera debitorë në fillim të vitit 2022 rezulton në shumën 60,510 mijë lekë nga ku gjetë vitit 2022 shuma e maturuar është në vlerën 8,120 mijë lekë dhe e arkëtuar në vlerën 3,636 mijë lekë. Vlera debitorë në fillim të vitit 2023 rezulton në shumën 64,997 mijë lekë nga ku gjatë vitit 2023 shuma e maturuar është në vlerën 8,034 mijë lekë dhe e arkëtuar në vlerën 3,322 mijë lekë. Pra rezulton një vlerë më pak se 40% e vlerës së arkëtuar duke rritur akoma më shumë totalin e debisë progresive në fund të vitit 2023 e cila paraqitet në vlerën **69,276,330 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 3, pika 3 dhe neni 4, pikat 1 dhe 2; Ligjin nr.68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 42, pika 2; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 6, pika 3, neni 76, neni 89, pika 2 dhe neni 117; Paketa Fiskale e Bashkisë Skrapar, kreu I dhe kreu II; Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Skrapar, neni 67. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 32-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pallogaritur dhe papaguar në shumë **69,276,330 lekë**.

**Brenda datës 31.12. 2024**

## **F. MASA DISIPLINORE**

### **F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Skrapar**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

#### **a. “Vërejtje”, për 28 punonjës, si më poshtë:**

**1. Z. N.G**, me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, administrimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për procesin e inventarizimit të aktiveve dhe plotësimin me dokumentacion të plotë të aktiveve të Njësisë.

Në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **7 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**2. Znj. H.B**, përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për debitorët.

**3. Z. G.H**, Inspektor i taksave në NJA Qendër, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**4. Z. N.K**, Inspektor i taksave në NJA Bogovë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**5. Z. N.D**, Inspektor i taksave në NJA Vëndreshë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**6. Znj. F.B**, Inspektor i taksave në NJA Çepan për periudhën 01.09.2022-31.12.2023, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**7. Z. E.O**, Inspektor i taksave në NJA Potom, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**8. Znj. L.B**, Inspektore e Taksave në NJA Leshnjë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**9. Z. F.L**, Inspektor i taksave në NJA Gjrbës, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**10. Z. TH.SH**, Inspektor i taksave në NJA Zhepë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

**11. Znj. I.O**, detyrë inspektore e menaxhimit të aseteve në cilësinë e kryetares së komisionit të inventarizimit, për mos përmbushje të detyrave dhe afateve sipas legjislacionit për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve.

**12. Znj. A.K**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të Arsimit, Sportit dhe Kulturës, në cilësinë e anëtares së komisionit të inventarizimit, për mos përmbushje të detyrave dhe afateve sipas



legjislacionit për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve.

**13. Znj. A.G**, me detyrë Specialiste e Financës, në cilësinë e anëtares së komisionit të inventarizimit, për mos përmbushje të detyrave dhe afateve sipas legjislacionit për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve.

**14. Z. B.M**, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara.

**15. Z. A.L**, në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara.

Në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, në **3 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit.

Në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **2 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**16. Znj. XH.S**, me detyrë ish përgjegjëse prokurimesh, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **3 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;

**17. Z. E.Y**, me detyrë përgjegjës prokurimesh, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **8 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit.

**18. Z. B.Z**, me detyrë përgjegjës bordi për ujitjen dhe kullimin, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **2 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;

**19. Z. R.G**, me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **2 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit dhe në **1 rast**, në të cilin vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**20. Znj. E.H**, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **7 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit.

**21. Znj. J.K**, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **2 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit.

**22. Znj. R.LL**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **6 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**23. Znj. L.H**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Gjellbërimit, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **3 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;

**24. Z. D.M**, me detyrë Mbikëqyrës në sektorin e Mbikëqyrjes së Rrugëve Rurale, në NShP Bashkia Skrapar, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi në **4 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit.

**25. Z. V.N**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës në NShP Bashkia Skrapar, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **4 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me

kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**26. Z. E.M**, me detyrë teknik ndërtimi në NShP Bashkia Skrapar, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **4 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**27. Z. E.K**, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në **4 raste**, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik.

**28. Z. E.O**, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Skrapar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor NShP, Bashkia Skrapar, për miratimin e disa procedurave të prokurimit, dhe për lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të cilët kanë dorëzuar dokumentacion jo të plotë në funksion të kriterëve të përcaktuara në DT.

**F.2.** Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Skrapar**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

<p><b>Shënim:</b> Pika e auditimit “Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023” nuk është shqyrtuar nga Grupi i KLSH pasi afati i punës audituese në teren është planifikuar deri në datën 23.02.2024 kur pasqyrat financiare mbyllen në 31 mars 2024.</p>
--

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## V. ANEKSET

### Anekset mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

#### Aneksi MFK1: Emërimet e punonjësve të rinj për vitet 2022 dhe 2023:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës
1	A.H	Specialiste Finance
2	J.D	Specialiste e planifikimit te territorit
3	I.D	Koordinator per te drejtën e info/one stop shop
4	F.R	Njesia e mbrojtjes se femijeve
5	B.Ç	Specialiste Tatim Taksa
6	S.B	Specialiste e te ardhurave
7	XH.Ç	Specialiste Arkive

Burimi: Bashkia Skrapar, përpunuar nga Grupi i Auditimit

#### Aneksi MFK2: Punonjësit e larguar gjatë viteve 2022 dhe 2023:

Nr.	Emri Mbiemri	Arsyeja e IA mit
1	SH.GJ	Mbaron kontrata
2	R.H	Me kërkesën e vet
3	F.B	Del ne pension
4	D.H	Del ne pension
5	XH.S	Nuk paraqitet ne pune pas përfundimit te lejes se lindjes
6	E.M	Përfundon kontrata
7	B.Ç	I larguar nga drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile
8	Y.M	Del ne pension
9	M.SH	Me kërkesën e vet
10	G.B	Me kërkesën e vet
11	D.G	Me kërkesën e vet
12	L.SH	Me kërkesën e vet
13	D.D	Me kërkesën e vet
14	S.D	Ndërron jetë
15	A.K	I pezulluar per shkak te vendimit gjyqesor
16	Z.C	Mos paraqitje ne pune
17	XH.H	Me kërkesën e vet
18	A.Z	Ndërron jete
19	Z.SH	Përfundon kontrata
20	S.K	Per shkak te ndyshimit ne strukture
21	L.H	Me kërkesën e vet
22	R.Ç	Nuk paraqitet ne pune pas përfundimit te lejes se lindjes
23	S.K	Me kërkesën e vet
24	F.C	Del ne pension
25	A.K	Me kërkesën e vet
26	Q.G	Del ne pension
27	K.XH	Del ne pension
28	O.S	Përfundon kontrata
29	K.SH	Përfundon kontrata e punes
30	E.M	Kalon ne detyre tjetër
31	A.H	Me kërkesën e vet
32	E.D	Përfundon kontrata
33	A.Q	Me kërkesën e vet
34	V.S	Del ne pension
35	D.Ç	Me kërkesën e vet
36	A.B	Del ne pension
37	E.G	Me kërkesën e vet
38	A.T	Ndërron jete
39	E.I	Me kërkesën e vet
40	I.H	Nuk paraqitet ne pune pas përfundimit te lejes se lindjes
41	L.SH	Përfundon emërimi i perkohshem
42	R.G	Përfundon kontrata
43	M.H	Del ne pension
44	K.T	Me kërkesën e vet
	A.D	Me kërkesën e vet
	F.B	Del ne pension
	XH.L	Del ne pension
	B.D	Me kërkesën e vet

Burimi: Bashkia Skrapar, përpunuar nga Grupi i Auditimit

### Anekset mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit

**Aneksi B1: Të dhënat e planifikimit për vitet 2022-2023, në lekë**

Nr.	Përshkrimi	Plani 2022		Plani 2023	
		Te ardhura	Shpenzime	Te ardhura	Shpenzime
1	Te ardhura te trashëguara nga vitit paraardhës	6,765,935		16,023,231	
2	Transferti e Pakushtezuar e Pergjithshme Trashëguar nga viti paraardhës	669,288		17,808,022	
3	Transferti e Pakushtezuar e Sektoriale Trashëguar nga viti paraardhës	5,512,561		3,893,425	
4	Plani te ardhurave te vitit ushtrimor	104,182,750		73,800,000	
5	Transferti e Pakushtezuar e Pergjithshme akorduar per vitin ushtrimor	127,428,284		181,263,821	
6	Transferti e Pakushtezuar e Sektoriale akorduar per vitin ushtrimor	134,477,106		134,821,491	
7	Transferti nga Buxheti Shtetit	309,916,669		234,294,402	
8	Paga dhe sigurime Shoqerore dhe Shendetesore (600+601)		232,603,489		262,072,983
9	Shpenzime Operative (602)		79,326,531		104,841,534
10	Investime nga Fondet e Bashkise ( Grant + te Ardhura)		58,855,049		58,230,493
11	Fondet e Emergjencave dhe Fondi Rezerve		8,455,100		12,121,221
12	Investime nga Buxheti Shtetit (230-231)		166,871,472		96,477,652
13	Shpenzime te tjera (603+604+606)		142,840,952		128,160,509
<b>TOTALI</b>		<b>688,952,593</b>	<b>688,952,593</b>	<b>661,904,392</b>	<b>661,904,392</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

**Aneksi B2: Plani përfundimtar i buxhetit për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024, në lekë**

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	220,815,252	220,815,252	0
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	69,639,383	69,639,383	0
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	33,431,465	33,431,465	0
4	Investime nga FZSHH	0		
<b>Total i planit fillestar</b>		<b>323,886,100</b>	<b>323,886,100</b>	<b>0</b>
<b>Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit</b>				
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	5,888,237	0	5,888,237
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	23,838,003	0	23,838,003
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	25,423,584	0	25,423,584
8	Investime nga FZSHH	0		
<b>Totali shtesa + ndryshime</b>		<b>55,149,824</b>		<b>55,149,824</b>
<b>Plani përfundimtar</b>				
10	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	226,703,489	220,815,252	5,888,237
11	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	93,477,386	69,639,383	23,838,003
12	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	58,855,049	33,431,465	25,423,584
13	Investime nga FZSHH			
<b>Shuma e planit vjetor 2022</b>		<b>379,035,924</b>	<b>323,886,100</b>	<b>55,149,824</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

**Aneksi B3: Plani përfundimtar i buxhetit për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025, në lekë**

Nr.	Përshkrimi	Plan Përfundimtar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	241,645,922	241,645,922	0
2	Shpenzimet (602, 604, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	90,713,056	90,713,056	0
3	Investime – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	15,000,000	15,000,000	0
4	Investime nga FZSHH	0		
<b>Total i planit fillestar</b>		<b>347,358,978</b>	<b>347,358,978</b>	<b>0</b>
<b>Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit</b>				
5	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	12,473,578	0	12,473,578
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	24,546,941	0	24,546,941
7	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	43,230,493	0	43,230,493
8	Investime nga FZSHH	0		
9	Pagesa 5 % garanci			
<b>Totali shtesa + ndryshime</b>		<b>80,251,012</b>		<b>80,251,012</b>
<b>Plani përfundimtar</b>				
10	Shpenzime për pagat (600+601) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	254,119,500	241,645,922	12,473,578
11	Shpenzime (602, 604,606, 609) – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	115,259,997	90,713,056	24,546,941
12	Investime nga Bashkia – nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	58,230,493	15,000,000	43,230,493
13	Investime nga FZSHH			
14	Pagesa 5 % garanci			
<b>Shuma e planit vjetor 2023</b>		<b>427,609,990</b>	<b>347,358,978</b>	<b>80,251,012</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

**Aneksi B4: Ndryshimet buxhetore së bashku me vendimet përkatëse për vitin 2022, në lekë**

Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				Buxheti Përfundimtar 2022
Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
		Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
VKB nr. 05 datë 31.01.2022	12,947,784	231	5,054,250		5,054,250	
		600	156,149		156,149	
		602	5,343,232		5,343,232	
		604	2,135,153		2,135,153	
		606	259,000		259,000	

<b>Shtesë</b>	<b>12,947,784</b>		<b>12,947,784</b>		<b>12,947,784</b>	
VKB nr. 10 datë 22.02.2022		602		200,000	-200,000	
		604		200,000	-200,000	
		606	400,000		400,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>400,000</b>	<b>400,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 15 datë 28.03	9,990,750	231	9,990,750		9,990,750	
<b>Shtesë</b>	<b>9,990,750</b>		<b>9,990,750</b>	<b>0</b>	<b>9,990,750</b>	
VKB nr. 17 datë 28.03.2022		231		4,668,000	-4,668,000	
		600	4,000,000		4,000,000	
		601	668,000		668,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>4,668,000</b>	<b>4,668,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 23 dhe 24 datë 27.04.2022		602		150,000	-150,000	
		606	150,000		150,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>150,000</b>	<b>150,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 41,42 datë 27.06.2022		231		1,500,000	-1,500,000	
		231	1,500,000		1,500,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>1,500,000</b>	<b>1,500,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 48 datë 25.07.2022		231		2,164,000	-2,164,000	
		231	2,164,000		2,164,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>2,164,000</b>	<b>2,164,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 53 datë 29.09.2022	24,192,000	231	15,046,584		15,046,584	
		600	4,500,000		4,500,000	
		601	751,500		751,500	
		602	3,893,916		3,893,916	
<b>Shtesë</b>	<b>24,192,000</b>		<b>24,192,000</b>	<b>0</b>	<b>24,192,000</b>	
VKB nr. 63 datë 24.10.2022		231		1,682,000	-1,682,000	
		231	1,682,000		1,682,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>1,682,000</b>	<b>1,682,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 67 datë 24.10.2022		602		100,000	-100,000	
		606	100,000		100,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>100,000</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 5 datë 24.10.2022	804,290	600	689,195		689,195	
		601	115,095		115,095	
<b>Shtesë</b>	<b>804,290</b>		<b>804,290</b>	<b>0</b>	<b>804,290</b>	
VKB nr. 64 datë 24.10.2022		600	2,063,500	1,817,500	246,000	
		601	163,000	409,000	-246,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>2,226,500</b>	<b>2,226,500</b>	<b>0</b>	
Akt normativ nr. 17 DT 01.12.2022	6,155,000	602	6,155,000		6,155,000	
<b>Shtesë</b>	<b>6,155,000</b>		<b>6,155,000</b>	<b>0</b>	<b>6,155,000</b>	
VKB nr. 65, 67 datë 24.10.2022		602		100,000	-100,000	
		606	100,000		100,000	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>100,000</b>	<b>100,000</b>	<b>0</b>	
Shkrese nr. 130 datë 05.01.2023	1,060,000	606	1,060,000		1,060,000	
<b>Shtesë</b>	<b>1,060,000</b>		<b>1,060,000</b>	<b>0</b>	<b>1,060,000</b>	
VKM 898 datë 29.12.2022		604		1,260,000	-1,260,000	
		600		4,235,448	-4,235,448	
		606	5,495,448		5,495,448	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>5,495,448</b>	<b>5,495,448</b>	<b>0</b>	
<b>Totali 2022</b>	<b>55,149,824</b>	<b>0</b>	<b>73,635,772</b>	<b>18,485,948</b>	<b>55,149,824</b>	<b>379,035,924</b>

Burimi: Bashkia Skrapar

### Aneksi B5: Ndryshimet buxhetore së bashku me vendimet përkatëse për vitin 2023, në lekë

Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				Buxheti perfundimtar 2023
Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
		Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
VKB nr. 03 datë 24.01.2023	36,906,590	230	3,000,000		3,000,000	
		231	24,985,582		24,985,582	
		600	1,676,190		1,676,190	
		601	524,534		524,534	
		602	5,699,446		5,699,446	
		604	669,598		669,598	
<b>Shtesë</b>	<b>36,906,590</b>		<b>36,906,590</b>	<b>0</b>	<b>36,906,590</b>	
VKB nr. 15 datë 28.03.2023	818,088	600	643,799		643,799	
		601	174,289		174,289	
<b>Shtesë</b>	<b>818,088</b>		<b>818,088</b>	<b>0</b>	<b>818,088</b>	
SHKRESE nr. 8321 datë 08.05.2023	3,917,318	600	3,356,740		3,356,740	
		601	560,578		560,578	
<b>Shtesë</b>	<b>3,917,318</b>		<b>3,917,318</b>	<b>0</b>	<b>3,917,318</b>	
VKB nr. 09 datë 29.06.2023		230	3,784,208		3,784,208	
		231		5,248,300	-5,248,300	
		600	583,369		583,369	
		601	80,723		80,723	
		602	800,000		800,000	
<b>Transferim</b>			<b>5,248,300</b>	<b>5,248,300</b>	<b>0</b>	

VKB nr. 14 datë 26.09.2023	7,058,016	600	6,056,200		6,056,200	
		601	1,001,816		1,001,816	
<b>Shtesë</b>	<b>7,058,016</b>		<b>7,058,016</b>	<b>0</b>	<b>7,058,016</b>	
VKB nr. 19 datë 26.09.2023	3,800,000	231	9,077,121	5,277,121	3,800,000	
<b>Shtese dhe transferim</b>	<b>3,800,000</b>		<b>9,077,121</b>	<b>5,277,121</b>	<b>3,800,000</b>	
VKB nr. 29 datë 23.11.2023		602		770,179	-770,179	
		231	770,179		770,179	
<b>Transferim</b>	<b>0</b>		<b>770,179</b>	<b>770,179</b>	<b>0</b>	
VKB nr. 30 datë 23.11.2023 (Akt Normativ nr. 5, datë 18.10.2023)	10,000,000	231	10,000,000		10,000,000	
<b>Shtesë</b>	<b>10,000,000</b>	<b>231</b>	<b>10,000,000</b>	<b>0</b>	<b>10,000,000</b>	
VKB nr. 45 datë 21.12.2023 (Akt Normativ nr. 6, datë 14.12.2023)	17,751,000	231	1,260,433		1,260,433	
		602	16,490,567		16,490,567	
<b>Shtesë</b>	<b>17,751,000</b>		<b>17,751,000</b>	<b>0</b>	<b>17,751,000</b>	
<b>Totali 2023</b>	<b>80,251,012</b>	<b>231</b>	<b>91,546,612</b>	<b>11,295,600</b>	<b>80,251,012</b>	<b>427,609,990</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

#### Aneksi B6: Përdorimi i të ardhurave për vitin 2022, në lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Diferenca	%
1	600 – Paga	198,565,000	192,096,000	6,469,000	97
2	601 – Sigurime shoqërore	34,039,000	31,812,000	2,227,000	93
3	602 – Shpenzime operative	79,327,000	71,920,000	7,407,000	91
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609)	16,921,251	10,987,807	5,933,444	65
5	Ndihma ekonomike dhe PAK	134,304,000	132,252,193	2,051,807	98
6	Investimet (230 + 231)	225,727,000	200,779,000	24,948,000	89
7	Shpërblime lindje – 606	0	0	0	
8	466 – Garancitë	532,874	532,874	0	100
<b>Totali</b>		<b>689,416,125</b>	<b>640,379,874</b>	<b>49,036,251</b>	<b>93</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

#### Aneksi B7: Përdorimi i të ardhurave për vitin 2023, në lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Diferenca	%
1	600 – Paga	224,603,234	221,488,658	3,114,576	99
2	601 – Sigurime shoqërore	37,469,759	36,312,181	1,157,578	97
3	602 – Shpenzime operative	104,841,538	75,119,777	29,721,761	72
4	Totali shpenzime të tjera – (606, 604, 609)	13,803,080	5,158,344	8,644,736	37
5	Ndihma ekonomike dhe PAK	126,253,000	123,650,525	2,602,475	98
6	Investimet (230 + 231)	154,708,145	117,212,839	37,495,306	76
7	Shpërblime lindje – 606	222,650	150,650	72,000	68
8	466 – Garancitë	824,632	824,632	0	100
<b>Totali</b>		<b>662,726,038</b>	<b>579,917,606</b>	<b>82,808,432</b>	<b>88</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

#### Aneksi B8: Të ardhurat për vitin 2022, plan-fakt, në lekë

Përshkrimi	Plan 2022	Fakt 2022	Diferenca	%
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2021	6,765,935	6,765,935	0	100
Të trashëguara nga transf.specifike 2021	5,512,561	5,512,561	0	100
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2021	669,288	669,288	0	100
Të ardhurat e veta të vitit 2022	94,192,000	77,111,090	17,080,910	82
Grante të pakushtëzuara viti 2022	261,905,390	261,905,390	0	100
Grante specifike të vitit 2022, të detajuara:	319,907,419	319,907,419	0	100
-Nga FZSHH	0	0	0	-
-Nga Ministrinë e Linjës	175,612,669	175,612,669	0	100
-Donatorë të ndryshëm	9,990,750	9,990,750	0	100
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	134,304,000	134,304,000	0	100
-Nga huatë	0	0	0	-
<b>Totali</b>	<b>688,952,593</b>	<b>671,871,683</b>	<b>17,080,910</b>	<b>98</b>

Burimi: *Bashkia Skrapar*

#### Aneksi B9: Të ardhurat për vitin 2023, plan-fakt, në lekë

Përshkrimi	Plan 2023	Fakt 2023	Diferenca	%
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2022	16,023,231	16,023,231	0	100
Të trashëguara nga transf.specifike 2022	3,893,425	3,893,425	0	100
Të trashëguara nga transf.pakushtëzuara 2022	17,808,022	17,808,022	0	100
Të ardhurat e veta të vitit 2023	73,800,000	64,484,901	9,315,099	87
Grante të pakushtëzuara viti 2023	316,085,312	316,085,312	0	100
Grante specifike të vitit 2023, të detajuara:	234,294,402	234,294,402	0	100
-Nga FZSHH	0	0	0	-
-Nga Ministrinë e Linjës	108,041,402	108,041,402	0	100
-Donatorë të ndryshëm	0	0	0	-
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	126,253,000	126,253,000	0	100
-Nga huatë	0	0	0	-
<b>Totali</b>	<b>661,904,392</b>	<b>652,589,293</b>	<b>9,315,099</b>	<b>99</b>

**Aneksi B10: Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022, sipas raportimit në MFE, në lekë**

Detyrime	Detyrimi në 31.12.2021	Detyrimi i krijuar në vitin 2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2022	Detyrimet në datën 31.12.2022
Investime	1,424,996	17,060,570	18,485,566	17,214,400	1,271,166
Investime nga ministrinë e linjës	0	56,992,928	56,992,928	49,400,000	7,592,928
Mallra dhe shërbime	8,878,711	2,874,844	11,753,555	6,438,054	5,315,501
Vendime gjyqësore	6,777,207		6,777,207	2,850,893	3,926,314
Të tjera	2,351,190		2,351,190	1,923,690	427,500
<b>Totali</b>	<b>19,432,104</b>	<b>76,928,342</b>	<b>96,360,446</b>	<b>77,827,037</b>	<b>18,533,409</b>

Burimi: Bashkia Skrapar

**Aneksi B11: Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023, sipas raportimit në MFE, në lekë**

Detyrime	Detyrimi në 31.12.2022	Detyrimi i krijuar në vitin 2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2023	Detyrimet në datën 31.12.2023
Investime	1,271,166	1,245,376	2,516,542	1,615,342	901,200
Investime nga ministrinë e linjës	7,592,928	30,530,776	38,123,704	38,123,704	0
Mallra dhe shërbime	5,315,501	586,500	5,902,001	652,962	5,249,039
Vendime gjyqësore	3,926,314	2,150,553	6,076,867	1,059,103	5,017,764
Të tjera	427,500	2,467,950	2,895,450	7,500	2,887,950
<b>Totali</b>	<b>18,533,409</b>	<b>36,981,155</b>	<b>55,514,564</b>	<b>41,458,611</b>	<b>14,055,953</b>

Burimi: Bashkia Skrapar

**Anekset mbi të ardhurat****Aneksi A1: Struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave për periudhën 2022-2023:**

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data e fillimit	Ndryshimet 2022-2023
1	H.B	P/Sektorit të Ardhurave	10.03.2021	Nuk ka
2	B.Ç	Insp/Tatim -taksave	07.10.2020	Nuk ka
3	S.A	Specialiste e te ardhurave	04.10.2022	Nuk ka
4	SH.A	Specialist transporti	20.04.2022	Nuk ka
5	A.L	Insp/Kontrollit dhe Adm. Tregut	03.01.2018	Nuk ka
6	G.H	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Qendër	01.02.2012	vazhdon
7	N.K	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Bogovë	03.08.2015	vazhdon
8	N.D	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Vëndreshë	03.08.2015	vazhdon
9	S.B	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Çepan	03.08.2015	larguar 31.08.2022
10	F.B	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Çepan	01.09.2022	vazhdon
11	E.O	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Potom	14.01.2022	vazhdon
12	L.B	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Leshnje	05.08.2015	vazhdon
13	F.L	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Gjerbës	06.11.2020	vazhdon
14	TH.SH	Insp.T-Taksave, Nj.Adm Zhepë	03.10.2019	vazhdon

Burimi: STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Aneksi A2: Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore për vitet 2022-2023, në lekë**

Nr.	Emërtimi	Tap Kod	F	Viti 2022			Viti 2023		
				Plan	Fakt	Realizimi %	Plan	Fakt	Realizimi %
<b>I</b>	<b>Te ardhura tatimore</b>	<b>TB</b>	<b>106</b>	<b>21,192,660</b>	<b>17,164,626</b>	<b>81</b>	<b>19,515,715</b>	<b>17,270,952</b>	<b>88</b>
1	Taksa mbi Bize Vog {TTHFitimi}	TB	9		0		0	97,135	
2	Taks mbi Pasurin e Paluajtshme	TB	37	13,470,860	7,206,866	53	12,958,915	6,652,075	51
a	Taksa mbi ndertesat	TB	19	4,132,767	2,762,395	67	3,716,132	2,597,760	70
	- Nga subjektet	TB	9	1,556,103	1,428,420	92	1,573,313	1,114,821	71
	- Nga familjaret	TB	9	2,576,664	1,333,975	52	2,142,819	1,482,939	69
	- Nga Institucionet	TB	1	0	0		0	0	
a-2	Takse mbi truallin	TB	9	1,164,467	807,777	69	1,210,422	731,494	60
b	Taksa mbi Token Bujqesore	TB	9	8,173,626	3,636,694	44	8,032,361	3,322,821	41
3	Taksa e ndikim infrast& lej ndert	TB	9	1,600,000	953,349	60	1,300,000	301,470	23
	Taksa per zenien e hapesires publike	TB	9	0	141,850		0	10,000	
4	Taksa e rregjistrim automj	TB	9	5,800,000	5,015,687	86	5,000,000	5,152,502	103
5	Takse table	TB	12	151,800	151,800	100	151,800	80,500	53
	- Nga subjektet fizike	TB	1		71,300		0	80,500	
	- Nga transporti	TB	1		0		0	0	
	- Nga subjekjuridik gjuh huaj	TB	1		0		0	0	
	- Nga subjekjuridik gjuh shqip	TB	9	151,800	80,500	53	151,800	0	-
6	Takse fjetje ne hotel	TB	9	90,000	0	0	90,000	0	-
<b>7</b>	<b>Renta minerare</b>	<b>TB</b>	<b>1</b>	<b>80,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15,000</b>	<b>20,364</b>	<b>136</b>
8	Takse e kalimdrejt Pronesise	TB	9		5,141		0	269,015	
9	Takse Prone Pyll Kullote	TB	1		0		0	0	
10	Tatim nga te ardhurat personale	TB			3,689,933				
<b>II</b>	<b>Te ardhura jotatimore</b>	<b>TB</b>	<b>208</b>	<b>39,723,993</b>	<b>69,939,194</b>	<b>176</b>	<b>38,052,878</b>	<b>44,092,163</b>	<b>116</b>
1	Tarife Pastrimi	TB	21	14,118,900	12,678,541	90	12,904,300	13,149,011	102

Nr.	Emërtimi	Tap Kod	F	Viti 2022			Viti 2023		
				Plan	Fakt	Realizimi %	Plan	Fakt	Realizimi %
	- Nga familjaret	TB	9	2,417,900	1,343,500	56	2,025,800	1,425,700	70
	- Nga subjektet	TB	9	10,204,000	9,728,541	95	9,380,000	10,011,811	107
	- Nga institucionet	TB	1	1,472,000	1,479,500	101	1,483,500	1,623,500	109
	- Nga firmat e ndertimit	TB	1	0	0		0	0	
	- Nga transporti	TB	1	25,000	127,000	508	15,000	88,000	587
2	Tarife Ndrichi	TB	20	2,660,017	1,985,609	75	2,383,600	2,169,203	91
	- Nga familjaret	TB	9	1,370,350	751,289	55	1,134,600	802,380	71
	- Nga subjek e firma ndert	TB	9	1,044,667	891,320	85	1,009,000	1,041,823	103
	- Nga institucionet	TB	1	225,000	225,000	100	225,000	220,000	98
	- Nga transporti	TB	1	20,000	118,000	590	15,000	105,000	700
3	Tarife Gjelberimi	TB	20	1,774,833	1,495,924	84	1,626,100	1,553,974	96
	- Nga familjaret	TB	9	759,000	448,300	59	625,100	437,200	70
	- Nga subjek e firma ndert	TB	9	940,833	849,124	90	911,000	930,274	102
	- Nga institucionet	TB	1	75,000	75,000	100	75,000	80,000	107
	- Nga transporti	TB	1	0	123,500		15,000	106,500	710
4	T zenie hapes Publike(a+b)	TB	3	850,000	914,050	108	890,000	802,600	90
	a-Takse tregu	TB	1	400,000	345,500	86	400,000	368,400	92
	b-T park Automjet(1b+2b)	TB	2	450,000	568,550	126	490,000	434,200	89
	1b- Nga inspektor i tregut	TB	1	300,000	330,550	110	350,000	269,200	77
	2b- Nga transporti	TB	1	150,000	238,000	159	140,000	165,000	118
5	T-repertitorri vitet kaluara	TB	1	0	0		3,000,000	0	-
6	Trife Therje bagetie	TB	1	0	0		0	0	
7	Miremb Infrastrukture	TB	9	1,418,700	1,357,734	96	1,245,400	1,869,197	150
8	Tarif Sherbimi (dosje ndihme ekon )	TB	9	287,500	70,850	25	183,120	64,200	35
6	Tarife alkooli	TB	8	0	120,600		0	68,800	
7	Tdru zj+Ndert	TB	8	2,931,000	2,388,350	81	3,545,200	3,060,882	86
8	Tkullotje, gjeth	TB	8	1,252,810	1,023,870	82	1,207,700	813,175	67
9	Qira FPjyor	TB	8	400,000	0	0	200,000	0	-
9	Tarife Rregjistrimi ne Konvikt	TB	1	840,000	0	0	84,000	0	-
10	Leje Transporti	TB	1	500,000	307,600	62	21,858	28,740	131
11	Te ardhura nga cerdhe	TB	1	900,000	708,750	79	700,000	842,700	120
12	Te ardhura nga konvikti	TB	1	1,100,000	387,708	35	400,000	380,105	95
13	Qera tregu	TB	1	0	0		0	0	
14	Te ardhura nga QK	TB	1	0	0		0	0	
15	Te ardh nga SherbPublik(ShFnerali)	TB	1	700,000	411,000	59	400,000	546,800	137
16	Te ardhura nga QKF	TB	1	0	0		0	5,425	
17	Te ardh nga gjobat + kamatevones	TB	9	100,000	116,310	116	100,000	173,100	173
18	Dokum Tenderi( DosjNd/ekon)	TB	1	0	25,200		0	71,740	
19	Te ardhura Detyrim Prapamb	TB	9	2,615,000	1,045,511	40	2,465,000	946,085	38
20	Leja ndertimi + LZhvillimi	TB	1	250,000	224,000	90	250,000	251,455	101
21	Tarif per rafting	TB	1	0	0		0	0	
22	Leje per hapje pike karburanti	TB	1	0	0		0	63,000	
23	T-Kalimit te automjet TonRend	TB	1	0	8,450		0	0	
24	Te Tjera te paspecifikuara	TB	8	480,000	11,046,677	2,301	460,000	315,760	69
	-Qira ndertese {Banimi+ LOKALI}	TB	1	100,000	81,466	81	80,000	47,240	59
	-Qira ndertese Alba Shoes+thertore	TB	1	0	101,961		0	258,520	
	Te ardh nga zgjicivile	Tb	1	0	0		0	0	
	-Transferte nga ministria	TB	1	0	0		0	0	
	Sponsorizime (fondbesa)	Tb	1	250,000	10,785,150		250,000	0	-
	License mmz	Tb	1	130,000	73,000	56	130,000	10,000	8
	Certifikate therje	Tb	1	0	0		0	0	
	- Shtypshkrime	TB	1	0	5,100		0	0	
25	Te tjera { Qira Trualli-etj }KVonese	TB	1	200,000	215,399	108	200,000	4,992,620	2,496
26	Qira Ndertese zyra arsimore	TB	1	110,400	0	0	0	0	
27	Kthim shume posta	TB	1	0	0		0	0	
28	Qira lokali	Tb	1	240,000	60,000	25	120,000	110,000	92
29	Te ardhura nga transporti (ministria)	TB	1	0	0		0	0	
30	alb-star+ SPECAPAG	TB	1	0	9,990,750		0	0	
31	Dhenie mjete me qera	TB	1	80,000	0	0	80,000	0	-
32	Te ardhura sherbimi veteriner	TB	4	40,000	0	0	0	143,228	
	Te tjera veterinare	TB	1	0	0		0	0	
	T-veterin per automjtransp Blektori	TB	1	0	0		0	0	
	T-veterin Paisje me certifikate	TB	1	40,000	0	0	0	0	
	T-nga peshimi I blektorise	TB	1	0	0		0	143,228	
33	Te tjera	Tb	9	1,500,000	17,492,400	1,166	500,000	1,282,568	257
34	Projekti " TAP"-Sponsorizim	TB	1	0	1,147,236		0	5,805,438	
35	Dru zjarri nga Nd/Sherb/Pyjor	TB	1	0	0		0	0	
36	Renta minerare	Tb	1	80,000	17,943	22	15,000	0	-
37	Kamate vonese	Tb	1	0	18,662		0	65,932	
38	Tarife vaditje	TB	9	75,000	0	0	75,000	0	-
39	Perdorim rruge BM	TB	9	4,835,833	1,650,417	34	4,896,600	3,834,133	78
40	Perdorim rruge BM	TB	9		2,840,000		100,000	33,448	33
41	Urdher zhdemtim	TB	1	0	179,653		0	648,844	
42	Kontrate Qira Toke Are	TB	1	0	10,000		0	0	
	<b>TOTALI T-Tarifa</b>	<b>TB</b>	<b>314</b>	<b>60,916,653</b>	<b>87,103,820</b>	<b>143</b>	<b>57,568,593</b>	<b>61,363,115</b>	<b>107</b>
	a-Nd/Sherbpyjor	TB	11		0		9,416,171	3,121,786	33



Nr.	Emërtimi	Tap Kod	F	Viti 2022			Viti 2023		
				Plan	Fakt	Realizimi %	Plan	Fakt	Realizimi %
	b-TAP	TB	0		0		0	0	
<b>TOTALI BASHKIA</b>		<b>TB</b>	<b>325</b>	<b>60,916,653</b>	<b>87,103,820</b>	<b>143</b>	<b>66,984,764</b>	<b>64,484,901</b>	<b>96</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

### Aneksi A3: Tabela përmbledhëse për njësinë qëndër dhe njësitë e varësisë, në lekë

Emërtimi	Kod	F	Viti 2022			Viti 2023		
			Plan	Fakt	Realizimi %	Plan	Fakt	Realizimi %
Qender	Q	29	7,492,170	5,801,008	77	5,349,000	3,736,600	70
Bogove	B	29	5,485,229	3,557,955	65	2,879,700	1,383,239	48
Vendreshe	V	29	1,535,986	1,344,212	88	1,804,000	960,480	53
Cepan	C	29	2,293,371	1,382,750	60	2,282,721	1,190,810	52
Potom	P	29	2,254,107	1,712,567	76	2,004,393	1,482,672	74
Leshnje	L	29	2,950,262	2,073,538	70	1,283,152	973,800	76
Gjërbes	GJ	29	6,431,975	3,077,977	48	1,737,026	639,150	37
Zhepe	ZH	29	2,610,550	925,854	35	2,289,045	355,953	16
Tot-Njesit	TNj	232	31,053,650	19,875,861	64	19,629,037	10,722,704	55
2=Shuma Corovode	SK	82	29,863,003	67,227,959	225	37,939,556	50,640,411	133
Totali T-Tarifa		314	60,916,653	87,103,820	143	57,568,593	61,363,115	107
+ Nd/ Sherb-PyJOR	TB	11	0	0		9,416,171	3,121,786	33
+Tap	TAP	0	0	0		0	0	
<b>Totali Bashkia</b>		<b>324</b>	<b>60,916,653</b>	<b>87,103,820</b>	<b>143</b>	<b>66,984,764</b>	<b>64,484,901</b>	<b>96</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### Aneksi A4: Ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, si dhe të trashëguar nga vitet e mëparshme.

Emërtimi sipas llojit		Nr.	Vlera
<b>I</b>	<b>Ne fillim të vitit 2022 (trashëguar nga vitet e mëparshme)</b>	<b>3486</b>	<b>85,872,422</b>
1	Biznesi madh	21	2,516,808
2	Biznesi vogel	21	280,841
3	Institucione	0	0
4	Tregtar ambulant	0	0
5	Familjar	3,443	82,834,773
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture per legal obj.informale	0	0
7	Gjoha te IVMT	0	0
8	Gjoha te Policise Bashkiake	0	0
9	Qira trualli	1	240,000
10	Qira objekti		85,872,422
11	Qira fond pyJOR kullososr		
<b>II</b>	<b>Krijuar brenda vitit 2022</b>	<b>2,912</b>	<b>9,324,913</b>
1	Biznesi madh	6	2,114,490
2	Biznesi vogel	5	63,770
3	Institucione	0	0
4	Tregtar ambulant	0	0
5	Familjar	2,900	7,026,653
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture per legal obj.informale	0	0
7	Gjoha te IVMT		
8	Gjoha te Policise Bashkiake		
9	Qira trualli	1	120,000
10	Qira objekti		
11	Qira fond pyJOR kullososr		
<b>III</b>	<b>Ne fund te vitit 2022(progresive)</b>	<b>6,397</b>	<b>95,197,335</b>
1	Biznesi madh	27	4,631,298
2	Biznesi vogel	26	344,611
3	Institucione	0	0
4	Tregtar ambulant	0	0
5	Familjar	6,343	89,861,426
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture per legal obj.informale	0	0
7	Gjoha te IVMT		
8	Gjoha te Policise Bashkiake		
9	Qira trualli	1	360,000
10	Qira objekti		
11	Qira fond pyJOR kullososr		
<b>IV</b>	<b>Krijuar brenda vitit 2023</b>	<b>2,551</b>	<b>10,634,682</b>
1	Biznesi madh	17	3,353,730
2	Biznesi vogel	13	216,968
3	Institucione	0	0
4	Tregtar ambulant	0	0
5	Familjar	2,520	6,943,984
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture per legal obj.informale		
7	Gjoha te IVMT		
8	Gjoha te Policise Bashkiake		
9	Qira trualli	1	120,000
10	Qira objekti		

Emërtimi sipas llojit		Nr.	Vlera
11	Qira fond pyjor kullosor		
<b>V</b>	<b>Ne fund te vitit 2023(progressive)</b>	<b>8,948</b>	<b>105,832,017</b>
1	Biznesi madh	44	7,985,028
2	Biznesi vogel	39	561,579
3	Institucione	0	0
4	Tregtar ambulant	0	0
5	Familjar	8,863	96,805,410
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture per legal obj.informale	0	
7	Gjoha te IVMT	0	
8	Gjoha te Policise Bashkiake	0	
9	Qira trualli	2	480,000
10	Qira objekti	0	
11	Qira fond pyjor kullosor	0	

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### Aneksi A5: Të dhënat për Taksën e ndërtimit në Infrastrukturë për vitin 2022, në lekë

Nr.	Emër / Mbiemër	Data	Lloji i objektit	Sip. ndërtimi m <sup>2</sup>	% që aplikohet	Shuma që duhet të arkëtohet	Faturuar Po/Jo	Paguar
1	E.C	24.02.2022	Banesë	30,3	0.5%	4,895	Po	4,895
2	D.N	24.02.2022	Shërbim	43,4	0.5%	7,012	Po	7,012
3	G.J.B	21.04.2022	Banesë	248,6	0.5%	40,165	Po	40,165
4	A Shpk	23.06.2022	Shërbim	133,4	0.5%	21,553	Po	21,553
5	A Shpk	23.06.2022	Shërbim	248,4	0.5%	40,133	Po	40,133
6	M.M	09.11.2022	Shërbim	48,6	0.5%	7,852	Po	7,852
7	R.Z	09.11.2022	Banesë	73,9	0.5%	11,940	Po	11,940
8	D.SH	19.12.2022	Banesë	432,6	0.5%	69,893	Po	69,893
<b>Totali</b>						<b>203,443</b>		<b>203,443</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### Aneksi A6: Të dhënat për Taksën e ndërtimit në Infrastrukturë për vitin 2023, në lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Data	Lloji i objektit	Sip. ndërtimi m <sup>2</sup>	% që aplikohet	Shuma që duhet të arkëtohet	Faturuar Po/Jo	Paguar
1	Z.Q	09.03.2023	Social-ekonomik	748	0.5%	120,851	Po	120,851
2	G.Q	09.03.2023	Kombinuar	438,8	0.5%	70,895	Po	70,895
3	B.C	05.07.2023	Banesë	188,5	0.5%	30,455	Po	30,455
<b>Totali</b>						<b>222,201</b>		<b>222,201</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### Aneksi A7: Numri i familjeve dhe vlerat debitore në një ose disa taksa/tarifa për vitin 2022, në lekë

Nr.	Njësia Administrative	Debitorë të trashëguar deri në 31.12.2021	Debitorë të krijuar në vitin 2022				Total debia progresive 2022	
			Familje me tokë bujqësore	Sip (m <sup>2</sup> )	Maturimi	Likuidimi		Debia
1	Qendër	11,966,633	1,563	17,410,000	2,000,000	1,312,740	687,260	12,653,893
2	Bogovë	14,363,328	710	6,710,000	1,233,086	370,149	862,937	15,226,265
3	Vendresha	1,640,856	456	7,540,000	480,237	591,814	-111,577	1,529,279
4	Çepan	9,714,166	592	9,380,000	1,180,800	301,188	879,612	10,593,778
5	Potom	3,655,647	613	7,590,000	726,714	274,415	452,299	4,107,946
6	Leshnje	2,554,547	347	3,340,000	406,489	150,426	256,063	2,810,610
7	Gjerbës	5,458,730	843	8,090,000	851,300	138,794	712,506	6,171,236
8	Zhepë	10,927,328	865	10,860,000	1,146,000	312,445	833,555	11,760,883
9	Çorovoda	229,287	122	704,729	98,662	184,723	-86,061	143,226
<b>Totali</b>		<b>60,510,522</b>	<b>6,111</b>	<b>71,624,729</b>	<b>8,123,288</b>	<b>3,636,694</b>	<b>4,486,594</b>	<b>64,997,116</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

#### Aneksi A8: Numri i familjeve dhe vlerat debitore në një ose disa taksa/tarifa për vitin 2023, në lekë

Nr.	Njësia Administrative	Debitorë të trashëguar deri në 31.12.2021	Debitorë të krijuar në vitin 2022				Total debia progresive 2022	
			Familje me tokë bujqësore	Sip (m <sup>2</sup> )	Maturimi	Likuidimi		Debia
1	Qendër	12,653,893	1,563	17,410,000	2,000,000	1,478,530	521,470	13,175,363
2	Bogovë	15,226,265	710	6,710,000	883,946	385,131	498,815	15,725,080
3	Vendresha	1,529,279	456	7,540,000	679,870	350,600	329,270	2,081,703
4	Çepan	10,593,778	592	9,380,000	1,180,800	252,471	928,329	11,522,107
5	Potom	4,107,946	613	7,590,000	786,078	336,054	450,024	4,557,970
6	Leshnje	2,810,610	347	3,340,000	406,489	185,306	221,183	2,519,667
7	Gjerbës	6,171,236	843	8,090,000	852,388	107,117	745,271	6,916,507
8	Zhepë	11,760,883	865	10,860,000	1,146,000	135,622	1,010,378	12,771,261
9	Çorovoda	143,226	122	704,729	98,662	91,990	6,672	149,898
<b>Totali</b>		<b>64,997,116</b>	<b>6,111</b>	<b>71,520,000</b>	<b>8,034,233</b>	<b>3,322,821</b>	<b>4,711,412</b>	<b>69,276,330</b>

**Burimi:** STTV Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

## Anekset mbi prokurimet publike

### Aneksi P1: Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të kontratës
1	Blere peleta për ngrohje për vitin 2022	500,000	Small Value	488,750	07/12/2022 12:00 PM	S		
2	Blerje detergjentë dhe materiale pastrimi	400,000	Small Value	304,310	27/07/2022 11:00 AM	A		
3	Blerje dru zjarri për objektet arsimore për vitin 2022	1,000,000	Small Value	982,800	25/10/2022 12:30 PM	XH.M		
4	Blerje goma për automjetet e bashkisë	208,000	Small Value	198,800	25/10/2022 01:00 PM	K		
5	Blerje karburanti për punime në akset e rrugëve rurale në segmentet : Ish punishte Prishtës - Rovicë, Zhepë - Gurrazes dhe rruga e fshatit Trebël	417,921	Small Value	417,920	01/11/2022 12:00 PM	G		
6	Blerje materiale dhe shpenzime të ndryshme për projektin "Forcimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (CRM) për adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Skrapar"	172,666	Small Value	170,900	16/06/2022 01:30 PM	G		
7	Blerje materiale kancelarie	375,000	Small Value	299,999	29/03/2022 12:30 PM	L		
8	Blerje materiale për kryerjen e punimeve për zgjidhjen e problematikës së shkarkimit të Ujrave të Zeza te pallati ku ndodhet filiali i Postës, si dhe disa segmente të tjera të rrjetit të KUZ brenda qytetit	329,782	Small Value	328,000	14/12/2022 10:30 AM	I		
9	Blerje materiale për organizimin e dekorimeve për festat e fundvitit	1,000,000	Small Value	749,000	15/11/2022 12:00 PM	B		
10	Blerje naftë për administratën, për ujitje - kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2022	3,333,333	Open Simple	3,333,333	15/02/2022 10:00 AM	G	3/23/2022	12/31/2022
11	Blerje pajisje kompjuterike për shkollën e mesme "Ramiz Aranitasi", dhe shkollat 9-vjeçare "Kahreman Ylli" dhe "Zylyftar Veleshnja"	833,333	Small Value	785,400	18/11/2022 11:00 AM	S		
12	Blerje set uniforma kundra zjarrit për punonjësit e PMNZSH	410,000	Small Value	399,000	22/12/2022 01:30 PM	A		
13	Blerje tonera	250,000	Small Value	124,250	24/06/2022 10:30 AM	L		
14	Blerje ushqimesh për Çerdhen	636,292	Small Value	620,320	16/03/2022 01:00 PM	S		
15	Blerje ushqimesh për fëmijët e Qendrës Alternative	217,578	Small Value	214,648	16/03/2022 01:00 PM	S		
16	Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2022	1,896,808	Open Simple	1,880,660	29/03/2022 10:00 AM	S	4/1/2022	12/31/2022
17	Bojatisje me hidromat dhe sherbetim me gëlqere i shkollave të Bashkisë Skrapar për vitin 2022	999,060	Small Value	570,000	21/07/2022 12:30 PM	A		
18	F.V Kondicionerë për zyra	610,000	Small Value	368,000	10/06/2022 11:00 AM	B		
19	Hartim projekti për "Ndërtim i shkollës së mesme të bashkuar Potom, Skrapar"	960,000	Small Value	930,000	15/06/2022 10:30 AM	A		
20	Hartim projekti për "Riveshje dhe asfaltim i disa segmenteve rrugore të qytetit të Çorovodës"	970,000	Small Value	831,837	15/06/2022 10:30 AM	T		
21	Mbikëqyrje dhe kolaudime objektsh për vitin 2022	621,608	Small Value	235,981	04/02/2022 11:00 AM	G		
				168,659	15/12/2022 12:30 PM	A		
				267,663	15/12/2022 01:30 PM	A		
22	Mbikëqyrje punimesh për "Mur mbajtës përgjatë lumit Osum te ish-kantieri i N.SH.N."	957,686	Small Value	856,492	28/09/2022 10:00 AM	HH		
23	Mur mbrojtës përgjatë lumit Osum te ish-kantieri N.SH.N.	51,998,778	Open Local	50,628,701	26/08/2022 10:00 AM	D	9/30/2022	12/23/2022
24	Rigjenerimi urban i zonës afër Gjimnazit në Rugën e Dëshmorëve, Çorovodë	10,908,570	Open Simple	10,662,150	17/11/2022 10:00 AM	F	12/27/2022	4/11/2023
25	Rikonstruksion i varresave të Dëshmorëve	833,333	Small Value	667,000	02/06/2022 01:30 PM	V		
26	Riparim dhe pastrim i kanalit ujitës të ujëmbledhësit Rog	600,405	Small Value	490,000	29/04/2022 01:30 PM	A		
27	Riparim dhe pastrim i kanalit ujitës të ujëmbledhësit Vëndreshë	564,635	Small Value	448,000	29/04/2022 01:30 PM	A.B		
28	Riparim i kanalit ujitës të fshatit Gjerbës dhe Strafcikë	337,182	Small Value	283,000	23/06/2022 01:00 PM	A		
29	Shërbim interneti për Njësitë Administrative për vitin 2022	640,000	Small Value	600,000	04/02/2022 11:00 AM	A		
30	Shërbime mirëmbajtje për makinat e bashkisë për vitin 2022	1,000,000	Small Value	995,000	13/06/2022 10:30 AM	M.B		
31	Shpenzime të ndryshme për pritje-përcjellje, organizim evente dhe raste të tjera	666,666	Small Value	644,000	23/11/2022 12:00 PM	P.A		
32	Siguracion i automjeteve të Bashkisë për vitin 2022"	253,423	Small Value	253,400	10/06/2022 11:00 AM	A		

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të kontratës
33	Sigurim i jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (MZSH)	375,000	Small Value	375,000	04/03/2022 12:30 PM	I		
34	Sigurim i materialeve për organizim panairi	160,000	Small Value	155,000	29/04/2022 01:00 PM	J		
<b>Totali</b>		<b>85,437,059</b>		<b>81,727,973</b>				

**Burimi:** *Bashkia Skrapar*

### Aneksi P2: Prokurimet e zhvilluara nga Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedurës së Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të kontratës
1	Blerje detergjentë dhe materiale pastrimi për vitin 2023	450,000	Small Value	335,000	26/04/2023 12:00 PM	M		
2	Blerje dru zjarri për objektet arsimore për vitin 2023	1,000,000	Small Value	976,500	11/08/2023 12:00 PM	XH.M		
3	Blerje goma për automjetet e bashkisë për vitin 2023	280,000	Small Value	278,800	29/09/2023 10:30 AM	K		
4	Blerje materiale kancelarie	450,000	Small Value	340,000	20/01/2023 10:30 AM	M		
5	Blerje materiale kuzhine për hapjen e kopshtit me drekë, Bashkia Skrapar	328,300	Small Value	238,900	06/12/2023 10:30 AM	E.L		
6	Blerje materiale për organizimin e dekorit për festat e fundvitit 2023	600,000	Small Value	535,900	21/11/2023 02:30 PM	J		
7	Blerje materiale të ndryshme elektrike dhe hidraulike	400,000	Small Value	296,400	26/01/2023 01:30 PM	E.L		
8	Blerje materiale të ndryshme për organizimin e projektit "Ndërtimi i Qendrës Sportive në shkollën 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja"	237,723	Small Value	219,900	27/04/2023 12:00 PM	G		
9	Blerje naftë për administratën, për ujitje - kullimi dhe për zjarfikësen për vitin 2023	3,750,000	Open Simple	3,750,000	13/02/2023 10:00 AM	G	2/27/2023	12/31/2023
10	Blerje pajisje dhe veshje sportive për projektin "Ndërtimi i Qendrës Sportive në shkollën 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja"	419,673	Small Value	369,900	27/04/2023 12:30 PM	J		
11	Blerje peleta për ngrohje për vitin 2023	600,000	Small Value	385,000	23/11/2023 12:30 PM	A		
12	Blerje printera/fotokpje dhe kompjutera desktop për nevojat e Bashkisë	783,660	Small Value	750,000	20/07/2023 11:00 AM	S		
13	Blerje tonera	300,000	Small Value	150,000	25/07/2023 10:30 AM	B		
14	Blerje ushqimesh për Çerdhen për vitin 2023	779,547	Small Value	767,630	26/01/2023 10:30 AM	4 S		
15	Blerje ushqimesh për fëmijët e Qendrës Alternative për vitin 2023	316,074	Small Value	315,878	26/01/2023 10:30 AM	4 S		
16	Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2023	1,533,000	Open Simple	1,499,200	30/01/2023 10:00 AM	4 S	2/28/2023	12/31/2023
17	Bojatisje me hidromat dhe sherbetim me gëlqere e shkollave të Bashkisë Skrapar për vitin 2023	812,640	Small Value	570,000	10/08/2023 11:00 AM	A.LL		
18	Botim i referateve/kumtesave të mbajtura në konferencën shkencore "Veçori të luftës Antifashiste në krahinën e Skraparit 1942-1944" organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë	250,000	Small Value	200,000	27/10/2023 11:00 AM	N.Z		
19	F.V. barrier automatike trafiku pranë tregut të qytetit Çorovodë	300,000	Small Value	245,000	27/10/2023 11:00 AM	I		
20	Kolaudim punimesh për "Rigjenerimi urban i zonës afër Gjinnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë	22,963	Small Value	20,105	17/08/2023 01:30 PM	D & P		
21	Kolaudim punimesh për "Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja"	14,843	Small Value	9,850	05/07/2023 12:00 PM	D & P		
22	Lyerje të sallave të mbledhjeve në katin e dytë të Bashkisë Skrapar	177,828	Small Value	142,828	17/11/2023 10:30 AM	D		
23	Mbikqyrje punimesh për "Ndërtimi i mjediseve sportive/ fushe sportive, pranë shkollës 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja"	138,520	Small Value	120,152	18/04/2023 01:00 PM	H		
24	Ndërtimi i mjediseve sportive/ ndërtim fushe sporti, pranë shkollës "Zylyftar Veleshnja"	4,521,937	Open Simple	4,488,960	17/03/2023 10:00 AM	A	4/20/2023	6/22/2023
25	Organizime për festën e Çlirimit	500,000	Small Value	445,000	06/09/2023 02:00 PM	B.K		
26	Pastrim i kanalit ujitës të ujëmbledhësit Vëndreshë dhe Rog	232,780	Small Value	222,780	21/06/2023 12:00 PM	D		
27	Punime për përshtatjen e magazinës ushqimore për kopshtin me drekë	232,917	Small Value	189,998	20/12/2023 12:00 PM	A		
28	Rikonstruksion i shkarkuesit katastrofik në rezervuarin Staraveckë	303,480	Small Value	272,000	29/09/2023 10:30 AM	D		
29	Rikonstruksion i shkollës "Ramiz Aranitasi", Çorovodë	41,247,773	Open Local	35,972,535	03/07/2023 10:00 AM	F	9/28/2023	1/27/2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit të kontrates
30	Rikonstruksion i varrezave të Dëshmorëve, Çorovodë (faza II)	1,000,000	Small Value	768,400	30/05/2023 01:30 PM	N.H		
31	Rikonstruksion i zyrave të katit të III të godinës së Bashkisë	1,000,000	Small Value	781,900	08/06/2023 11:00 AM	E		
32	Riparim argjinate në shpatullat e urës së Vlushës, nga gërryerjet e lumit	826,900	Small Value	745,998	20/12/2023 12:00 PM	A		
33	Shërbim interneti për Njësitë Administrative për vitin 2023	640,000	Small Value	600,000	10/02/2023 11:00 AM	O		
34	Shërbime mirëmbajtje për automjetet për vitin 2023	1,000,000	Small Value	950,000	06/09/2023 12:00 PM	M.B		
35	Shërbime të ndryshme për pritje-përcjellje, organizim evente dhe raste të tjera	1,000,000	Small Value	910,000	30/05/2023 01:30 PM	M		
36	Shpenzime për organizimin e festës së "Rakisë"	500,000	Small Value	466,000	02/11/2023 11:00 AM	A		
37	Shpenzime për shërbime organizimi evente për projektin "Ndërtimi i Qendrës Sportive në shkollën 9-vjeçare "Zylyftar Veleshnja"	111,433	Small Value	97,000	09/06/2023 11:00 AM	J		
38	Siguracion TPL i automjeteve të Bashkisë për vitin 2023	397,502	Small Value	396,245	04/04/2023 10:30 AM	A		
39	Sigurim i jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (MZSH)	375,000	Small Value	375,000	03/04/2023 10:30 AM	I		
40	Studim projektim për "Rigjenerim urban i zonës pranë urës së madhe mbi lumin Osum"	993,000	Small Value	811,536	17/02/2023 12:30 PM	S		
41	Studim projektim për "Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme "Ramiz Aranitasi" Çorovodë, Bashkia Skrapar"	943,000	Small Value	837,120	27/01/2023 12:00 PM	G		
42	Studim-projektim për "Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës "Arkitekt Kasëmi", Bashkia Skrapar"	1,000,000	Small Value	755,187	18/08/2023 10:00 AM	H		
43	Studim-projektim për "Rikualifikim urban në lagjen "5 Shtatori", Çorovodë	7,301,480	Consulting	6,980,000	10/10/2023 10:00 AM	A	11/1/2023	3/1/2024
<b>Totali</b>		<b>78,071,973</b>		<b>69,582,602</b>				

**Burimi:** Bashkia Skrapar

### Aneksi P3: Prokurimet e zhvilluara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit të kontrates
1	Blerje Goma për automjetet e Ndërmarrjes	533,333	Small Value	425,500	11/05/2022 09:00 AM	P.M		
2	Blerje materiale Elektrike për vitin 2022	750,000	Small Value	567,000	21/06/2022 10:00 AM	E		
3	Blerje Materiale Ndërtimi për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për vitin 2022	3,908,813	Open Simple	3,799,050	26/09/2022 10:00 AM	B	10/14/2022	12/31/2022
4	Blerje Naftë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2022	9,500,000	Open Simple	9,397,102	25/02/2022 10:00 AM	G	3/16/2022	12/31/2022
5	Blerje Pjesë Këmbimi dhe Bateri për mjetet e Ndërmarrjes	833,333	Small Value	780,000	05/08/2022 10:00 AM	B		
6	Blerje Pllaka Betoni për Varrezat Publike	300,000	Small Value	225,400	15/04/2022 10:30 AM	B		
7	Blerje Vajra,Graso dhe Lubrifikantë për mjetet e Ndërmarrjes	333,333	Small Value	310,700	08/06/2022 10:00 AM	E		
8	Blerje Vegla Pune për vitin 2022	208,333	Small Value	189,900	20/10/2022 10:00 AM	E.L		
<b>Totali</b>		<b>16,367,145</b>		<b>15,694,652</b>				

**Burimi:** Bashkia Skrapar

### Aneksi P4: Prokurimet e zhvilluara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	LLoji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit të kontrates
1	Blerje Goma për automjetet e Ndërmarrjes	650,000	Small Value	609,000	08/09/2023 10:00 AM	B		
2	Blerje materiale elektrike për vitin 2023	400,000	Small Value	278,900	06/04/2023 10:00 AM	E.L		
3	Blerje materiale ndërtimi për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike për vitin 2023	3,962,494	Open Simple	3,920,031	06/07/2023 10:00 AM	B	7/14/2023	12/31/2023
4	Blerje Naftë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2023	9,558,333	Open Simple	9,183,140	10/02/2023 10:00 AM	G	2/20/2023	12/31/2023
5	Blerje pjesë Këmbimi dhe Bateri për mjetet e Ndërmarrjes	900,000	Small Value	866,000	12/05/2023 10:00 AM	S		
6	Blerje Pllaka Betoni për Varrezat Publike	300,000	Small Value	245,000	08/03/2023 09:00 AM	E		
7	Blerje Vajra dhe Graso për mjetet e Ndërmarrjes	350,000	Small Value	347,500	12/05/2023 09:00 AM	E		
8	Blerje Vegla Pune për vitin 2023	125,000	Small Value	119,000	17/08/2023 09:00 AM	E		

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit te procedures	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit të kontrates
9	Sigurim Automjetesh	400,000	Small Value	385,510	02/06/2023 10:00 AM	S		
<b>Totali</b>		<b>17,987,493</b>		<b>17,129,832</b>				

Burimi: Bashkia Skrapar

**Aneksi P5:** Procedurat e audituara në Bashkinë Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, sipas problematikave:

Nr.	Nj. Shpenzuese	Emërtimi i procedurës	Vlera e kontratës	Fondi limit	Problematikat në vlerë		
					Fondi limit	Kriteret	Vlerësimi
<b>2022</b>							
1	Bashkia Skrapar	Rigjenerimi urban i zonës afër Gjinnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë	10,662,150	10,908,570	ok	10,662,150	10,662,150
2	Bashkia Skrapar	Mur mbajtës përgjatë lumit Osum, te ish-kantieri i NSHN-së	50,628,700	51,998,778	ok	50,628,700	ok
3	Bashkia Skrapar	Blerje autoboti për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta të Bashkisë Skrapar	9,950,000	10,010,550	ok	9,950,000	ok
4	Bashkia Skrapar	Blerje naftë për administratën, për ujitje – kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2022	3,333,333	3,333,333	3,333,333	3,333,333	ok
5	Bashkia Skrapar	Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2022	1,880,660	1,896,808	ok	1,880,660	1,880,660
<b>Totali</b>			<b>76,454,843</b>	<b>78,148,039</b>	<b>3,333,333</b>	<b>78,148,039</b>	<b>12,542,810</b>
<b>2023</b>							
6	Bashkia Skrapar	Rikonstruksion i shkollës “Ramiz Aranitasi”, Çorovodë	35,972,535	41,247,773	ok	35,972,535	ok
7	Bashkia Skrapar	Ndërtimi i mjediseve sportive/ndërtim fushe sporti, pranë shkollës “Zylyftar Veleshnja”	4,488,960	4,521,937	ok	4,488,960	4,488,960
8	Bashkia Skrapar	Blerje naftë për administratën, për ujitje - kullimi dhe për zjarrfikësen për vitin 2023	3,750,000	3,750,000	3,750,000	3,750,000	3,750,000
9	Bashkia Skrapar	Blerje ushqimesh për nevojat e konviktit të shkollës së mesme për vitin 2023	1,499,200	1,533,000	ok	1,499,200	1,499,200
10	Bashkia Skrapar	Studim-Projektim “Rikualifikim urban në lagjen 5 Shtatori Corovodë	6,980,000	7,301,480	6,980,000	6,980,000	ok
<b>Totali</b>			<b>10,730,000</b>	<b>58,354,190</b>	<b>52,690,695</b>	<b>9,738,160</b>	<b>10,730,000</b>
<b>2022</b>							
15	NShP	Blerje Materiale Ndërtimi për nevojat Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2022	3,799,050	3,908,666	3,799,050	3,799,050	3,799,050
16	NShP	Blerje naftë për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Bashkia Skrapar për vitin 2022	9,357,102	9,500,000	9,357,102	9,357,102	ok
<b>Totali</b>			<b>13,156,152</b>	<b>13,408,666</b>	<b>13,156,152</b>	<b>3,799,050</b>	<b>13,156,152</b>
<b>2023</b>							
17	NShP	Blerje Materiale Ndërtimi për nevojat Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2023	3,920,031	3,962,494	3,920,031	3,920,031	ok
18	NShP	Blerje Naftë për Nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për Vitin 2023	9,183,140	9,558,000	9,183,140	9,183,140	9,183,140
<b>Totali</b>			<b>13,103,171</b>	<b>13,520,494</b>	<b>13,103,171</b>	<b>13,103,171</b>	<b>9,183,140</b>

Burimi: Bashkia Skrapar

## Anekset mbi Lejet e Ndërtimit

**Aneksi L1:** Të dhëna për aplikimet e zhvilluara gjatë viteve 2022 dhe 2023 në Bashkinë Skrapar.

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	10	6	4
Leje ndërtimi, rikonstruksione dhe shtesa në nd. ekz. deri 250m <sup>2</sup>	8	7	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	10	9	1
Çertifikatë përdorimi	2	2	-
Leje infrastrukture	5	5	-

Burimi: Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi L2:** Aplikimet e përzgjedhura për t’u audituar:

Nr.	Kategoria	Objekti	Zhvilluesi	Vendimi i lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për rikonstruksion dhe shtesë kati, me sipërfaqe më të vogël se 250 m <sup>2</sup>	Rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtesë kati në lartësi me çati	Znj. E.B	Vendim nr. 34, datë 20.04.2022	Nuk ka të dhëna
2	Leje ndërtimi me sip. më të vogël se 250 m <sup>2</sup>	Agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit	Z. A.XH	Vendim Nr. (mungon); datë 23.01.2023	42,009,447.41 lekë
3	Çertifikatë përdorimi	Agroturizëm, bujtinë 2 kat me bodrum dhe zhvillimi i parcelave me të mbjella në funksion të agroturizmit	Z. A.XH	Vendim nr. 09, datë 29.09.2023	-

**Burimi:** Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit

### Aneksi L2: Lejet e miratuara nga Bashkia Skrapar për periudhën 01.01.2022-31.12.2023:

Nr. Prot	Data e aplikimit	Investitori	Vendim Leje Ndertimi	Lloji i Lejes	Sip. ndertim	Taksa në %	Preventivi faktik	Vlera e paguar lekë	Shenime
117	28.02.2022	A.Q	Nr. 33, datë 29.03.2022	Banesë e re me binxë ,me çati me tjegulla	72.25	0.02	6,079,650	121,597	
121	18.03.2022	E.B	Nr. 34, datë 20.04.2022	Rikonstruksion banese ekzistuese dhe shtese kati ne lartesi me çati	229.96	0.02	4,774,547	148,614	
122	31.03.2022	G.M	Nr. 35, datë 10.05.2022	Vilë banimi 1 kat +Podrum	249	0.04	8,046,004	321,840	
127	22.08.2022	M.B	Nr. 63, datë 22.08.2022	Strukture me element te porositur “servis makinash”	80				Deklarate paraprake punimesh
128	03.09.2022	H.L	Nr. 37, datë 28.09.2022	Banese individuale 2 kateshe me mur rrethues	221.2	0.02	11,574,273	231,485	
135	28.12.2022	A.XH	Nr. 23/1, datë 23.01.2023	Agroturizem, Bujtin 2 kat me Podrum dhe zhvillimi i parcelave me te mbjella ne funksion te agroturizmit	240	0.02	42,009,447		Per sistemin e taksave vendore” neni 27,pika 8
137	14.01.2023	B.B	Nr. 41, datë 06.02.2023	Riparim ne katin perdhe dhe shtese kati	190.5	0.02	5,007,413	101,548	
143	05.06.2023	S.M	Nr. 66, datë 05.06.2023	Rikonstruksion I katit te pare dhe mbulim i shkalleve.	65				Deklarate paraprake punimesh
147	29.09.2023	T.M	Nr. 68, datë 05.10.2023	Ndertim Çati e pashfrytezueshme mbi objekt banimi 1 kat	80				Deklarate paraprake punimesh
149	21.10.2023	M.C	Nr. 69, datë 27.10.2023	Kryerje punimesh per Objekt Memorial					Deklarate paraprake punimesh
150	31.10.2023	E SHA	Nr. 70, datë 31.10.2023	Kryerje punimesh mirmbajtje (HEC MIVAS)					Deklarate paraprake punimesh
153	20.11.2023	H.K	Nr. 72, datë 21.11.2023	Rikonstruksioni i katit perdhe dhe çatise,banese monofaliljare 1 kat.	80				Deklarate paraprake punimesh

**Burimi:** Bashkia Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit